1- **Shkaqet Kimike** që çojnë në rritjen e dëmtimeve të betonit , më të rëndësishmet janë:

- Karbonatimi, veprimi i  $\text{CO}_2$ .
- Depërtueshmëria e klorureve  $\text{Cl}^-$ , prezente në ambjentet detare.
- Agresiviteti nga kriprat sulfate me aluminatet në beton, që janë në tokë, në ujin e detit dhe Brenda në beton në materialet përbërëse.
- Reaksionet i Alkalinëve (Na& K) me materiale inerteactive në beton që vjen nga rënia e vlerës së pH.
- Agresiviteti nga substancat acide si rezultat i reaksionit të tyre me kriprat e amoniakut, kriprat e magnezit dhe ujit të butë, në betonin e ngurtësuar.
- Ndikimi i lagështirës, prezenca e të cilës nxit reaksionin e hidratimit të çimentos me ujin  $\text{H}_2\text{O}$ . Korrozioni nga ndotja e ajrit, veprimi i  $\text{O}_2$ .

Këto shkaqe, C.W.Yu dhe John W. Bull, i përmbledhin në figurën 1.2.1.1, si më poshtë:




Figura 1.2.1.1: Shkaqet kimike të shkatërrimit të betonit

Kërkesat decizive:

- Cilësia e shtresës së jashtme të betonit (Përshkueshmëria, poroziteti, difuzioni)
- Mbështjellja e betonit ( shtresa mbrojtëse)

### 2- Shkaqet Fizike

- Ngrirje shkrirja, e ndikuar edhe nga kriprat e shkrira.
- Plasaritjet e para të shkaktuara tkurrjet dhe tendosjet termike.
- Tensionet e krijuara gjatë procesit të ngurtësimit të betonit.

### 3- Shkaqet Mekanike

- Gërryerja sipërfaqesore nga forcat e fërkimit.
- Gërryerja nga rrjedhja e ujit.
- Goditjet.

Ndër shkaqet e brendshme që ndikojnë në degradimin e strukturave të betonit janë dhënë edhe në fotot e mëposhtme:



**Figura 1.2.1.2, 1.2.1.3: Fenomeni i segregimit të betonit dhe mosngjeshjes referuar standardit**

- Mos realizimi i duhur i shtresës mbrojtëse të armaturës së hekurit.
- Realizimi jo i duhur i ngjeshjes së betonit në vepër.
- Hedhja e betonit nëstrukturë duke mos respektuar Kushtet Teknike të Zbatimit për procesin e betonimit.



**Figura 1.2.1.4: Shembuj të defekteve në ngjeshjen e betonit, në ish pishinën dimërore në Durrës**


Nga komentimi i gjendjes së strukturave të betonit në Durrës por edhe më gjërë në vendin tonë, u konstatua që gjatë periudhës kohore prej viteve 1930- deri më 2010, por kryesisht ndërtimet e bëra në vitet 1940-1990, kanë defekte në hapat e realizimit të tyre, disa prej të cilat po i pasqyrojmë më poshtë:

- Në fazën e projektimit, Kushtet Teknike të Projektimit parashikonin llogaritjen e strukturave të betonit pothuajse vetëm në kriteret e qëndrueshmërisë. Përgjithësisht nuk llogariteshin strukturat në jetëgjatësi.
- Për ndërtimin e objekteve të banimit kryesisht përdorej betoni me klasa (marka) të ulta. Theksojmë që betonet e përdorura rëndom, në objektet e banimit dhe ato sociale të zakonshme, në këto vite janë me klasa (marka siç janë emërtuar në atë kohë) maksimale M-200-250, që i korespondojnë sot klasave C 16/20- C20/25.
- Betonet strukturore fillonin nga M-200, sot C16/20. Sipas S SH EN 206-1 kjo klasë nuk quhet beton strukturor.
- Gjatë fazës së prodhimit të betonit, kushtet në të cilat punonte kantjeri i prodhimit ishin larg kërkesave të standardit S SH EN 206-1.
- Larja e materialeve inerte në karrierat e nxjerrjes, përdorimi i klasave të duhura të këtyre materialeve inerte, respektimi i raporteve të përbërësve të betonit, nuk vlerësoheshin në nivelin e standardit. Këtu dua të theksoj në mënyrë të veçantë nuk kushtoheshin kujdes mbi rëndësinë e përdorimit të sasisë së duhur të ujit. Sasia e ujit në beton shpesh pa kriter, në çdo fazë të prodhimit dhe të përdorimit të betonit.
- Gjatëfazës së transportit të betonit në objekt jo gjithnjë respektoheshin kushtet e KTZ-së. Përgjithësisht nuk kishte betoniera apo auto betoniera për transportin e betonit, apo pompa për hedhjen e betonit në objekt.
- Gjatë fazës së hedhjes së betonit në objekt vërehej mungesa e mjeteve të mekanizuara për hedhjen e betonit në vepër, shpesh betoni të hidhej me krahë, madje edhe në katet e larta. Theksojmë në mënyrë të veçantë ato pallate që ndërttoheshin me kontribut vullnetar, pra nga punëtorë jo të specializuar.
- Mungesa e mjeteve dhe veglave të mekanizuara bënte që jo rrallëherë ngjeshja e betonit të mos bëhej referuar standardit por me mjete rrethanore, nuk kishte vibrator. Mungesa e mekanizimit të procesit të ndërtimit bënte që cilësia e hedhjes së betonit të ishte në nivele të ulta cilësore.
- Mungesat e kontrollit, në nivelin e standardit, të mënyrës së betonimit të strukturave të betonit si dhe trajtimi i tyre ishin me shumë të meta dhe mangësi.
- Cilësia e armaturës së drurit ishte për të dëshiruar. Kjo çonte jo vetëm në realizimin e sipërfaqeve të strukturave të betonit jo të dëshiruara, por edhe në rrjedhjen e lëngut të çimentos duke lënë në strukturë gati vetëm Materialet inerte me pak çimento.
- Sasia e çimentos ishte e lartë për klasën e betonit që prodhohej. Rezultati ishte kosto e lartë e prodhimit të betoneve. Këtë fakt e kemi pasqyruar edhe në tabelën 1.2.1.1 të mëposhtme.
- Në prodhimin e betoneve nuk përdorehin shtesa ose aditivë.

**Tabela 1.2.1.1: Sasia e përbërësve të betonit referuar manualeve shqiptare, në vite**


| <b>Periudha<br/>në vite</b> | <b>Çimento,<br/>Kg/m<sup>3</sup></b> | <b>Ujë,<br/>litra</b> | <b>U/Ç</b> | <b>Klasa (marka)<br/>MPa</b> | <b>Aggregate/çimento<br/>%</b> |
|-----------------------------|--------------------------------------|-----------------------|------------|------------------------------|--------------------------------|
| 1945-1950                   | 340                                  | 170                   | 0,5        | 30                           | 7.5                            |
| 1950-1960                   | 300                                  | 170                   | 0,6        | 30                           | 6.8                            |
| 1960-1990                   | 270                                  | 170                   | 0,63       | 30                           | 6.6                            |
| Sot viti 2013               | 368                                  | 200                   | 0,543      | 30                           | 5.77                           |

Po të modelojmë shkaqet e dëmtimit dhe shkatërrimit të betonit dhe strukturave të tij do të shohim figurën 1.2.1.5, si më poshtë:



**Figura 1.2.1.5: Shkaqet e dëmtimit dhe shkatërrimit të strukturave të betonit të armuar.**

Në mënyrë tabelare do të përcaktonim shkaqet e shkatërrimit të betonit dhe të strukturës të paraqitura në figurën 1.6, të marra nga S SH EN 1504-9:



**Figura 1.2.1.6: Shkaqe të zakonshme të dëmtimit të strukturave të betonit [S SHEN 1504-9 (1997)].**  
 (Marrë nga "Qëndrueshmëria e Materialeve dhe Strukturës në Ndërtim dhe Inxhinierinë Civile", Edituar nga C.W.Yu dhe John W. Bull) (51)

Ndërsa duke përmbledhur mendimet e dhëna nga **M. Collepardi** kam ndërtuar tabelën 1.2.1.2 e mëposhtme:

**Tabela 1.2.1.2: Sasia Shkaqet e shkatërrimit të strukturave të betonit**

|                                     |                                      |                              |                                                                                            |
|-------------------------------------|--------------------------------------|------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|
| Shkatërrimi i strukturave betonarme | 1. Përshkueshmeria                   | 1.1. Kapilariteti i poreve   | 1.1.1 Raport i lartë u/ç                                                                   |
|                                     |                                      |                              | 1.1.2 Trajtim i keq gjatë gurtësimit                                                       |
|                                     |                                      | 1.2. Makroporet              | 1.2.1 Raport i ulët u/ç                                                                    |
|                                     |                                      |                              | 1.2.2 Ngjeshje jo e duhur e betonit të freskët në raport me punueshmërinë e tij të kërkuar |
|                                     |                                      | 1.3 Plasaritjet              | 1.3.1 Ngarkesat në fazën e punës                                                           |
|                                     |                                      |                              | 1.3.2 Ciklet e ngrirje/ shkrirjeve                                                         |
|                                     |                                      |                              | 1.3.3 Ciklet e të ftohtit/ të ngrohtit                                                     |
|                                     | 2. Prezenca e ujit                   | 2.1 Ambjentet me lagështi    |                                                                                            |
|                                     | 3. Ekspozimi ndaj agjentëve agresivë | 3.1 Në ajër                  | 3.1.1 Oksigjeni O <sub>2</sub>                                                             |
|                                     |                                      |                              | 3.1.2 Dyoksidi i karbonit CO <sub>2</sub>                                                  |
|                                     |                                      | 3.2 Sulfatet SO <sub>4</sub> |                                                                                            |
|                                     |                                      | 3.3 Kloruret CL <sup>-</sup> |                                                                                            |
|                                     |                                      | 3.4 Jonet alkale             |                                                                                            |

### 1.2.2 Ç'është jetëgjatësia. Koncepte bazë mbi jetëgjatësinë

Do desha të theksoja përcaktimin që i bën një prej studiuesve më të rëndësishëm të betoneve jetëgjatësisë, **Neville** referuar të cilit:

Është shumë e rëndësishme që çdo strukturë betoni të vazhdojë të kryejë funksionet që ka, që janë ruajtja e qëndrueshmërisë së kërkuar dhe shërbyeshmërisë, gjatë jetës së saj të përdorimit. Për pasojë, betoni duhet të jetë në gjendje të përballojë, gjatë gjithë periudhës së funksionimit, pa u shkatërruar, ndikimet agresive të kushte ambjentale të ndryshme, ndaj të cilave ai është i ekspozuar. Betone të tillë quhen të qëndrueshëm, jetëgjatë apo durabël.

Betone jetëgjatë do të jenë ato betone të cilat i rezistojnë ndikimit të kushteve agresive ambjentale pa humbur vetitë e tyre funksionale, pa patur nevojë për punime shërbimi, për një kohë më të gjatë se standardi i sotëm që për godinat e banimit është 50 vjet. Jetëgjatësia arrihet duke patur parasysh dhe vlerësuar klasat e ekspozimit ambjental të përcaktuara më poshtë në eurokodin shqiptar.




Figura 1.2.2.1: Algoritmi i prodhimit të betonit të zakonshëm





Figura 1.2.2.2: Algoritmi i prodhimit të betonit jetëgjatë

Në studimin e jetëgjatësisë së betonit duhet të kemi parasysh dy koncepte të jetëgjatësisë. Jetëgjatësinë e strukturës së betonit e cila ka të bëjë me jetën në përdorim dhe jetëgjatësinë e betonit e cila ka lidhje me jetën në shërbim. Për të siguruar jetëgjatësinë e betonit dhe jetëgjatësinë e strukturës duhet të kihen parasysh rregullat e mëposhtme:

- Për të patur **jetë në përdorim** të strukturës së betonit, duhet bëjmë dallimin ndërmjet jetëgjatësisë së projektuar të betonit, i marrë si material duke marrë parasysh kushtet ambientale të veçanta në të cilat ai punon dhe jetëgjatësisë së vërtetë të betonit në vepër, pra me vetitë që ai ka në strukturën reale.

- **Jeta në shërbim** që është e lidhur me betonin si material pasi çdo dëmtim i shfaqur në një strukturë, është pasojë e mospërputhjes ndërmjet cilësive të betonit dhe kushteve të ekspozimit në të cilat punon ai, pra duket qartë se, jetëgjatësia e betonit si material do të ishte me të vërtetë e lidhur me jetëgjatësinë e strukturës.

Në mënyrë skematike po paraqes nga se varet jetëgjatësia e betonit, më poshtë figura 1.20



**Figura 1.2.2.3: Faktorët nga të cilët varet jetëgjatësia e betonit**

Referuar Eurocod 2, duhet marrë parasysh jetëgjatësia e strukturave të betonit në mënyrë që të sigurohet që struktura të mbetet funksionale gjatë gjithë jetës së saj. Kjo kërkesë do të përfshijë të gjitha aspektet e projektimit, si p.sh. zgjedhja e klasës së betonit dhe përcaktimi i shtresës mbrojtëse për të siguruar një ruajtje sa më të përshtatshme të shufrave të armimit; gjithashtu edhe përzgjedhja e materialeve të përshtatshme në përputhje me kushtet e ekspozimit në të cilat do të punojnë struktura. Të rëndësishme gjithashtu janë procedurat e duhura të procesit të ndërtimit nëse duam që betoni të jetë jetëgjatë, duke gjatë kohës së shërbimit. Sot standardi na thotë që jetëgjatësia e

projektuar e betoneve të projektuara me çimento Portland dhe me madhësinë maksimale 20mm të materialeve inerte është 50 vite. Edhe po ti referohemi standardit S SH EN 206-1:2003, më poshtë paraqitet jetesa në vite referuar tipit të konstruksionit.


**Tabela 1.2.1.2: Jetesa normale marrë nga S SH EN 206-1:2003**

| Jetëgjatësia në vite | Tipi i konstruksionit                                               |
|----------------------|---------------------------------------------------------------------|
| $\leq 10$            | Objektet e përkohshme                                               |
| $\geq 50$            | Veprat e zakonshme,<br>Urat, digat dhe objektet e rëndesisë normale |
| $\geq 100$           | Veprat e mëdha<br>Ura, digat, rëndësi strategjike të veçanta        |

Zhvillimi, gjatë viteve të shërbimit të strukturës, e të gjitha faktorëve që shkaktojnë demtimin e betonit, mund të modelohet nga një kurbë me dy faza (fig 1.2.2.4) (Tuutii 1982). Kjo është baza e përcaktimit të jetëgjatësisë së shërbimit të strukturës. Jetëgjatësia tekike e shërbimit është koha gjatë shërbimit deri sa arrihet një fazë e caktuar demtimi e papranueshme. Dy fazat e demtimit i shpjegojmë si më poshtë:

**Faza e fillimit.** Gjatë kësaj faze nuk ndodh ndonjë dobësim i dukshëm i betonit apo ndonjë rënie funksionale e strukturës, por disa nga barrierat mbrojtëse thyhen ose tejkalohen nga veprimet aggressive të kushteve të mjedist nëpërmjet klasave të ekspozimit. P.sh karbonizimi i hekurit, si rezultat i depërtimit të klorureve të ujit të detit janë shembuj të faktorëve që përcaktojnë jetëgjatësinë e periudhës së fillimit.

**Faza e përhapjes.** Gjatë kësaj faze dallohet një zhvillim aktiv i demtimit dhe humbjes funksionale të strukturës. Ndikimi i faktorëve që çojnë në shkatërrimin e strukturës tashmë bëhen shumë më të ndjeshëm dhe rriten me një ritëm më të shpejtë. Korozioni i strukturës betonarme është një nga shembujt më të rëndësishëm të përparimit që çon në shkatërrimin e strukturës.



**Figura 1.2.2.4: Jetëgjatësia e shërbimit të strukturës prej betoni. Modeli i demtimit me dy faza.**  
(Marrë nga Dr Streen Rostam "QËNDRUESHMËRIA E STRUKTURAVE PREJ BETONI – GJEDJA E ARTIT" Marrë nga libri i edituar nga C.W.Yu dhe John W. Bull (52)

Jetëgjatësia e betoneve është qëndrueshmëria e strukturave betonarme për tu rezistuar veprimeve fizike, kimike, mekanike etj. Kjo do të thotë që:

- Tu rezistojë ngarkesave dhe mbingarkesave të ndryshme, gjatë periudhës së shfrytezimit, pa shkatërruar funksionin strukturor.
- Tu rezistojë veprimeve të ndryshme agresive të mjedisit duke ruajtur estetikën, sigurinë, rehatinë e përdoruesit për të cilën ai është projektuar.

Struktura duhet të qëndrojë në nivel konstant dhe të ketë një qëndrueshmëri të mirë gjatë gjithë jetës së përdorimit, me shpenzimet minimale të mirëmbajtjes. Struktura duhet të ruajë në vlera minimale kohëzgjatjen e përdorimit të objektit që është edhe jeta e shërbimit të strukturës.

Qëndrueshmëria që lidhet me mjedisin, është një parameter shumë i rëndësishëm. Kjo kërkon që të merren parasysh të gjitha llojet e ndikimeve agresive të mjedisit, të cilat përbëjnë edhe faktorët e jashtëm që ndikojnë në qëndrueshmërinë e strukturës së betonit. Kjo do të arrihet nëse do të vlerësohen të gjitha ndikimet e mjedisit që nga moment i hedhjes së betonit e deri gjatë gjithë jetës së shërbimit, që do të thotë se duhet të respektohen dhe të zbatohen të gjitha rekomandimet në fuqi.

Rëndësi të veçantë marrin marrja parasysh e ndikimit të faktorëve të brendshëm të një strukture. Këta faktorë varen nga shumë parametra, si:


- Cilësia e projektimit të strukturave referuar Eurocode 2.
- Cilësia e materialeve dhe e përbërësve të përdorur të betonit.
- Cilësia dhe standardi i prodhimit dhe transportit të betonit deri në strukturën e ndërtimit.
- Zbatimi i të gjitha rregullave teknike për realizimin e strukturave të betonit, referuar Standardit S SH EN 206-1:2003; S SH EN 197-1: 2011.

### 1.3 BETONI SI MATERIAL NDËRTIMI DHE PËRBËRËSIT E TIJ

Betoni është një gur artificial i prodhuar si rezultat i përzierjes së përbërësve të tij referuar një raporti të duhur nëpërmjet një procesi të caktuar teknologjik. Betone të zakonshëm konsiderohen përzierjet e ngurtësuar me masë vëllimore  $2200\text{--}2400\text{ kg/m}^3$ .

Materialet përbërëse të betonit janë: çimento, Materialet inerte(rëra, zhavorri ose çakëlli), uji dhe shtesat e ndryshme. Për llogaritjen dhe përcaktimin e këtij raporti ekzistojnë teori të ndryshme. Ato përcaktonë raportet e përbërësve të betonit, duke u nisur nga kritere referuese të ndryshme. Modelimi matematikor i gjetjes së sasive të përbërësve të betonit quhet mix-design ose projektimi i recepturave të betonit, trajtuar më poshtë.

Mbështetur në standardin S SH EN 206-1, është dhënë raporti i përbërësve në figurën 1.6:



**Figura 1.3.1: Përqindjet e përbërësve të betonit**

Betoni në gjendje të ngurtësuar ka strukturë homogjene, ndërsa përbërësit e tij kanë strukturë heterogjene. Kjo është arsyeja që për të marrë një beton të kërkuar duhet të studiojmë dhe analizojmë dhe llogarisim materialet përbërëse.

#### 1.3.1 Materialet inerte

Materialet inerte janë materiali mbushës dhe përbërësi kryesor i betonit. Agregatet, me vetitë e tyre, ndikojnë drejtpërdrejt në vetitë e betoneve. Në përdorimin e materialeve inerte për prodhimin e betonit duhet të merren parasysh cilësitë e tyre që janë vetitë fiziko-kimike dhe mineralogjike-petrografike. Përcaktojmë edhe kategorizimin e materialeve inerte, Referuar EN 933-1.

### 1.3.1.1 Materiali inert i hollë, rëra

Rëra është material i shkrifët i përbërë nga kokrriza me madhësi nga 0.5 – 5 mm të fituara nga copëtimi natyral ose mekanik i formacioneve shkëmborë. Përbërja mineralogjike e rërave varet nga përbërja e shkëmbit mëmë.

Rëra në përmbajtjen e saj nuk duhet të ketë më shumë se 2-3 % argjilë dhe pluhura si dhe përmasat e kokrrizave të saj nuk duhet të jenë më të mëdha se 2mm dhe duhet të jetë në përputhje me standardin EN 126207.

Standardi miraton kërkesat cilësore, klasifikimin dhe rregullat dhe rregullat e marrjes në dorëzim të rërës që përdoret për ndërtim, Kryesisht për përgatitjen e llaçi dhe betonit.

**Tabela 1.3.1.1: Tabela përmbledhëse mbi specifikimet e rërave natyrale**

| Klasifikimi         | Mbetja e plotë mbi sitë [%] | Moduli i madhësisë së kokrrizave | Sasia që kalon sitën 0.125 mm, [%] të masës |
|---------------------|-----------------------------|----------------------------------|---------------------------------------------|
| Rërë e trashë       | 50 – 70                     | 2.4 – 3.5                        | 10                                          |
| Rërë e mesme        | 35 – 50                     | 1.9 – 2.5                        | 10                                          |
| Rërë e imët         | 20 – 36                     | 2.0 – 1.5                        | 15                                          |
| Rërë shumë e trashë | 10 - 20                     | 1.6 – 1.1                        | 20                                          |

### 1.3.1.2 Materiali inert i trashë, granil 1 dhe çakëll 2.

Si mbushës i trashë në betone, përdoren zalli ose çakulli. Betonet e freskëta që transportohen me betoniere nuk duhet të kenë material të trashë me madhësi më shumë se ¼ e diametrit të tubit të pompës.

Që Materiali inert të jetë i përshtatshëm, ai duhet të plotësojë kërkesat e S SH EN 12620: 2002+ A1:2008.

Mbështetur në Normativat Europiane që përcaktohen në standardin EN 12620 duhet të kemi parasysh këto kërkesa të rëndësishme mbi raportin e përmbajtjes së materialeve inerte në recepturën e betonit, të marrë nga Sika Concrete Handbook:




Figura 1.3.1.2: Kurbat e shpërndarjes së grimcave referuar Sika Concrete Handbook

### 1.3.2 Çimento

- Çimento- lidhësi kryesor për prodhimin e betonit. Studime dhe kerkime mbi porozitetin e brumit dhe gurit të çimentos, proceset e hidratimit. Një analizë e plotë, komente.

Çimento është materiali lidhës në prodhimin e betonit. Çimento duke u përzier me ujin dhe me mbushësin e hollë, rërën, na jep llaçin e çimentos. Më tej duke u përzier me mbushësin e trashë, çakëllin, formon betonin.

Referuar **ASTM C150**, çimento ndahet në 5 tipi kryesore. Çdo tip i çimentos ka një indeksim (numër) të veçantë që i korrespondojnë klasa të ndryshme qëndrueshmëriash që janë; 32.5; 32.5R; 42.5; 42.5R; 52.5; 52.5R. Këto numra përcaktojnë rezistencën mekanike minimale në shtypje në N/mm<sup>2</sup> e matur në 28 ditë.

Çimento prodhohet si rezultat i procesit teknologjik të bashkimit të mineraleve përbërëse C<sub>3</sub>S; C<sub>2</sub>S; C<sub>3</sub>A; C<sub>4</sub>AF; SO<sub>3</sub>; MgO si dhe materialeve lidhëse. Përqindja e këtyre mineraleve në përmbajtjen e brumit të çimentos ose klinkeri, është dhënë më poshtë në tabelën 1.3.2.1:

**Tabela 1.3.2.1: Përmbajtja në % e mineraleve për tipet e çimentove**

| <b>Tipi referuar ASTM</b>      | <b>C<sub>3</sub>S</b> | <b>C<sub>2</sub>S</b> | <b>C<sub>3</sub>A</b> | <b>C<sub>4</sub>AF</b> |
|--------------------------------|-----------------------|-----------------------|-----------------------|------------------------|
| I-çimento portland e thjeshtë  | 45-55                 | 20-30                 | 8-12                  | 6-10                   |
| II- çimento Portland e Përbërë | 40-50                 | 25-35                 | 5-7                   | 10-15                  |
| III- çimento Furrnalte         | 50-65                 | 15-25                 | 8-14                  | 6-10                   |
| IV- çimento Pocelanoze         | 25-35                 | 40-50                 | 5-7                   | 10-15                  |
| V- çimento e Përbërë           | 40-50                 | 25-35                 | 0-4                   | 10-20                  |

Çimento nëse përzihet me ujë në një raport 3:1, është në gjëndje për të prodhuar një pastë të çimentos (klinker) e cila është lehtësisht e punueshme. Klinkeri për një interval kohe rreth një orë e humb plasticitetin fillestar të saj pra kompaktësohet dhe për një periudhë kohe rreth 24 orë ose një ditë arrin afërsisht fortësinë e një guri natyror dhe është në gjëndje për ti rezistuar ngarkesave mekanike.

Klinkeri , brumi i çimentos, prodhohet duke pjekur në temperature që shkojnë 200-1400°C, përzjerjen e lendeve te para,në sasinë (76 deri 78) % me gurin gëlqeror dhe argjilën, në sasinë (22 deri 24)%.

Në përbërjen klinkerit janë të pranishme edhe mineralet okside të mëposhtme:

CaO<sub>2</sub> (64 deri 68)%,  
SiO<sub>2</sub> (20 deri 23)%,  
Al<sub>2</sub>O<sub>3</sub> (3 deri 8)%,  
Fe<sub>2</sub>O<sub>3</sub> (2 deri 6)%,  
Ca O 65.5%

si dhe përmbajnë MgO, Na<sub>2</sub>O, K<sub>2</sub>O, TiO<sub>2</sub> në përqindje të vogla.

Ndikimi i vetive të çimentos dhe përbërjes mineralogjike të saj,e për rrjedhojë në vetitë e betonit, vjen si rezultat i zhvillimit të reaksionit të hidratimit të çimentos që është një reaksion ekzotermik dmth shoqërohet me çlirim nxehtësie. Minerale të kryesore që ndikojnë në këtë reaksion ekzotermik janë C<sub>3</sub>S dhe C<sub>3</sub>A, të cilat gjatë procesit të hidratimit çlirojnë nxehtësi.

Kështu sa më e madhe të jetë sasia e çimentos së përdorur aq më e madhe do të jetë edhe sasia e nxehtësisë së çliruar që dmth aq më i madh është edhe avullimi i ujit gjatë procesit të ngurtësimit si dhe rritet mundësia e shtimit të poreve kapilare. **Pra hidratimi i çimentos ndikon në ritjen e poreve në beton.**

Më poshtë, në figurën 1.3.2.1, është dhënë procesi i hidratimit të brumit të çimentos. Dukendjekurfazat e kalimit të brumit të çimentos në gur çimento, nëpërmjet procesit të hidratimit ose **të thithjes së sasisë së ujit, fillojnë të krijohen strukturat skeletore**. Po të përshkruanim në mënyrë të përmblendhur fazat e hidratimit të çimentos do të paraqesim:

#### **a) Faza e parë e hidratimit**

Zakonisht ndodh deri në 4-6 orët pas prodhimit të çimentos. Gipsi në pastën plastike të çimentos lidh tricalcium aluminatin (C<sub>3</sub>Al) duke formuar trisulphate (etringite),që është

një shtresë uji e padepërtueshme e cila pengon konvertimin e përbërësve të tjerë. Kemi krijimin e një strukture **kristalore halore**.

#### b) Faza e dytë e hidratimit

Zakonisht ndodh pas 4-6 orësh deri në një ditë pas prodhimit të çimentos. Pas pak orësh ne shohim fillimin e fuqishëm të hidratimit të materialeve përbërëse të klinkerit veçanërisht të tricalcium silicate ( $\text{Ca}_3\text{Si}$ ), e cila shoqërohet me **formimin e kristalit të kalçium silikatit** i cili shërben për konsolidimin e strukturës.

#### c) Faza e tretë e hidratimit


Zakonisht ndodh rreth një ditë pas prodhimit të çimentos. Struktura dhe mikrostruktura e klinkerit të çimentos janë fillimisht akoma hapur. Ndërsa procesi i hidratimit përparon, hapsirat janë të mbushura me produkte të tjera të hidratuara dhe qëndrueshmëria rritet më shumë. Pra, kjo strukturë, e klinkerit, pas ngurtësimit, është shumë e fortë dhe shoqërohet me krijimin e poreve. **Poroziteti i çimentos dhe vazhdimi i procesit të hidratimit** edhe gjatë lidhjes në beton është një fenomen mjaft i rëndësishëm dhe faktor për prodhimin e betoneve të zakonshëm dhe jetëgjatë.




Figura 1.3.2.1: Jepen fazat e hidratimit dhe të ndryshimit structural të çimentos

Ky proces, në mënyrë grafike, referuar **Michael S. Mamlouk & John P. Zaniewski**, në *“Materials for Civil and Construction Engineers” Third edition*, është treguar në figurën 1.3.2.2 të mëposhtme.


- a) Formohet së pari faza C-S-H.  $C_3A$  formon një xhel të shpejtë.



- b) Volumi i grimcave të çimentos bie ndërsa formohet xheli në sipërfaqe. Grimcat e çimentos akoma janë në gjendje të levizin në mënyrë të pavarur, por ndërsa rritet hidratimi, fillon një bashkim i lehtë. Një pjesë e çimentos është në fazën thiksotropike, vibracioni mund të thyjë pikat e dobëta.




- c) Seti fillestar ndodh me zhvillimin e një skeletoni të dobët në të cilin grimcat e çimentos mbahen në vend.



- d) Seti përfundimtar ndodh ndërsa skeletoni bëhet rigjid, grimcat e çimentos janë kyçur në vend dhe rritet hapësira midis grimcave të çimentos për shkak të reduktimit të volumit të grimcave.



- e) Hapësirat midis grimcave të çimentos janë mbushur me produktet e hidratimit ndërsa pasta e çimentos rrit fortësinë dhe durabilitetin.



Zhvillimi i strukturës në pastën e çimentos (sipas Hover dhe Phillco, 1990):

- faza fillestare C-S-H,
- formimi i xhelit,
- seti i fillimit - zhvillimi i skeletonit të dobët,
- seti përfundimtar - zhvillimi i skeletonit rigjid,
- ngurtësimi.

**Figura 1.3.2.2: Fazat e hidratimit dhe të ndryshimit struktural të çimentos**

### 1.3.3 Uji

Uji është një element tjetër përbërës i rëndësishëm i betonit. Raporti i sasisë së ujit në lidhje me përbërësit e tjerë të betonit, është një nga kërkesat e standardit për kalimin nga betonet e zakonshme në betone jetëgjatë.

Uji është një element me funksion të dyfishtë referuar betonit. Ai mundeson krijimin e përzierjes së betonit dhe i jep ketij të fundit veti plastike. **Uji që përdoret për prodhimin e betonit duhet të jetë në përputhje me kërkesat e EN 1008** duhet të jetë ujë si substancë, reagon kimikisht me lëndet lidhëse gjatë fazës së ngrirjes dhe ngurtësimit. Burimet e ujit që mund të përdoren për realizimin e përzierjes së betonit mund të jenë të ndryshme.

### 1.3.4 Shtesat ose aditivët në trajtë tretësire ose të ngurtë

Referuar përcaktimit të S SH EN-206-1-2003, pika 3.1.22 “shtesë (tretësirë) quhet material i shtuar gjatë procesit të përzierjes së betonit, në sasi të vogla në lidhje me masën e çimentos, për të ndryshuar vetitë e betonit të freskët ose të ngrutësuar”.

Shtesat ose modifikuesit janë materiale kimike të prodhuara për ti dhënë betonit disa veti dhe cilësi të cilat janë të favorshme dhe të kërkuara për projektuesin dhe për strukturat e betonit.

Përdorimi i shtesave bëhet duke plotësuar kërkesat e S SH EN-206-1:2003 referuar të cilit përzierësit për betonin duhet ti përgjigjen standardit EN 934-2.

**Tabela 1.3.4.1: Sasia e shtesës së lëngët referuar EN 206-1:2003**

| <b>Sasia e shtesës së lëngët referuar standardit EN 206-1:2003</b> |                                                                                                                                        |
|--------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Sasia e lejuar                                                     | $\leq 5 \%$ referuar peshës së betonit (duhet të verifikohet efekti i një doze më të lartë në performancë dhe durabilitetin e betonit) |
| Sasia e minimale                                                   | sasia e shtesave $< 2 \%$ të betonit lejohen vetëm nëse janë tretur pjesërisht në ujin e miks betonit                                  |

Nëse sasia totale e shtesave të lëngshme është  $> 3 \text{ l/m}^3$  e betonit, sasia e ujit që reduktohet në recepturë duhet të përfshihet në llogaritjet e raportit ujë/çimento. Efektet dhe përdorimet e shtesave të listuara më lartë (dhe të tjera) janë diskutuar më gjatë në pjesën në vijim.

## KAPITULLI 2

### LITERATURË, MBËSHTËTJE TEORIKE NGA EKSPERIENCA BOTËRORE

#### TË PËRGJITHSHME

Në këtë kapitull i referohemi standarteve shtetërore shqiptare, standarteve europiane, standarteve botërore si dhe literaturave të autorëve të ndryshëm që kane trajtuar vetitë dhe karakteristikat teknike të betoneve jetëgjatë, të eksperimentuara në këtëpunim. Punimi i eksperimentuar për betonin jetëgjatë, përbën vëllimin më të madh të kërkimit shkencorë, pasi lidhet drejtpërsëdrejti me përcaktimin e karakteristikave të mëposhtme të betonit të prodhuar në kushtet e kantjereve të prodhimit dhe të trajtuara në kushtet e një mjedis agresiv dhe në ato që një kantier ndërtim realizon.

#### 2.1 LITERATURAT DHE STANDARDET QË I REFEROHEN FAKTORËVE QË NDIKOJNË NË VETITË E BETONIT JETËGJATË

##### 2.1.1 Punueshmëria, në betonin e freskët

**Deborah H. Butler (2013):** Punueshmëria është mundësia e betonit të freskët për të rrjedhur në strukturën e betonit. Betoni i prodhuar me punueshmërinë e duhur është i përshtatshëm për kushtet e kantjerit.

**Mamlouk, Michael S. (2011):** Referuar studimeve punueshmëria e betonit rritet kur:

- duke shtuar sasinë e ujit,
- nëpërmjet përdorimit të shtesave të lengta, ose
- duke përdorur materiale inertenatyrale, pra me forma të rrumbullakosura.

Referuar **Neville (2002)** faktorët që ndikojnë në punueshmëri janë:

Faktori kryesor është përmbajtja e ujit në recepturën e betonit e shprehur në litra/  $m^3$ . Kjo sasi jepet në një tabelë për punueshmëri (slump) të ndryshme dhe madhësi maksimale të materialeve inerte. Për rastin tonë të studimit marim këto vlera në tabelë: për Dmax të materialit inert 25-30 cm; për punueshmëri të klasës 4-5; për Materialet inertenatyrale sasia e ujit është 175-180  $kg/m^3$  dhe për Materialet inerte thyera është 200-205  $kg/m^3$ .

Megjithatë ndikimet e materialeve inerte dhe të raportit ujë/çimento duhet të merren në konsideratë së bashku. Kështu në mënyrë të përmbledhur, për një punueshmëri të dhënë, gjendet një vlerë e raportit agregat i trashë/ hollë i cili kërkon sasinë më të vogël të ujit.

##### 2.1.2 Ndikimi i çimentos, në betonin e freskët

Përdorimi i çimentos Portland u mbështet mbi bazën e studimeve të mëposhtme:

**Philip S. Zacarias, ShawCor Ltd (2007)**

Gjenden fakte të konsiderueshme që betonet e prodhuara me çimento Portland, me përmbajtje të lartë të C3A, janë më rezistente ndaj korrozionit të kriprave se sa çimentot sulfate.

- Nga analizimi i fazave të hidratimit të çimentos na çon në faktorët që ndikojnë në rezistencën fillestare dhe atë përfundimtare të çimentos janë përbërja e klinkerit dhe imtësia e bluarjes.
- Përbërja e klinkerit ndikon nëpërmjet raportit ndërmjet silikatit trekalcik ( $C_3S$ ) dhe silikatit bikalcik ( $C_2S$ ): i pari hidratohet më shpejt, duke çliruar një sasi të konsiderueshme nxehtësie, ndërsa i dyti hidratohet më ngadalë. Prandaj një klinker me përmbajtje të madhe të  $C_3S$  na jep një arritje të shpejtë të rezistencës, ndërkohë që ai që përmban më shumë  $C_2S$ , e arrin rezistencën me shpejtësi më të vogël, por qëndrueshmëria përfundimtare është gjithashtu e pothuajse e njëjtë.
- Imtësia e bluarjes do të thotë një sipërfaqe kontakti më e madhe pra një shpejtësi më e madhe e hidratimit: e për rrjedhojë, faktori i imtësisë influencon veçanërisht në përfundimin e rezistencës fillestare.

**Mehta (1981)** duke konkluduar nga testet laboratorike dhe llogaritjet teorike që betoni në ambientet detare kërkon çimento portland me përmbajtje më pak se 8%  $C_3A$  me qëllim që të lidhë dhe largojë jonet e klurureve nga solucioni i çimentos.

**Verbeck (1968)** gjeti që shkalla e plasaritjeve të lidhura me korrozionin e trarëve në ujë e detit zvogëlohet me rritjen e përmbajtjes së  $C_3A$ . Për sasi të  $C_3A$  2-5%, 5-8%, 8-11%, madhësia e plasaritjeve linare për kubikët ishte përkatësisht 11,9.1 dhe 4 mm. Rezultatet treguan që përmbajtja e  $C_3A$  duhet të jetë mbi 8% për të pasur një mbrojtje të mirë të hekurit të betonit. Këto studime janë theksuar nga Philip S. Zacarias, ShaëCor Ltd.(2007).

**Mamlouk, Michael S. & JOHN P. ZANIEWSKI (2011):** rekomandon një përdorimin e një sasive minimale të çimentos  $334\text{kg/m}^3$  për betonet e ekspozuara në zonat bregdetare dhe jo më pak se  $385\text{kg/m}^3$  për betonet që punojnë nën ujë.

Ndikimi i çimentos në jetëgjatësinë e betonit përcaktohet në standardin EN 206-, referuar të cilit duhet të përdorim tipin e duhur të çimentos por edhe të ruajmë një sasi minimale të mundshme, për shkak të fenomenit të plasaritjeve si rezultat i procesit të hidratimit, por edhe për shkak të kostos së betonit të prodhuar.

Çimento që përdoret për beton duhet të zgjidhet referuar standarteve të përcaktuara dhe të ruhet në kushtet e përshtatshme (psh në ambiente të thatë) atëhere kjo çimento është e duhura.




**Figura 2.1.2.1, 2.1.2.2: Fabrikë e prodhimit të betonit**

Autorët **Philip S. Zacarias, ShawCor Ltd** kanë vërtetuar që: duhet të përmendim edhe rëndësinë që ka raporti agregat/çimento. Për një volum të njëjtë betoni përqindja e çimentos në raport me rërën rritet pasi sipërfaqja e materialit që do të lidhet rritet. Rritja e sasisë së çimentos e pa shoqëruar me rritjen e sasisë së ujit do të thotë zvogëlim të raportit ujë/çimento. Mbështetur në rekomandimet e Sika handbook është ndërtuar tabela 2.31, si mëposhtë:

**Tabela 2.1.2.1: Sasia minimale e çimentos për materiale inertenatyrale dhe të thyera**

| Sasia minimale e përmbajtjes së Çimentos e rekomanduar nga Sika |                        |
|-----------------------------------------------------------------|------------------------|
| Diametri max. i grimeve                                         | Agregat i rrumbullakët |
| 8 mm                                                            | 380 kg/m <sup>3</sup>  |
| 16 mm                                                           | 330 kg/m <sup>3</sup>  |
| 32 mm                                                           | 300 kg/m <sup>3</sup>  |

Mbështetur në konkluzionet e nxjerra nga Philip S. Zacarias, ShaëCor Ltd. në studimin *”Alternative Cements For Durable Concrete In Offshore Environments”* është ndërtuar një model matematikor i varësisë së raportit ujë/çimento dhe rezistencë mekanike kur janë përdorur dy tipe çimentosh CEM 42.5® dhe CEM 32.5®, të paraqitura në grafikët e mëposhtëm figura 13:



**Figura 2.1.2.3: Qëndrueshmëria mekanike në shtypje në funksion të raportit u/ç për dy çimento me kohë të ndryshme të maturimit në moshën 1 - 3 - 7 dhe 28 ditë.**


Në studime të kryera me afat të gjatë, si edhe në studimin tonë, rezultatet kanë treguar në mënyrë të qartë se betonet me raporte të ulët ujë / çimento janë betone jetëgjatë, duke marrë parasysh edhe përbërjen e çimentos Portland të përdorur për prodhimin e betonit.

### 2.1.2 Ndikimi i raportit ujë/çimento, në betonin e freskët

Raporti ujë/çimento i betonit duhet të llogaritet dhe kontrollohet në varësi të përmbajtjes së çimentos dhe duke e korrigjuar referuar ujëthitjes së materialeve inerte.

Me raport ujë/çimento do të kuptojmë raportin ndërmjet sasisë faktike të ujit të përdorur dhe sasisë së çimentos të përdorur në betonin e freskët. Ndikimi i këtij raporti është i pranishëm në të gjitha vetitë e betonit të zakonshëm por mënyrë të veçantë në betonet jetëgjatë. Ndikimi i raportit u/ç është analizuar nga studiues të ndryshëm por edhe nga ne në këtë studim. Kështu:

- Sa më i lartë të jetë raporti ujë/çimento, aq më e madhe do të jetë hapësira midis grimcave të materialeve inerte të betonit dhe aq më i madh do të jetë volumi i boshllëqeve të krijuara në beton. Pra ndikon në rritjen e porozitetit në beton.
- Raporti ujë/çimento ndikon në rezistencën mekanike të betonit, që referuar Neville, fq 271, "Properties Of Concrete, fourth and final edition", varësi e shprehur kjo në grafikun 2.27 si më poshtë:



**Figura 2.1.2.4: Lidhja midis rezistencës 7 ditore dhe raportit uje/çimento për betone të prodhuara me çimento Portland me ngurtësim të shpejtë**  
(Marrë nga Neville, fq 271, "Properties of Concrete, fourth and final edition")

**Figura 2.1.2.5: Dalë nga rezultatet tona eksperimentale**

Në testimet e realizuara në pjesën eksperimentale, analizat e rezistencës mekanike të betonit, për një moshë të caktuar dhe për kushte mjedisore të dhëna, për një sasi të caktuar çimento dhe për një ngjeshje të duhur treguan që kjo rezistencë do të varet nga raporti ujë/çimento.

- Një raport më i ulët ujë/çimento do të thotë më pak ujë, ose më shumë çimento dhe punueshmëri më e ulët që ndikon në ngurtësimin më me vështirësi të betonit dhe në marrjen e një rezistencë mekanike më të ulët.
- Raporti ujë/çimento, dmth një sasi uji më e madhe se recepturat, ndikon në krijimin e plasaritjeve gjatë tkurrjes së betonit në procesin e ngurtësimit.

Ndikimi i këtij raporti shkon edhe më tej pasi ai ndikon edhe në jetëgjatësinë e betonit. Analizat e testeve tregojnë që ndryshimit të raportit ujë/çimento i korrespondon ndryshimi i sistemit të poreve që krijohen gjatë procesit të ngurtësimit të betonit. Sa më i dendur të jetë betoni i prodhuar, pra sa më pak pore të ketë aq më e lartë do të jetë qëndrueshmëria dhe jetëgjatësia e betonit e cila nënkupton rezistencën që paraqet betoni për të mos lejuar depërtimin e agresivitetit të klasave të ekspozimit të strukturës.

### 2.1.3 Ndikimi i materialit inert, në betonin e freskët

Pothuajse 75-80 % e peshës dhe vëllimit të betonit zihet nga agregatet, prandaj ato ndikojnë në vetitë e ndryshme të betonit. Meqë Materialet inerte janë më të lira se sa çimentoja, përdorimi i tyre në betone është ekonomik duke patur parasysh qëndrueshmërinë dhe jetëgjatësinë e betoneve në kushte ambjentale të ndryshme.

Materiali inert:

- Të vlerësohet mirë kurba e shpërndarjes së madhësisë së grimcave
- Të mbahet e ulët përmbajtja e materialeve inerte të imët
- Të përshtatet përmbajtja e binderit për të arritur një përmbajtje të kënaqshme të imët.

Të përmbledhura jepen referuar standardit në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 2.1.3.1: Përmbajtja në % e grimcave të imta në agregatët e përdorura**

|                                                                                                        |                                       |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------|
| Vlerat standarte për përbërjen më të imët kokrrizore (përberja $\leq 0.125$ mm) referuar EN 206-1:2000 |                                       |
| <b>Grimca <math>\phi</math> 8 mm</b>                                                                   | <b>Grimca <math>\phi</math> 16 mm</b> |
| 450 kg/m <sup>3</sup>                                                                                  | 400 kg/m <sup>3</sup>                 |
| Rekomandimet nga Sika                                                                                  |                                       |
| <b>Maksimumi i <math>\phi</math> së grimcave</b>                                                       | <b>Agregat i rrumbullakët</b>         |
| 8 mm                                                                                                   | 500 kg/m <sup>3</sup>                 |
| 16 mm                                                                                                  | 425 kg/m <sup>3</sup>                 |
| 32 mm                                                                                                  | 375 kg/m <sup>3</sup>                 |

Në përdorimin e materialeve inerte, referuar S SH EN 933-1 dhe S SH EN 12620, duhet të merren parasysh vetitë fiziko-kimike dhe mineralogjike - petrografike si dhe karakteristikat e tyre .

**C. ARUMand A.O. OLOTUAH (2006)** kanë trajtuar ndikimet e materialeve inertenë betonin jetëgjatë që poi tregojmë më poshtë p.sh:

- Lloji i materialit inert në varësi të vendburimit. Materialet inertenatyrore që vijnë nga depozita minerale natyrore. Materialet inerte i nënshtrohen vetëm përgatitjeve mekanike dhe/ose larjes.  
Materialet inerte ashpër nga masivet malore: vijnë nga depozita minerale. I nënshtrohet eksplodimit të shtresave gjeologjike, pra është prezente mundësia e shkatërrimit më parë të strukturës së tyre.
- Forma dhe struktura e kokrrizave pas thyerjes dhe fraksionimit, e cila preferohet të jetë kubike ose e rrumbullakët.
- Qëndrueshmëria mekanike ose në shtypje e materialit inert e cila ndikon drejtpërdrejt në rezistencën e betonit.
- Duhet të kenë dendësi sa më të madhe të mundshme, veti kjo që ndikon në rezistencën e betonit sinë grafikun e mëposhtëm 2.1.3.1.




Figura 2.1.3.1: Ndikimi i formës me cepa të materialeve inerte në pore

- Pastërtia e materialeve inerte nga baltërat apo materialet e ndryshme organike.
- Duhet të kenë sipërfaqe të ashpra. Ashpërsia e sipërfaqes së materialeve inerte bën që të **kërkojnë më shumë çimento** dhe sigurojnë lidhje më të mirë.
- Përmbajtja e tyre në beton duhet të jetë në raporte të caktuara fraksionimi, pasi në brumin e betonit kemi të pranishëm edhe Materiali inertn e hollë (rërën) dhe agtregatin e trashë (çakëll apo granil 1 dhe 2) të paraqitura grafikisht në figurën 2.1.3.2.




Figura 2.1.3.2: Ndikimi i trashësisë së materialit inert në varësinë ndërmjet depërtueshmërisë dhe rezistencës në shtypje

Respektimi i këtyre rapoteve ndikon në punueshmërinë dhe në rezistencën e betonit. Uniformiteti dhe cilësia e betonit të prodhuar ndikojnë edhe në jetëgjatësinë e tij; si edhe buxhetin nëse nuk është gjetur një zgjidhje ekonomike.

- Madhësia optimale e materialeve inerte, e ashtuquajtura  $D_{max}$ , me ndikim shumë të madh në vetitë dhe koston e betonit.

#### 2.1.4 Ndikimi i kushteve ambjentale. Klasat e ekspozimit, ujë deti

Jetëgjatësia e betonit mund të perkufizohet si:

*Aftësia e materialit të betonit për t'i duruar klasave të ekspozimit të veprimeve agresive të mjedisit në të cilat ai punon, pa u shkatërruar.*

Rritja e jetëgjatësisë së betonit dhe jetëgjatësisë së strukturës së betonit arrihet vetëm me betonet jetëgjatë që janë perkufizuar si produkte të cilat janë në gjendje të përballojnë jovetëm ngarkesat statike e dinamike por edhe veprime të ambjentit, që shpesh herë këto të dytë janë edhe më të rrezikshme.

Të realizosh një beton jetëgjatë do të thotë të realizosh një beton rezistent ndaj veprimit agresiv të kushteve ambjentale, të cilat përfaqësohen nga klasat e ekspozimit, që në mënyrë grafike paraqiten në figurën 2.1.4.1, të mëposhtëm:




Figura 2.1.4.1: Paraqitja grafike e klasave të ekspozimit të betonit referuar EUROCOD-it.

Që të sigurohet jetëgjatësia e strukturave të betonit duhet të merren parasysh klasat e ekspozimit mjedisor në varësi të të cilave përdorim sasinë dhe llojin e duhur të çimentos dhe një raport të caktuar ujë/çimento duke bërë të mundur marrjen e betonit jetëgjatë për një klasë të veçantë ekspozimi të dhëna në tabelën e mëposhtme:

Klasat e ekspozimit në funksion të kushteve ambjentale jepen në tabelën e mëposhtme 2.1.4.1, referuar standardit S SH EN 206-1:

**Tabela 2.1.4.1: Klasat e ekspozimit në funksion të kushteve ambjentale (S SH EN 206-1)**

| <b>Emërtimi i klasave</b>                                                     | <b>Përshkrimi i ambjentit të ekspozimit</b>                             |
|-------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------|
| <b>1 – Asnjë risk nga korrozioni i armaturave ose nga veprimi mbi betonin</b> |                                                                         |
| X <sub>0</sub>                                                                | shumë i thatë                                                           |
| <b>2 – Korrozioni i armaturës i shkaktuar nga karbonatimi i betonit</b>       |                                                                         |
| XC <sub>1</sub>                                                               | i thatë                                                                 |
| XC <sub>2</sub>                                                               | i lagësht, rrallëherë i thatë                                           |
| XC <sub>3</sub>                                                               | lagështi mesatare: e lartë                                              |
| XC <sub>4</sub>                                                               | periodikisht i thatë dhe i lagur                                        |
| <b>3- Korrozioni i shkaktuar nga kloruret</b>                                 |                                                                         |
| XD <sub>1</sub>                                                               | lagështi mesatare                                                       |
| XD <sub>2</sub>                                                               | i lagur, rrallëherë i thatë                                             |
| XD <sub>3</sub>                                                               | periodikisht i thatë dhe i lagur                                        |
| <b>4 – Korrozioni i shkaktuar nga kloruret e ujit të detit</b>                |                                                                         |
| XS <sub>1</sub>                                                               | ekspozimi ndaj kriprave detare por jo në kontakt direkt me ujin e detit |
| XS <sub>2</sub>                                                               | i zhytur                                                                |
| XS <sub>3</sub>                                                               | në zonat detare, në zonat objekt i spërkatjeve                          |
| <b>5 – Veprimi nga ciklet ngrirje/shkrirje</b>                                |                                                                         |
| XF <sub>1</sub>                                                               | shkallë mesatare e mbingopjes, në mungesë të agjentëve shkrirës         |
| XF <sub>2</sub>                                                               | shkallë mesatare të mbingopjes, në prezencë të agjentëve shkrirës       |
| XF <sub>3</sub>                                                               | shkallë e larte e mbingopjes, në mungesë të agjentëve shkrirës          |
| XF <sub>4</sub>                                                               | shkallë e larte e mbingopjes, në prezencë të agjentëve shkrirës         |
| <b>6 – Veprimi kimik</b>                                                      |                                                                         |
| XA <sub>1</sub>                                                               | agresivitet i dobët                                                     |
| XA <sub>2</sub>                                                               | agresivitet i mesëm                                                     |
| XA <sub>3</sub>                                                               | agresivitet i lartë                                                     |

Duke ju referuar **Mario Collepari dhe Luigi Coppola**, në “Ekspozimi i betoneve ndaj klorureve të ujit të detit”; në Enco Journal N°10, si dhe mbështetur në EN 206, korrozioni i hekurit në strukturat betonarme rrezikohet nga kloruret nga tre situata ambjentale:

- Nga kloruret me origjinë detare ( klasa e ekspozimit XD)
- Nga kloruret me origjinë detare ( klasa e ekspozimit XD)
- Nga kloruret që vijnë nga kriprat e patretshme ( klasa e ekspozimit XF)

Të gjitha referencat emësipërme tregojnë për ndikimin e kushteve ambjentale të cilat reflektohen në dobësimin deri në shkatërrim të betonit dhe të strukturave të tij. Prandaj marrja parasysh e klasave të ekspozimit, që në procesin e projektimit të strukturave, është shumë e rëndësishme.

Kërkesat e jetëgjatësisë së betonit lidhur me klasat e ekspozimit jepen në tabelën 2.1.4.2 të mëposhtme:

**Tabela 2.1.4.2: Kërkesat e jetëgjatësisë lidhur me kushtet e mjedist për beton të prodhuar me çimento Portland 32.5R, dhe Dmax 32 mm.**

| <b>u/ç max</b> | <b>Përmbajtja minimale e çimentos (kg/m<sup>3</sup>)</b> | <b>Qëndrueshmëria karakteristike minimale R<sub>ck</sub>(N/mm<sup>2</sup>)</b> | <b>Klasat e ekspozimit Referuar tabelës S SH EN 206-1</b>                                                  |
|----------------|----------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| 0,60           | 280                                                      | 30                                                                             | XC <sub>1</sub> , XC <sub>2</sub>                                                                          |
| 0,55           | 300                                                      | 37                                                                             | XC <sub>3</sub> , XF <sub>1</sub> , XA <sub>1</sub> , XD <sub>1</sub>                                      |
| 0,50           | 320                                                      | 37-40                                                                          | XS <sub>1</sub> , XD <sub>2</sub> , XF <sub>2</sub><br>XA <sub>2</sub> , XF <sub>3</sub> , XC <sub>4</sub> |
| 0,45           | 350                                                      | 45                                                                             | XS <sub>2</sub> , XS <sub>3</sub> , XA <sub>3</sub> ,<br>XD <sub>3</sub> , XF <sub>4</sub>                 |

**Nga studimet është provuar që nën veprimin e ujit të detit në strukturat e betonit ndodh procesi i këmbimit në të cilin kalçiumi i ndodhur në hidroksid silikat kalçiumi zëvendësohet me magnezin për të formuar hidroksid silikat magnezi, i cili nuk ka aftësi lidhëse ose veshje e sipërfaqes së jashtme të betonit**

### **2.1.5 Neglizhenca dhe kontrolli jo i duhur në kantjeret e ndërtimit**

1- Defektet në procesin e betonimit të strukturës në kantjerin e ndërtimit.

- Realizimi jo korrekt i punimeve të hekurit. Vendosija e hekurit në strukturën betonarme, me distancatorë të duhur dhe referuar standardit është kusht i domosdoshëm që hekuri të marrë shtresën mbrojtëse të nevojshme. Ndodh që hekuri të dalë edhe në sipërfaqen e strukturës së betonuar, i gatshëm për tu korroduar.
- Pastrimi i armaturës së drurit përpara betonimit të strukturës. Ky defekt pengon lidhjen e betonit të vjetër me betonin e ri duke krijuar premisë për plasaritje të strukturave të betonit.
- Hedhja e betonit në strukturë jo referuar kushteve teknike. Ndodh që betonohet nga një lartësi më të madhe se standardi e kjo bën fragmentimin e materialeve inerte dhe është krijimi i boshllëqeve në elementin betonarme.
- Ngjeshja jo e mirë gjatë betonimit. Në qoftë se betoni nuk do të ngjishet si duhet do të marrim një beton jo me densitetin e llogaritur, një beton me porozitet të lartë, një beton me pore të padëshirueshme për betonin jetëgjatë, si ai i paraqitur në figurën 2.1.5.1, 2.1.5.2.



**Figura 2.1.5.1, 2.1.5.2: Shembuj të ngjeshjes jo të mirë të betonit në strukturën e betonit, ish Pishina Durres**

- Porositeti i betonit, i krijuar gjatë procesit të hedhjes së betonit në strukturë, është një faktor i rëndësishëm përcaktimin e qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së betonit e sidomos në një mjedis detar.
- Fenomeni i segregimit ose shtresëzimit të betonit.
- Mostrajtimi i duhur i betonit gjatë procesit të ngurtësimit.
- Sasia e lartë e ujit, mbi recepturën e betonit. Të mos lejohet shtimi i sasisë së ujit në kantjerin e ndërtimit.

## **2.2 VETITË E BETONEVE JETËGJATË**

### **2.2.1 Qëndrueshmëria në shtypje ( $f_{cm}$ ) dhe Moduli i Elasticitetit në betonin e ngurtësuar**

Betoni klasifikohet në klasa në bazë të rezistencës së tij në shtypje  $R_{ck}$  ose  $f_{ck}$ . Qëndrueshmëria karakteristike  $f_{ck}$  perkufizohet mbi bazën e vlerave të mara nga prova laboratorike të shtypjes mono aksiale të kubikeve të betonit 150 mm ( $H/D=1$ ), të trajtuar, të maturuar 28 ditë; ndërsa qëndrueshmëria  $f_{ck,cyl}$  perkufizohet mbi bazën e vlerave të mara nga prova laboratorike të shtypjes monoaksiale të mostrave cilindrike 150 mm me diametër 300 mm me lartësi ( $H/D=2$ ).

Midis dy vlerave ekziston mardhënia e mëposhtme:

$$f_{ck} = 0,83 R_{ck} \text{ (per } H/D=2)$$

Referuar normativave për një projektim sa më korrekt dhe zbatim të përpiktë në një vepër ndërtimi, betoni specifikohet në funksion të klasës së tij të rezistencës, klasës së konsistencës (viskozitet-ngjizosje) dhe në varësi të dimensioneve nominale të materialeve inerte. Parametra të specifikuar në laboratorët e liçencuar për matjetë të dhenave teknike të materialeve të ndërtimit.

Klasifikimi i betoneve bëhet mbi bazën e klasave të rezistencës, që në përputje me standardin S SH EN 13791 dhe EN 206-1, jepen në tabelën 2.2.1.1, 2.2.1.2, si më poshtë:

**Tabela 2.2.1.1, 2.2.1.2: Klasat e Rezistencës në shtypje referuar Standardit S SHEN 13791 dhe Eurocod 2.**

| <b>Klasa e Forcave Shtypëse</b> | <b>Forcat minimale cilindrike karakteristike</b><br>$f_{ck,cyl} \text{ -- N/mm}^2$ | <b>Forcat minimale kubike karakteristike</b><br>$f_{ck,cube} \text{ -- N/mm}^2$ | <b>Kategoritë e betonit</b> |
|---------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| C 8 / 10                        | 8                                                                                  | 10                                                                              | Jo strukturore              |
| C 12 / 15                       | 12                                                                                 | 15                                                                              |                             |
| C 16 / 20                       | 16                                                                                 | 20                                                                              | Të zakonshme                |
| C 20 / 25                       | 20                                                                                 | 25                                                                              |                             |
| C 25 / 30                       | 25                                                                                 | 30                                                                              |                             |
| C 30 / 37                       | 30                                                                                 | 37                                                                              |                             |
| C 35 / 45                       | 35                                                                                 | 45                                                                              |                             |
| C 40 / 50                       | 40                                                                                 | 50                                                                              |                             |
| C 45 / 55                       | 45                                                                                 | 55                                                                              |                             |
| C 50 / 60                       | 50                                                                                 | 60                                                                              | Veti të lartë               |
| C 55 / 67                       | 55                                                                                 | 67                                                                              |                             |
| C 60 / 75                       | 60                                                                                 | 75                                                                              |                             |
| C 70 / 85                       | 70                                                                                 | 85                                                                              | Rezistencë të lartë         |
| C 80 / 95                       | 80                                                                                 | 95                                                                              |                             |
| C 90 / 105                      | 90                                                                                 | 105                                                                             |                             |
| C 100 / 115                     | 100                                                                                | 115                                                                             |                             |

|                                                       |        |        |        |        |        |        |
|-------------------------------------------------------|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Klasa e betonit (MB)                                  | 15     | 20     | 30     | 40     | 50     | 60     |
| Klasat e soliditetit në shtypje, referuar Eurokodit 2 | C12/15 | C16/20 | C25/30 | C30/37 | C40/50 | C50/60 |

Sipas **Neville (2002)**: Qëndrueshmëria në shtypje varet nga:

- Raporti ujë/çimento i përcaktuar në recepturën e betonit të projektuar. Nga testimet qëndrueshmëria është invers i raportit ujë/çimento.
- Sasia faktike e ujit në përmbajtjen e brumit të betonit, pasi duhet të merret parasysh edhe sasia e ujit të lirë.
- Faktor tjetër që ndikon në rezistencën e betonit është realizimi i ngjeshjes së betonit e cila krijon rritjen e porozitetit. Në mënyrë strikte thuhet që qëndrueshmëria e betonit varet nga volume it ë gjitha hapsirave në beton.
- Ndikimi i llojeve të materialeve inerte në rezistencën e betonit. Në veçanti forma dhe tekstura e materialeve inerte. Ky ndikim varet nga raporti ujë/çimento në brumin e betonit. Kështu për raportin ujë/çimento nën 0.4, përdorimi i materialit inert të thyer ndikon në rezistencën e betonit deri në 38% më shumë se kur përdoren materiale inertenatyrle.
- Ndikimi i moshës së maturimit në rezistencën mekanike. Qëndrueshmëria rritet me kalimin e kohës por referuar një grafiku të dhënë në tabelen e mëposhtme 2.1.2.3.

Qëndrueshmëria në shtypje mund të vlerësohet mbi bazën e provave cilindrike ose kubike. Klasifikimi i këtyre betoneve bëhet mbi bazën e klasave të rezistencës, në përputje me standardin S SH EN 13791 dhe EN 206-1.

Qëndrueshmëria në shtypje e betonit rritet me rritjen e moshës. Kjo rritje është pothuajse linear deri në 28 ditë dhe më tej ritmet e rritjes zvogëlohen. Po ti referohemi “**Concrete Mix Design Procedure & Example**”, ndërtojmë tabelën 2.2.1.3si më mëposhtë.

**Tabela 2.2.1.3: Relacioni ndërmjet moshës dhe rritjes së rezistencës në shtypje të betonit**

| Mosha - ditë | Rezistenca në shtypje % |
|--------------|-------------------------|
| 1 ditë       | 16%                     |
| 3 ditë       | 40%                     |
| 7 ditë       | 65%                     |
| 14 ditë      | 90%                     |
| 28 ditë      | 99%                     |

**A. Barbucci, DICheP:** Moduli i elasticitetit shpreh deformimin e betonit gjatë ngurtësimit. Ky fenomen është një nga fenomenet më komplekse të degradimit të betonit është se shkaktohet nga deformimet (nga formimi ettringitve). Ky term përdoret për të treguar një degradim të materialit bazuar në formimin e ettringite (një sulfo-kalçium sherbet aluminat) në mjediset agresive.

**Mamlouk, Michael S. (2011):**Mosha e testimitmë e kërkuar për përcaktimin e rezistencës në shtypje është 7 ditore dhe 28 ditore. Qëndrueshmëria në shtypje e kubeve ndikohet nga madhësia e mostrave. Zvogëlimi i tyre çon në rritje e gabimeve në testime.

## 2.2.2 Qëndrueshmëria në tërheqje në betonin e ngurtësuar

Qëndrueshmëria në tërheqje matet në mënyrë indirekte referuar ASTM C496.

**Mamlouk, Michael S. (2011):** Vlerat normale të rezistencës në tërheqje variojnë nga 2.5 MPa deri në 3.1MPa (referuar Neville, 1996). Qëndrueshmëria në tërheqje është rreth 10% e rezistencës në shtypje.

## 2.2.3 Përshkueshmëria ose përmbajtja e klorureve

Përshkueshmëria e kriprave, sulfateve dhe në veçanti klorureve në strukturat e betonit përcaktohet në mënyrë indirekte me përmbajtjen e klorureve në beton. Kjo përmbajtje nuk duhet të kalojë vlerat e dhëna në standardin shtetëror, si në tabelën 10 më poshtë:

**Tabela 2.2.3.1: Përmbajtja maksimale e klorureve në beton, referuar S SH EN 206-1**


| Përdorimi i betonit                                                                                                                | Klasa e përmbajtjes së betonit <sup>a</sup> | Përmbajtja maksimale e Cl <sup>-</sup> në masë të çimentos |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|------------------------------------------------------------|
| Nuk përmban armaturë prej çeliku ose metale të tjera të inkastruar me përjashtim të pajisjeve ngjitëse rezistente ndaj korrozionit | Cl 1.0                                      | 1.0 %                                                      |
| Përmban armature prej çeliku ose metale të tjera të inkastruar                                                                     | Cl 0.20                                     | 0.20 %                                                     |
|                                                                                                                                    | Cl 0.40                                     | 0.40 %                                                     |
| Përmban armaturë të paratensionuar                                                                                                 | Cl 0.10                                     | 0.10 %                                                     |
|                                                                                                                                    | Cl 0.20                                     | 0.20 %                                                     |

Vlerat e dhëna në tabelën e mësipërme përmbajtja e klorureve matur referuar (referuar S SHEN: 196-2 dhe S SHEN 1744/1); AASHTO T 277 (ASTM C 1202). Siç shihet përmbajtja e lejueshme e klorureve në beton në masë të çimentos është 1 %.

Sasia e klorureve në beton na vjen nga çimento, uji dhe Materialet inertedhe nganjëherë nga shtesat e lëngshme. Përmbajtja e llogaritur në standart është shumatore e sasisë së klorureve të përbërësve të tij.

Referuar **C. ARUM1 and A.O. OLOTUAH2:**Sasia e klorureve të nevojshme për fillimin e korrozionit të hekurit është pjesërisht i varur nga vlera e pH e ujit në porët e betonit. Për një vlerë të pH < 11.5 korrozioni i hekurit mund të ndodhë pa prezencë të klorureve. Me vlerën e pH > 11.5 për fillimin e korrozionit të hekurit është e nevojshme një sasi e konsiderueshme kloruri.


**Neville** thotë betoni që ndodhet nën veprimin e ujit të detit është nën ndikimin e veprimeve kimike dhe fizike. Kjo përfshin sulmin kimik, ndikimi i klorideve në korrozionin e hekurbetonit, ndikimi i ngrirje shkrirjeve, korrozionit nga kriprat, gërryerjes nga rërat dhe nga akujt.



**Figura 2.2.3.1: Varësia ndërmjet raportit u/ç dhe depertueshmerise. (Sipas Neville)**

Ndërtimet detare që i përkasin klasave të ekspozimit XS, janë të ekspozuar ndaj substancave shumë agresive, sepse uji i detit përbëhet kryesisht nga klorureve dhe sulfatëve. Ndikimi i klorureve në jetëgjatësinë e betonit fillon me korrozionin e hekurit ndërsa efektet e sulfatëve ndikojë në përkeqësimin e vetë betonit .

Në studimin e autorit **Philip S. Zacarias, ShawCor Ltd.** "Alternative Cements for Durable Concrete in Offshore Environments", në kapitullin "Chemical Attack of Concrete by Seawater" (Ndikimi kimik i betonit nga uji i detit), është trajtuar si veprojnë kimikisht kloruret e ujit të detit me betonin dhe konkretisht me mineralet që përmban çimento, duke krijuar një shtresë mbrojtëse të papërshkueshme nga uji. Në studim paraqiten reaksionet kimike të mëposhtme:



nga të cilat prodhohen:

|                                           |                                                                                                   |
|-------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|
| $\text{Ca(OH)}_2$                         | calcium hydroxide (portlanditë)                                                                   |
| $\text{MgSO}_4$                           | magnesium sulphate                                                                                |
| $\text{CaSO}_4 \cdot 2\text{H}_2\text{O}$ | calcium dehydrate (gypsum)                                                                        |
| $\text{Mg(OH)}_2$                         | magnesium hydroxide (brucite)                                                                     |
| $\text{SiO}_2 \cdot \text{H}_2\text{O}$   | hydrosilicate (silica gel)                                                                        |
| C-S-H                                     | calcium silicate hydrate ( $\sim 3(\text{CaO}) \cdot 2(\text{SiO}_2) \cdot 8\text{H}_2\text{O}$ ) |
| M-S-H                                     | magnesium silicate hydrate ( $4(\text{MgO}) \cdot \text{SiO}_2 \cdot 8.5\text{H}_2\text{O}$ )     |

Magnezium silikatet, krijojnë në sipërfaqen e betonit një shtresë mbrojtëse për betonin.

Përsa më lart , **M.Colleparidi** , ka ndërtuar këtë tabelën e mëposhtme:


**Tabela 2.2.3.2: Ndikimi i raportit ujë/çimento në kohën e depërtueshmërisë së klorureve, për një shtresë mbrojtëse 4 cm**

| Raporti U/Ç | Koha    |
|-------------|---------|
| 0.60        | 7 muaj  |
| 0.45        | 5 vite  |
| 0.30        | 65 vite |

## 2.2.4 Përshkueshmëria e ujit

Qëndrueshmëria ndaj depërtimit të ujit në kubet e betonit quhet e përshtatshme kur vlerat e depërtimit të ujit rezultojnë më të vogla se 50 mm dhe vlera mesatare e depërtimit të jetë më pak se 20 mm. Në këto raste raporti ujë/çimento nuk duhet të kalojë 0.55. Përshkueshmëria e ujit matet referuar Standardit S SHEN 12390-8/ 2002.

Referuar **SIKA handbook**: Betoni i papërshkueshëm nga uji është ai beton që është i ngjeshur mirë. Për të përfituar një beton të ngjeshur, referuar kërkesave të llogaritura në projekt, duhet **së pari** të arrihet një kurbë sa më e mirë e shpërndarjes së grimcave, pra duhet të kemi parasysh shumë mirë raportin e fraksioneve të materialeve inerte që përdorim, grafik ky i dhënë në figurën 2.2.4.1. **Së dyti** një beton të ngjeshur e arrijmë nëpërmjet kontrollit të raportit ujë/çimento ose përdorimit të shtesave vullkanike, të cilët reduktojnë porozitetin kapilar e për rrjedhojë depërtimin e ujit.



**Figura 2.2.4.1: Përcaktimi i papërshkueshmërisë nga uji referuar EN 12390-8 (Marrë nga SIKA handbook)**

Analizimi i këtij grafiku nga Sika, nxjerr përfundimet që:

- Depërtueshmëria maksimale e ujit, në beton, duhet të jetë  $\leq 50$  mm, për raportin 0.45.
- Raporti maksimal ujë/çimento, për të pasur një depërtueshmëri të duhur, është 0.45.

### 2.2.5 Përmbledhje teorike

Në **përmbledhje** japim disa analiza dhe komente të përbërjes dhe vetive të çimentos, në përdorimin e saj në beton:

- Rekomandohet të përdoret një sasi çimento minimalisht e domosdoshme për të arritur rezistencën e kërkuar. Kjo ka disa avantazhe si dukshëm kosto e ulët ekonomike, përftojmë një sasi të kufizuar energjie të çliruar gjatë procesit të hidratimit, si dhe për të kontrolluar tkurrjen që ndikon në minimizimin e plasaritjeve të shkaktuara nga tkurrja.
- Sasia minimale e çimentos është e varur edhe nga karakteristikat e rërës dhe të materialit inert të trashë. Megjithatë, rritja e sasisë së çimentos do të çojë në rritjen e sasisë së ujit, që mund të sjellë rënie të rezistencës mekanike.
- Prezenca e flluskave të ajrit e ul rezistencën mekanike potenciale të klinkerit, por ndërkohë kjo mund të shmanget duke ndryshuar raportin e përbërjes ose duke ulur raportin u/ç dhe/ose duke rritur sasinë e çimentos.
- Pra shihet që sasia e çimentos së përdorur në recepturat e betonit duhet të shkojë në minimumin e duhur.

Specifikimi i kërkesës për porosinë e betonit duhet të respektojë rregullat e mëposhtme:

- Kërkesa e betonit duhet të bëhet vetëm nga inxhinieri i objektit dhe duke respektuar kërkesat e projektit. Në kërkesën e betonit, mbështetur në S SHEN 206-1: 2003, duhet të kërkojmë, psh beton soletë:
  - Klasa e betonit: **C30/37**
  - Klasa e ekspozimit: **XC<sub>4</sub>**
  - Diametri maksimal i materialit inert: **Dmax 32**
  - Klasa e konsistencës: **C<sub>3</sub>**
  - Densiteti : klasa e densitetit **D 2,0**
  - Beton i pompueshëm
  - Përmbajtja maksimale e klorureve: **Cl 0.1**

## KAPITULLI 3

### PROGRAM EKSPERIMENTAL

#### 3.1 TË PËRGJITHSHME

Ky kapitull, përshkruan fazën eksperimentale të punimit shkencorë që lidhet me përzgjedhjen e agregateve, me metodat e projektimit të përbërjeve të betonit, me mënyrën e përgatitjes dhe trajtimit të betonit, për kushtet në të cilat prodhohet dhe trajtohet betoni, duke synuar që të realizojmë një beton dhe struktura jetëgjata në kushte ambientale normale apo dhe në prezencë të ujit të detit.

Qëllimi i punimit të këtij kapitulli, ka qenë të krijojmë dhe besojmësefinalizimi i programit eksperimental për të prodhuar një beton jetëgjatë, që në punën tonë do të thoshim me rezistencë të lartë; që do të rezistojë për një kohë sa më të gjatë pa u shkatërruar ndaj veprimit të kushteve ambientale të ekspozimit. Kjo na ka shtyrë që në këtë fazë të punojmë një model bllok-skemë ku të përfshijmë në të gjithë faktorët; që ndikojnë në vetitë e betoneve jetëgjatë. Shohim figurën 3.1.1, më poshtë:




Figura 3.1.1: Faktorët që ndikojnë në rezistencën e betonit.

#### 1.2 METODOLOGJIA E PROJEKTIMIT DHE PRODHIMIT TË BETONIT

Në realizimin e recepturave të betonit jemi mbështetur në metodat kryesore të mix design si dhe në kondicionet që duhet të plotësojë betoni i prodhuar për të rezistuar në dy kushte ambientale të ndryshme, që ne i kemi emërtuar: Normale (N) dhe në kushte agresive në kontakt me ujin e detit, Agresive(A). Sipas S SHEN 206-1: 2003, për betonet e

ekspozuara në ujë deti, jemi përpjekur t'i qendrojmë „besnik“ në studimin tonë trajtimit në klasa e ekspozimit XS1, XS2, XS3, paraparë edhe në Standardin S SHEN 206-1:2003.

### **1.2.1 Projektimi i Recepturave të Përgatitjes së betonit (mix design)**

Për të përgatitur përbërjet e përzierjeve të betoneve, kam mbështetur dhe konsultuar një literaturë të konsiderueshme, si ato që parashikohen në standardin **S SHEN 206-1: 2003; BS: 10262-1982**, por edhe përvojën shqiptare në projektimin e betoneve, që me të drejtë duhet të vlerësohet dhe të zërë vendin e duhur.

Projektimi i përzierjeve që kanë shërbyer si bazë për të kryer testimet e betoneve është dashur të mbështetet në 3 parime kryesore:

- *Përzgjedhja e përbërësve*: materialeve inerte të hollë(rëra) dhe të trashë(zalli ose çakëlli), e çimentos, e ujit, e shtesave sa më të përshtatshëm në plotësim të kërkesave të standarteve.
- *Përcaktimi i përmbajtjes sasiore të përbërësve* në mënyrë që të përftojë një beton me veti fiziko-mekanike të njëtrajtshme, jetëgjatë dhe kosto sa më ulët.
- *Prodhimi, transporti, vendosja dhe trajtimi në vepër i betonit* t'i përgjigjet me rigozitet respektimit të normativave si projektuese ashtu dhe konditave mjedisore të ekspozimit. Me rëndësi të madhe konsiderojmë respektimin e ngjashëm të trajtimit të mostrave të testimit të betoneve të prodhuar.

### **Fazat kryesore të përcaktimit të përzierjeve të betonit**

- 1- Hartimi i Detyrës së kujdesshme të projektimit të përzierjeve të betonit,
- 2- Përzgjedhja e metodave për llogaritjet sasiore të komponentëve ose siç emërtohet Mixdesign,
- 3- Aplikimi programeve matematikore i Mixdesign të përzgjedhur dhe të adaptuar për rastin tonë të studimit,
- 4- Prodhimi i betonit në gjendje të freskët dhe përcaktimi i parametrave e vetive të përcaktuara,
- 5- Përgatitja e mostrave të testimit, trajtimi në dy kondita mjedisore të ndryshme: mjedis normal (N) dhe mjedis i ekspozuar në ujë deti (A),
- 6- Testimi i mostrave të provave, marrja e rezultateve dhe interpretimi i rezultateve të fituara.

Më poshtë, në mënyrë më detajuar po përshkruajmë ecurinë nga pikpamja teknologjike dhe teknike të fazave të mësipërme:

#### **1. Mbi detyrën e projektimit. Kërkesat për betonin e freskët:**

Kërkohet të projektohet një beton, i aftë jo vetëm të përballojë nderjet e brendshme që lindin nga veprimi i ngarkesave të jashtme por edhe t'i qendrojë veprimit agresiv të mjedisit agresiv të ujit të detit. Kubet e betonit do të testohen për vetitë e qëndrueshmërisë dhe të jetëgjatësisë.

Referuar standardit S SHEN 206-1: 2006, për kushtet ambientale të klasave XS<sub>1</sub>- XS<sub>3</sub> që i korespondojnë ekspozimit të ujit të detit, sipas të dhënave të tabelës 3.2.1.1 të dhënë më poshtë, kemi ndërtuar kërkesat për betonin si më lartë.

**Tabela 3.2.1.1: Vlerat e rekomanduara për betonin sipas S SHEN 206-1:2006**

|                                                      | Klasat e Ekspozimit       |                                         |                 |                 |
|------------------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------------------|-----------------|-----------------|
|                                                      | Asnjë risk nga korrozioni | Korrozioni nga kloruret në ujin e detit |                 |                 |
|                                                      | X <sub>0</sub>            | XS <sub>1</sub>                         | XS <sub>2</sub> | XS <sub>3</sub> |
| Raporti maksimal U/Ç                                 | -                         | 0.5                                     | 0.45            | 0.45            |
| Klasa e rezistencës minimale                         | C12/15                    | C30/37                                  | C35/45          | C35/45          |
| Përmbajtja minimale e çimentos ( kg/m <sup>3</sup> ) | -                         | 300                                     | 320             | 340             |
| Përmbajtja minimale e ajrit (%)                      | -                         | -                                       | -               | -               |
| * Marrë nga EN 206-1:2006                            |                           |                                         |                 |                 |

Si edhe referuar VKM nr. 679 datë 22.10.2004 “Për miratimin e rregullave teknike për përdorimin e betoneve strukturore” kushprehimisht citohet se: Në kushtet e një agresiviteti kimik, dhe për strukturat në det, të vendosura në zonat detare ose që janë objekt i lagës dhe tharjes të vazhduar, rekomandohet nga Komiteti Evropian i Betonit (CEB 1995) një përmbajtje sasiore minimale e çimentos prej **370 kg/m<sup>3</sup>** dhe një raport **u/ç prej 0,4**. Pë më tej, mbështetur në këto kërkesa ndërtuam pasqyrën e mëposhtme 3.2.1.2, sipas së cilës ne përcaktuam detyrën e projektimit të recepturës së betonit.

**Tabela 3.2.1.2: Kërkesat teknike për MixDesign e betonit të kërkuar**

| Karakteristikat conform EN 206-1     | Vlerat tona te projektit                                                       |
|--------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|
| Qëndrueshmëria në shtypje 28 ditore  | C35/ 45                                                                        |
| Beton i pompueshëm                   | S <sub>4</sub> ( 160-210mm)                                                    |
| Diametri maksimal i materialit inert | D max. 20-25 mm                                                                |
| Klasa e ekspozimit të kubikëve       | Normale (N) dhe XS (A)ujë deti                                                 |
| Raportet ujë/çimento                 | 0.45; 0.4; 0.35                                                                |
| Llojet e materialeve inerte          | 2 tip lumi + 1 tip mali                                                        |
| Dendësia e betonit                   | Klasa D2,0                                                                     |
| Çimento e përdorur                   | CEM 1 Portland “ Titan”                                                        |
| Shtesa , aditivi                     | E njëjtë për të gjitha prodhimet superplastifikatori”Chryso-Fluid Premia 180”. |

Dhe konkretisht kemi realizuar këto materiale dhe vetitë respektive;

- Densiteti i betonit ka qenë 2200-2400kg/m<sup>3</sup>, për betone strukturore.
- Agregatet, janë zgjedhur nga karrierat e masive shkëmbore në Krujë dhe përpunimi i tyre në një impjant të thyerjes e fraksionimit në Fushë Krujë (materiale inertetë thyera) dhe të tipit aluvional, lumi Erzen, vendburimi në Romanat (materiale inertetë thyera dhe natyrale) dhe vendburimi në Milot, lumi Mat (materiale

inertenatyrale), me rëra me modul imtësie rreth 2.60, densitet 2.58 dhe densitet vëllimorë rreth 1600 kg/m<sup>3</sup>.

- Nuk kërkuam përmbajtje të ajrit.

## 2. Përzgjedhja e metodave për llogaritjet sasiore së komponentëve ose siç emërtohet Mixdesign

Përzgjedhja e metodave për llogaritjet sasiore së komponentëve ose siç emërtohet Mixdesign, ka kaluar në fazat e mëposhtëme, duke umbështetur në standartinshqiptar **S SH EN 206-1:2003**, si dhe në standartet botërore ekzistuese.

**Hapi 1:** *Zgjedhja e klasës së konsistencës*; në bazë të S SH EN 206-1:2006. Autorë të ndryshëm kohën e formimit të strukturës së betonit e indetifikojnë me konsistencën e tij, respektivisht me raportin u/ç. Kur ne llogarisim përbërjen e betonit klasa e konsistencës duhet të jetë e përcaktuar që në projekt në mënyrë që të shmangim shtresëzimin e betonit.

Zgjedhëm konsistencën e betonit të klasës “S4”, dmth me ulje të konusit 160-200mm, në përputhje me kërkesat e punueshmërisë që kërkon projekti.

**Hapi 2:** *Zgjedhja e madhësisë maksimale të materialeve inerte* ASTM C33.

Edhe kjo e dhënë duhet të jepet nga projektuesi në varësi të llojit të elementeve konstruktive të vetë objektit. Zgjedhja e D<sub>max</sub> bëhet në përputhje të standardit S SHEN 12620

**Hapi 3:** *Llogaritja e sasisë së ujit*. sipas standardit S SH EN 1008 përcakton silësinë e ujit me karakteristika të ujit të pijshëm.

Llogaritja e sasisë së ujit mbështet në klasën e konsistencës së dhënë si dhe në disa faktorë siç janë: madhësia maksimale e materialeve inerte, forma e tyre, imtësia e tyre. Në tabelat e dhëna nga standardi ne mund ta zgjedhim sasinë e ujit në varësi të madhësisë maksimale të materialit inert dhe konsistencës. Nga tabela 3.2.1.3 ne marrim sasinë e ujit për materiale inertetë thyera ndërsa për ato natyrale ne duhet të shtojmë, në çdo rast, edhe 18-20 kg ujë më shumë për m<sup>3</sup> beton.

Sasia e ujit të nevojshëm në recepturën e betonit, për një klasë punueshmërie të dhënë varet nga forma dhe madhësia maksimale e materialeve inerte. Më poshtë po japim sasinë e përafërt të kërkuar për materiale inertetë thyera dhe për materiale inerte natyrale(të rrumbullakosura).

**Tabela 3.2.1.3: Sasia e ujit të përdorur në beton në varësi të materialit inert**

| Forma e Materialeve inerte | Sasia e ujit të përdorur, kg/m <sup>3</sup> |
|----------------------------|---------------------------------------------|
| Çakëll i rrumbullakët      | 12                                          |
| Çakëll i thyer             | 21                                          |
| Çakëll natyral             | 27                                          |

Uji si material përbërës i betonit, reagon kimikisht me lëndën lidhëse, çimenton, gjatë fazës së hidratimit dhe ngurtësimit. Është shumë e rëndësishme, që pavarësisht origjinës, të ketë:

- Përmbajtje të ulët të kriprave minerale.
- Përmbajtje të ulët të lëndëve organike të tretura.
- Përmbajtje të ulët të lëndëve inorganike të tretura.

Përpara përdorimit të ujit që do të përdorim për prodhimin e betonit duhet të bëjmë analizat nëse plotësohen ose jo kërkesat e standardit.

Përshtatshmëria e ujit për prodhimin e betonit varet nga origjina e tij. Standardi S SHEN 1008 liston këto tipe si më poshtë:

- **Ujë i pijshëm:** i përshtatshëm për beton. Nuk ka nevojë të testohet.
- **Ujë i nxjerrë nga procese në industrinë e betonit** (psh uji larës): përgjithësisht është i përshtatshëm për betone (por duhet të plotësohen kërkesat në aneksin A të referuar këtij standardi).
- **Ujë tokë:** mund të jetë i përshtatshëm për beton por duhet të kontrollohet.
- **Ujë natyral i sipërfaqes dhe ujë nga proceset industriale:** mund të jetë i përshtatshëm për beton por duhet të kontrollohet.
- **Ujë deti:** mund të përdoret për struktura betonipor nuk është i përshtatshëm për betonarme apo të paratensionuar.
- **Ujëra të zeza:** nuk është i përshtatshëm për tu përdorur në betone.

Nëse sasia e ujit të recepturës është mbi sasinë e duhur, poroziteti i betonit të prodhuar e bën betonin të përshkueshëm ndaj ujit si dhe ndaj kriprave, pra e bën betonin dhe strukturën e betonit jo jetëgjatë ndaj ndikime agresive të kushteve ambientale.

Sasia e ujit të përdorur është përcaktuese nëse prodhojmë ose jo beton jetëgjatë. Përmbajtja e ujit në beton është shumatore i ujit që shtojmë në ujë dhe ujit që përmbajnë vetë Materialet inerte sipërfaqeve të tyre në formën e lagështirës që ato përmbajnë, e shprehur në mënyrë grafike e gjejmë te Neville si më poshtë në figurën 3.2.1.




Figura 3.2.1: Paraqitja me diagramë e lagështisë në materialeve inerte.

Kështu sasia e faktike që shtojmë në betonierë është diferencë e sasisë së ujit të llogaritur me ujin që thithin agregatet, aftësi që shprehet nëpërmjet koeficientit të thithjes ose absorbimit. Fomulat konkrete të llogaritjes janë si me poshtë:

$$\text{Lagështia} = (P_{\text{lag}} - P_{\text{that}}) / (P_{\text{that}} - P_{\text{tave}})$$

$$\text{Absorbimi} = (P_{\text{lag}} - P_{\text{that}}) / (P_{\text{lag}})$$

#### **Hapi 4:** *Zgjedhja e raportit ujë / çimento*

Uji si komponent tjetër i betonit është marrë nga pusi, me vetitë e ujit të pijshëm dhe gjithashtu në përputhje me EN 1008. Ndryshimi ndërmjet betonit të zakonshëm dhe atij jetëgjatë në lidhje me raportin u/ç është: në betonin e zakonshëm ky raport përfaqëson sasinë e ujit (*uji i shtuar + lagështia e lirë në agregat*) / sasinë e çimentos në njësinë e vëllimit m<sup>3</sup>, në betonet jetëgjatë sasia e ujit së bashku me shtesat në përzjerje (*uji i shtuar si dhe lagështia e lirë në agregat*) duke u përzjerë më parë me shtesat e lëngshme, për në Chryso-Fluid Premia, / sasinë e çimentos na jep atë që quhet raporti u/ç. Për betonet e zakonshme u/ç= 0.67-0.68, ndërsa për betonet jetëgjatë u/ç= 0.35-0.45. Në këtë kuadër sasia e ujit është e ndarë në dy pjesë: pjesa e parë është sasia e ujit që i nevojitet çimentos për hidratim normal dhe pjesa e dytë është sasia e ujit që i nevojitet betonit për tu vendosur me lehtësi në strukturë.

Për zgjedhjen e këtij raporti duhet të kemi parasysh dy kritere qëndrueshmëria dhe jetëgjatësia ose durabiliteti. Kur si prioritet kemi rezistencën atëherë ky raport do të jetë në varësi të llojit të çimentos dhe të klasave të ekspozimit.

Nëse do të kemi si prioritet jetëgjatësinë ky raport ose duhet të jepet nga projektuesi ose duhet të merret nga tabelat e standardit.

Në çdo rast, ne duhet të zgjedhim vlerën më të vogël të këtij raporti të dalë nga të dy kriteret e mësipërme.

#### **Hapi 5:** *Llogaritja e sasisë së çimentos ,.*

Nisur nga fakti që çimento S SH EN 206-1:2003, është një nga përbërësit kryesorë të betonit që ndikon drejtpërdrejt edhe në koston e tij, jemi munduar të ulim përdorimin e sasisë së çimentos, duke synuar njëkohësisht të fitojmë një beton me ngrirje të shpejtë dhe rezistencë të lartë në shtypje.

Gjatë fazës eksperimentale, për realizimin e këtij studimi kemi përdorur çimenton te tipit: CEM I /42.5®. Ndër testimet, sipas S SHEN 197-1, të vetive rezultoi se kjo lloj çimento ka përmbajtje të lartë të C3A dhe imtësi bluarje të lartë, pra ka ngrirje dhe ngurtësim të shpejtë, e cila ndihmon në formimin intensiv të strukturës së çimentos. Referuar S SHEN 206-1:2000 rekomandohet:

**Tabela 3.2.1.4: Përmajtja minimale e çimentos së sekomanduar për tu përdorur**

| Dmax e Kokrrizës | Agregat i rrumbullakët | Agregat i thyer       |
|------------------|------------------------|-----------------------|
| 8 mm             | 380 kg/m <sup>3</sup>  | 420 kg/m <sup>3</sup> |
| 16 mm            | 330 kg/m <sup>3</sup>  | 360 kg/m <sup>3</sup> |
| 32 mm            | 300 kg/m <sup>3</sup>  | 330 kg/m <sup>3</sup> |

Sasia e çimentos do të dalë përsëri nga dy kriteret nga hapi 3 dhe 4 si dhe nga kushti i jetëgjatësisë. Referuar S SH EN 206-1 dhe Referuar Mario Collepardi dhe Luigi Coppola; në Enco Journal N°10; jepet tabela 3.2.1.5, e sasisë minimale të lejuar të çimentos në varësi të klasave të ekspozimit, si më poshtë:

**Tabela 3.2.1.5: Klasat e ekspozimit për veprat e ekspozuara ndaj klorureve të ujit të detit, referuar S SHEN 206-1: 2003.**

| Klasat e ekspozimit                                               | Përshkrimi i ambjentit                                                                    | Sasia min. e çimentos (kg/ m <sup>3</sup> ) | Raporti maksimal U/Ç≤ | Vlera min.Rck* (N/mm <sup>2</sup> ) |
|-------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|-----------------------|-------------------------------------|
| XS <sub>1</sub>                                                   | Strukturat nëafërsi të brigjeve të ekspozuara ndaj tërheqjes së ujërave për shkak të erës | 300                                         | 0.5                   | 37                                  |
| XS <sub>2</sub><br>një strukture të vetme gjysmë të zhytur në ujë | Strukturat e ekspozuara në mënyrë të përherëshme ndaj ujit të detit                       | 320                                         | 0.45                  | 45                                  |
| XS <sub>3</sub><br>një strukture të vetme gjysmë të dalë mbi ujë  | Strukturat e ekspozuara në mënyrë jo të vazhdueshme ndaj ujit të detit                    | 340                                         | 0.45                  | 45                                  |

Nga të dy këto kritere do të marrim vlerën më të madhe.

**Hapi 6:** Llogaritja e sasisë së materialeve inerte të trasha ose të çakëllit 1 dhe 2, prodhim referuar Standardit **S SHEN 509:1987**.

Duke u bazuar në hulumtimet e fundit të Neville 2002 në tabelën e dhënë prej tij (fq. 754 Neville); si dhe në S SHEN 12620:2003, jepet në varësi të madhësisë së materialit inert (20mm), për Materiali inertn e trashë koeficienti është 0.64, kështu sasia e çimentos llogaritet:

Sasia e çakëllit do të jetë = densiteti i materialit inert(kg/m<sup>3</sup>) x koefiçientin e marrë në tabelën 3.2.1.6.

**Tabela 3.2.1.6: Vlerat standarte për përmbajtjen e kokrrizave të finos (përmbajtje  $\leq 0.125$  mm) sipas EN 206-1:2000 dhe SIKA.**

| Vlerat standarte për përmbajtjen e kokrrizave të rërës (përmbajtje $\leq 0.125$ mm) sipas EN 206-1:2000 |                        |                       |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|-----------------------|
| Kokrriza Ø 8 mm                                                                                         | Kokrriza Ø 16 mm       | Kokrriza Ø 32 mm      |
| 450 kg/m <sup>3</sup>                                                                                   | 400 kg/m <sup>3</sup>  | 350 kg/m <sup>3</sup> |
| Rekomandimet e SIKA                                                                                     |                        |                       |
| D max e Kokrrizës                                                                                       | Agregat i rrumbullakët | Agregat i thyer       |
| 8 mm                                                                                                    | 500 kg/m <sup>3</sup>  | 525 kg/m <sup>3</sup> |
| 16 mm                                                                                                   | 425 kg/m <sup>3</sup>  | 450 kg/m <sup>3</sup> |
| 32 mm                                                                                                   | 375 kg/m <sup>3</sup>  | 400 kg/m <sup>3</sup> |

**Hapi 7: Llogaritja e sasisë së rërës**, në përputhje me S SH EN 933-1 referuar Standardit **S SHEN 505:1987**.

Gjejmë volumin e të gjithë përbërësve të betonit. Nga volumi total një zbresim volumin e përbërësve të gjetur më sipër.

**Hapi 8: Përzgjedhja e shtesave** në përputhje me standardin **S SHEN 934-2**.

Meqenëse betonet e zakonshme mund të prodhohen me ose pa shtesa, për betonet jetëgjatë përdorimi i shtesës duhet të përmirësojë strukturën e betonit duke zvogëluar boshllëkun ndërmjet kokrrizave dhe natyrisht duke ndikuar më pas në rezistencën mekanike të çimentos por edhe të betonit. Shtesat e ashtuquajtura superpalstifikatore i shtohen përzjerjes së betonit në masën 0.1-2% të masës së çimentos duke ndikuar njëkohësisht në zvogëlimin e sasisë së ujit për 20-30% dhe një rritje të konsistencës së betonit të freskët prej 15-20 cm, si rrjedhim rrjedhshmërinë e masës së betonit, për pasojë nuk kemi as shtresim (segregim) dhe as dalje të ujit në sipërfaqe.

### 3. Aplikimi matematikor i mix design të përzgjedhur dhe të adaptuar për rastin tonë të studimit.

**Eksperimentimi konkret i recepturës së betonit** u realizua si më poshtë:

- Nga kërkesat e S SHEN 206-1:2003 përcaktojmë klasën e betonit C35/45.
- Sasia e çimentos nga tabela 3.2.1.4, në pikën 2.
- Raporti ujë/çimento, për kushtet ambjentale, 0.45.
- Sasia e ujit, në përputhje me standardin **S SHEN 12350-7**, ku merret parasysh edhe thithja e ujit në përputhje me standardin **S SHEN 1097-6**.
- Sasia e materialeve inerte, nga grafiku pesha e materialit inert ( granil 2+ granil 1+ rërë)
- Për pompim duhet të kemi raportin 50% rërë dhe 50% granil 1 dhe 2. Gjej peshën e rërës, në përputhje me S SHEN 933-1.

- Nga S SHEN granili 1 (për fortësi) jo më shumë se 12% .Gjej peshën e granilit 1.
- Diferenca është granil 2.


**Referuar standardit S SHEN** është marrë parasysh çimento 500.

Ne mund të përdorim sasi çimento me klasë <500 + shtesa por duke shtuar aditiv të fortë.

Më poshtë jepen tabelat e recepturave.

**Tabela 3.2.1.7: Receptura e betonit, për diametër maksimal të korrozave <30mm, për agregat mali**


| Recepturat për Materialet inerte malit; Fushë Krujë; për Normale, Agresive |                   |             |             |             |
|----------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------|-------------|-------------|
| Përbërësit                                                                 | Njësia            | K-1         | K-2         | K-3         |
| Rërë 0-5 mm                                                                | kg/m <sup>3</sup> | 895         | 918         | 854         |
| Granil 5-10 mm                                                             | kg/m <sup>3</sup> | 298         | 305         | 327         |
| Granil 10-25 mm                                                            | kg/m <sup>3</sup> | 668         | 685         | 680         |
| Çimento                                                                    | kg/m <sup>3</sup> | 395         | 395         | 387         |
| Ujë                                                                        | L/m <sup>3</sup>  | 158         | 139         | 195         |
| Modifikues                                                                 | mL/m <sup>3</sup> | 3.32        | 4.56        | 4.88        |
| Temperatura e betoni                                                       | ° c               | 21          | 21          | 20          |
| Raporti u/ç                                                                |                   | <b>0.40</b> | <b>0.35</b> | <b>0.50</b> |
| Konsistenca                                                                | mm                | 19          | 19          | 20          |
| Densiteti i betonit të freskët                                             | kg/m <sup>3</sup> | 2417        | 2447        | 2448        |
|                                                                            |                   | 10/10/2013  | 17/10/2013  | 26/10/2013  |



**Figura 3.2.2: Grafiku i referohet DIN ISO 1045, për diametër maksimal të korrozave <30mm**

**Tabela 3.2.1.8: Receptura e betonit, për diametër maksimal të korrizave <30mm, për agregat lumi Erzen, Romanat**

| Përbërësit                     | Njësia            | R-1         | R-2         | R-3         |
|--------------------------------|-------------------|-------------|-------------|-------------|
| Rërë 0-5 mm                    | kg/m <sup>3</sup> | 998         | 998         | 998         |
| Granil 5-10 mm                 | kg/m <sup>3</sup> | 230         | 230         | 230         |
| Granil 10-25 mm                | kg/m <sup>3</sup> | 691         | 691         | 691         |
| Çimento                        | kg/m <sup>3</sup> | 360         | 360         | 360         |
| Ujë                            | L/m <sup>3</sup>  | 161         | 144         | 125         |
| Modifikues                     | mL/m <sup>3</sup> | 4.32        | 4.32        | 4.32        |
| Temperatura e betoni           | ° c               | 20          | 19          | 19          |
| Raporti u/ç                    |                   | <b>0.45</b> | <b>0.40</b> | <b>0.35</b> |
| Konsistenca                    | mm                | 21          | 20          | 18          |
| Densiteti i betonit të freskët | kg/m <sup>3</sup> | 2444        | 2427        | 2408        |
|                                |                   | 11/02/2013  | 11/11/2013  | 11/12/2013  |



**Figura 3.2.3: Grafiku i referohet kurbës nga DIN ISO 1045 për diametër maksimal = 30 mm**

**Tabela 3.2.1.9: Receptura e betonit, për diametër maksimal të korrizave <30mm, për agregat lumi Mat, Milot**

| Përbërësit                     | Njësia            | M-1         | M-2         | M-3         |
Figura 3.3.2.4.10: Analiza e granulometrisë së kokrrizave dhe diagrama e kalimeve kumulative për fraksionin I (0/5mm) – materiale natyrale nga lumi Milot.







Figura 3.3.2.4.11: Analiza e granulometrisë së kokrrizave dhe diagrama e kalimeve kumulative për fraksionin I (0/5mm) – materiale natyrale nga lumi Milot.




**Figura 3.3.2.4.12: Analiza e granulometrisë së kokrrizave dhe diagrama e kalimeve kumulative për fraksionin II (5/10mm) – materiale natyrale nga lumi Milot.**



**Figura 3.3.2.4.13: Analiza e granulometrisë së kokrrizave dhe diagrama e kalimeve kumulative për fraksionin II (5/10mm) – materiale natyrale nga lumi Milot.**



**Figura 3.3.2.4.14: Analiza e granulometrisë së kokrrizave dhe diagrama e kalimeve kumulative për fraksionin III (10/25mm) – materiale natyrale nga lumi Milot.**



**Figura 3.3.2.4.15: Analiza e granulometrisë së kokrrizave dhe diagrama e kalimeve kumulative për fraksionin III (10/25mm) – materiale natyrale nga lumi Milot.**

### 3.3.4 Uji i përdorur

Uji që u përdorur është ujë që plotëson kërkesat e Standardit **EN 1008: 2003**. Tesimi i mostrave të këtij uji jepen në tabelën e mëposhtme Tabela 3.3.4.1.

**Tabela 3.3.4.1: Vetitë e ujit**

| REZULTATET E TESTIMIT |                                                      |                  |               |                               |
|-----------------------|------------------------------------------------------|------------------|---------------|-------------------------------|
| Nr                    | Karakteristikat                                      | Njësia<br>matese | Rezultatet    | Kërkesat e testimit specifike |
| 1                     | Burimi i ujit                                        |                  | pusi          | ---                           |
| 2                     | Ngjyra e ujit                                        |                  | transparente  | ---                           |
| 3                     | Aroma e ujit                                         |                  | nuk ka        | ---                           |
| 4                     | Densiteti i ujit në 19 °C                            | kg/l             | <b>1.0036</b> | 0.9982                        |
| 5                     | Fortësia e ujit (CaCO <sub>3</sub> )                 | mg/l             | <b>2.93</b>   | ---                           |
| 6                     | Sedimentimi në 180 °C                                | mg/l             | <b>2.47</b>   | ≤4                            |
| 7                     | Përmbajtja e pH                                      |                  | <b>6.81</b>   | ≥ 4                           |
| 8                     | Përmbajtja e klorureve Cl <sup>-</sup>               | mg/l             | <b>863.5</b>  | ≤ 1000                        |
| 9                     | Përmbajtja e sulfatave SO <sub>4</sub> <sup>-2</sup> | mg/l             | <b>1256.9</b> | ≤ 2000                        |
| 10                    | Përmbajtja e kripërave NaCl                          | mg/l             | <b>65.8</b>   | ≤100                          |

Rezultatet e analizave të ujit u krahasuan me standardin referuar të cilit:  
Sasia e klorurit të nevojshëm për fillimin e korrozionit është pjesërisht i varur nga vlera e pH të ujit në porosit të betonit. Për njëvlerë të pH ≤ 11.5 korrozioni mund të ndodhë edhe pa prezencën e klorureve. Pra uji ynë është brenda parametrave të kërkuar.

### 3.3.5. Shtesat (lëng) ose modifikuesit e përdorur

Shtesa e përdorur nga ne në prodhimin e betoneve ishte **Chryso-Fluid Premia 180** në sasinë 3 l / m<sup>3</sup> beton.

Rezultati i përdorimit të shtesave ishte ujla e sasisë së ujit të përdorur. Efekti i përdorimit të sasisë së ujit më të ulët është rritja e rezistencës dhe jetëgjatësisë së betonit. Nëpërmjet uljes së depertueshmërisë së ujit apo të klorureve.

Një efekt tjetër i përdorimit të shtesave është edhe rritja e punueshmërisë së betonit të freskët ndërkohë që qëndrueshmëria në shtypje mbetet e pa ndryshuar pasi ajo varet nga raporti ujë/çimento.

Rezultatet treguan që përdorimi i shtesave ndikoi në ujljen e sasisë së çimentos si rezultat i minimizimit të sasisë së ujit duke mos ndikuar në punueshmërinë e betonit dhe në rezistencën në shtypje të betonit. Pra në këtë mënyrë ne kemi realizuar beton me kosto më të ulët dhe më ambjental pasi ka përdorim të një sasive më të ulët çimento. Specifikimet e supermodifikuesit janë dhënë në tabelën 3.3.5.1 më poshtë:

**Tabela 3.3.5.1: Karakteristikat fiziko-kimik të shtesave supermodifikuesit që u përdorur në betonin durabël.**

| <i>CHRYSO Fluid Premia 180</i>                 |                                    |
|------------------------------------------------|------------------------------------|
| Gjendja                                        | E lëngët                           |
| Ngjyra                                         | Kafe e lehtë                       |
| Masa volumore referuar ISO 758                 | 0.960 g/cm <sup>3</sup> (ne +20°C) |
| Përmbajtja e lëndës së thatë referuar EN 480-8 | 15.680 %                           |
| Sasia e kripërave referuar EN 480-10           | 0.17 %                             |
| pH referuar ISO 4316                           | 4.77 (ne +20°C)                    |

### 3.4 PROCEDURA E PRODHIMIT TË BETONIT

Për të gjithë kubikët e prodhuar, mbi bazën e recepturave të mësipërme të dhëna në Tabelat 3.3.4.1, 3.3.5.1, u ndoq procedura si më poshtë vijon:

- Peshohen Materialet inerte të, çakëll 1, çakëll 2 dhe hidhen në betonierë.



**Figura 3.4.1, 3.4.2: Peshimi i materialeve inerte**

- Përzihen për rreth 5 minuta.
- Peshohet dhe hidhet çimento. Ky është moment kur shenohet koha e prodhimit. Fillon procesi i përzierjes.
- Shtohet rreth 50% e sasisë së ujit të kërkuar referuar recepturës. Shtohet sasia e shtesës dhe pas saj shtohet edhe pjesa tjetër e ujit të mbetur.
- Brumi i betonit përzihet në betonierë rreth 25-30 minuta.



**Figura 3.4.3, 3.4.4: Proçesi i përzierjes**


- Pas kohës së përzierjes betoni hidhet në konus dhe i matet ulja.
- Tani brumi i gatshëm hidhet, me shtresa, në kubikët 15\*15\*15 ose cilindrikë 15\*30. Ngjeshja bëhet me shufër cilindrike hekuri të galvanizuar. Bëhet vibrimi për 1 minutë në tavolinën e vibrimit. I vendosen çdo kubiku indeksimet përkatëse.
- Në cdo prodhim kemi përgatitur nga dy kubikë me reperë që na shërbejnë për matjen e zgjatimeve lineare.
- Të ndarë në sasi të barabartë kubikët ruhen në kushte normale të kantjerit dhe pjesa tjetër është dërguar në një ambient të përshtatshëm në det, në zonën e Currilave në Durrës.



**Figura 3.4.5 – 3.4.7: Prodhimi i kubikëve në kantjeret e prodhimit**

Eksperimenti i tretë është bërë me materiale të marra nga prodhuesi “SAG” shpk.

Këtu prodhuam mostrat me furnizime të materialeve të marra nga Miloti, pra nga lumi Matit. Në figurën 3.4.7 është dhënë një foto e trajtimit të kubeve të betonit, në ditët e para të maturimit, si dhe është paraqitur indeksimi i tyre. Identifikimi i kubeve të betonit u bë nëpërmjet ndërtimit të tabelës së indeksimit të kubeve të prodhuara, të paraqitur në tabelën 3.4.8, si më poshtë.



**Figura 3.4.8: Tabela e indeksimit të kubikëve të prodhuar**



**Figura 3.4.9 - 3.4.12: Trajtimi i kubikëve të betonit**

**Tabela 3.4.1: Tabela e indeksimit të kubikëve, 28 ditore**

|               |                    |             |          |             |
|---------------|--------------------|-------------|----------|-------------|
| K-1-N         | Normale kantjeri   | 0.47        | mali     | Fushë Krujë |
| K-2-N         | Normale kantjeri   | 0.4         | mali     | Fushë Krujë |
| K-3-N         | Normale kantjeri   | 0.35        | mali     | Fushë Krujë |
| Betoni C35/45 |                    |             |          |             |
| Emërtimi      | Kushtet e mjedisit | Raporti u/ç | Agregati | Vendburimi  |
| K-4-A         | Ujë deti           | 0.47        | mali     | Fushë Krujë |
| K-5-A         | Ujë deti           | 0.4         | mali     | Fushë Krujë |
| K-6-A         | Ujë deti           | 0.35        | mali     | Fushë Krujë |
| Betoni C35/45 |                    |             |          |             |
| Emërtimi      | Kushtet e mjedisit | Raporti u/ç | Agregati | Vendburimi  |
| R-1-N         | Normale kantjeri   | 0.45        | lumi     | Romanati    |
| R-2-N         | Normale kantjeri   | 0.4         | lumi     | Romanati    |
| R-3-N         | Normale kantjeri   | 0.35        | lumi     | Romanati    |
| Betoni C35/45 |                    |             |          |             |
| Emërtimi      | Kushtet e mjedisit | Raporti u/ç | Agregati | Vendburimi  |
| R-4-A         | Ujë deti           | 0.45        | lumi     | Romanati    |
| R-5-A         | Ujë deti           | 0.4         | lumi     | Romanati    |
| R-6-A         | Ujë deti           | 0.35        | lumi     | Romanati    |
| Betoni C35/45 |                    |             |          |             |
| Emërtimi      | Kushtet e mjedisit | Raporti u/ç | Agregati | Vendburimi  |
| M-1-N         | Normale kantjeri   | 0.45        | lumi     | Miloti      |
| M-2-N         | Normale kantjeri   | 0.4         | lumi     | Miloti      |
| M-3-N         | Normale kantjeri   | 0.34        | lumi     | Miloti      |
| Betoni C35/45 |                    |             |          |             |
| Emërtimi      | Kushtet e mjedisit | Raporti u/ç | Agregati | Vendburimi  |
| M-4-A         | Ujë deti           | 0.45        | lumi     | Miloti      |
| M-5-A         | Ujë deti           | 0.4         | lumi     | Miloti      |
| M-6-A         | Ujë deti           | 0.34        | lumi     | Miloti      |

Theksojmë se për secilin prej indeksimeve janë prodhuar nga dy kube për 7, 28, 90, 180ditore. Për rast janë prodhuar nga dy kube për testimet e rezistencës në shtypje, për modulën e elasticitetit (me reper), nga 3 kube për përshkueshmërinë e ujit dhe për përmbajtjen e klorureve, nga dy cilindra 28 ditore për testimin e rezistencës në tërheqje.

Meqë sasia e kubeve të prodhuara ishte e madhe ato janë prodhuar në tre kantjere prodhimi dhe në disa data prodhimi, referuar përshkrimeve të mësipërme.

### 3.5 PROCEDURA E TESTIMEVE DHE ANALIZAVE

Pas periudhës së tharjes kubikët e betonit të prodhuar u testuan, për të marrë rezultate për vetitë mekanike dhe të durueshmërisë së betonit në kohën e maturimit 7, 28, 90, 180 ditore. Provat dhe testimet e bëra janë mbështetur në standardin EN 206-1:2003, dhe standarteve të tjera në fuqi. Nga kubikët e prodhuar u testuan dhe u analizuan:

Kërkesat tona **për betonin e freskët** ishin:

- 1- Konsistenca u përcaktua në përputhje me standardin EN 12350-2.
- 2- Përmbajtje e çimentos dhe raportit ujë/çimento. Thithja e ujit të materialeve të materialeve inerte u përcaktua në përputhje me standardin EN 1097-6.
- 3- Madhësia maksimale e materialit të materialit inert. Kjo madhësi duhet të matet në përputhje me standardin EN 933-1.
- 4- Temperatura e betonit të freskët.
- 5- Densiteti i betonit. Për betonin me peshë normale ishte  $2000\text{kg/m}^3$  deri në  $2600\text{kg/m}^3$ .

Kërkesat tona **për betonin e ngurtësuar** ishin:

- 1- Qëndrueshmëria në shtypje. Vlerësimi i rezistencës në shtypje u mat në përputhje me standardin EN 13791
- 2- Qëndrueshmëria ndaj plasaritjeve në tërhehje. Vlerësimi i rezistencës në tërheqje u mat në përputhje me standardin EN 12390-6
- 3- Moduli i elasticitetit

Kërkesat tona **për betonin jetëgjatë** ishin:

- 1- Qëndrueshmëria ndaj depërtimit të ujit.
- 2- Reagimet ndaj depërtimit të klurureve.

**Provat e testimit të vetive të betonit të freskët** u realizuan në përputhje me standardin EN 12350-1, 2, 3, 4, 5, 6.

#### 3.5.1 Konsistenca ose punueshmëria duhet të përcaktohet, ku do të përcaktohen provat e uljeve (referuar ATSM C 143) AASHTO T 119.

Një nga vetitë e betonit të freskët është punueshmëria e betonit. Kjo veti është shumë e rëndësishme, në veçanti për prodhuesit e betonit, të cilët realizojnë hedhjen e betonit në vepër.

Punueshmëria e betonit është lehtësia që paraqet betoni gjatë pompimit, dalja e një mase të vijueshme dhe pa lejuar ndarjen e betonit në shtresa ose siç quhet fenomeni i

segregimit. Slump test është test i konsistencës ose punueshmërisë së betonit i cili realizohet duke mbushur konin me beton, e lëvizim konin dhe masim uljen e betonit e cila konvertohet në shkallë të konsistencës së betonit ose klasë të punueshmërisë së betonit



**Figura 3.5.1.1: Matje e konsistencës së betonit të prodhuar me datë 30.09.2013**

Punueshmëria e betonit rritet:

- duke shtuar sasinë e ujit,
- nëpërmjet përdorimit të shtesave të lengta, ose
- duke përdorur materiale inertenatyrale, pra me forma të rrumbullakosura.

Klasat e Konsistencës në përputhje me Standardin EN 12350-2.

### **3.5.2 Sasia dhe lloji i çimentos dhe raportit ujë/çimento.**

Thithja e ujit të materialeve të materialeve inerte u përcaktua në përputhje me standardin EN 1097-6.

### **3.5.3 Madhësia maksimale e materialit të materialit inert.**

Kjo madhësi u mat në përputhje me standardin EN 933-1.

### **3.5.4 Temperatura e betonit të freskët**

Temperatura e betonit të freskët, referuar standardit S SH EN ishte rreth 20 °C. Kjo temperaturë u zgjodh duke respektuar grafikun e mëposhtëm 3.5.4.1.




Figura 3.5.4.1: Forca shtypëse (Marrë nga SIKA handbook 2006)

### 3.5.5 Densiteti i betonit të freskët

Në tabelat e rezultateve eksperimentale dhe të realizimit të recepturave të betonit janë dhënë edhe vlerat e matura për çdo rast betoni të përgatitur.

## 3.6 PROVAT E VETIVE TË BETONIT TË NGURTËSUAR

U realizuan në përputhje me standardin EN 12390-1, 2, 3, 6, 7.

### Të Përgjithshme

#### 1. Qëllimi

Mbi kampionët ushtrohet forcë shtypëse deri në shkatërrimin e tyre, kjo bazuar referuar standardit EN 12390-4. Shënohet maksimumi i forcës së ushtruar mbi kampion dhe llogaritet qëndrueshmëria në shtypje dhe përkulje e betonit.

#### 2. Paisje

- Presë hidraulike për të realizuar provën në shtypje dhe përkulje të kampionëve të betonit, me specifikimet referuar UNI EN 12390-4.
- Format për përgatitjen e kampionëve të betonit që do i nënshtrohen këtij testi mund të jenë kubik, cilindrik ose karrota, të cilat janë konform standarteve EN 12350-1, EN 12390-1, EN12390-2 dhe EN 12504-1. N.q.s kampionit që do të testohet nuk ka dimensionet nominale të specifikuara referuar standardit EN 12390-1, atëherë testi do të kryhet referuar pikës B.

### 3. Proçedura

Fillimisht thahet kampioni që do t'i nënshtrohet testit. Gjithashtu bëhet edhe pastrimi me kujdes i paisjes përpara se të kryhet testi. Nuk duhen shtuar pllaka të cilat nuk i përkasin paisjes për të realizuar këtë test.

Vendosim kampionin në pozicionin e duhur, në mënyrë që sipërfaqja që do të shtypet ose përkulet të jetë pingule më pllakën që do të ushtrojë forcën.

Zgjedhim shpejtësinë konstante të shtypjes brënda një intervali nga 0.2 MPa / s (N/mm<sup>2</sup> · s) deri në 1.0 MPa / s (N/mm<sup>2</sup> · s) me një shmangie prej  $\pm 10\%$  nga shpejtësia konstante.

Në disa paisje, ky ndryshim i shpejtësisë kontrollohet në mënyrë manuale, gradualisht, duke mos lejuar rritjen apo zvogëlimin e shpejtësisë së kryerjes së testit. Shënojmë vlerën e marrë nga monitori.

Figurat më poshtë paraqesin pamjet përkatëse kur secilin tip kampionit në të cilën është realizuar testi dhe shkatërrimi ka dhënë një rezultat të kënaqshëm.




Figura 3.5.5.1, 3.5.5.2: Pamjet e kampionëve pas thyerjes.

### 4. Mbajtja e raportit gjatë marrjes së mostrës

Çdo kampion duhet të shoqërohet me një raport të përgatitur nga personi përgjegjës.

Në raport përfshihen:

- a) identifikimin e mostrës;
- b) dimensionet nominale të modelit ose, në rast se dimensioned nuk janë të rregullta të jepet madhësia aktuale;
- c) gjendja e sipërfaqes në kohën e testit;
- d) datën e testit;
- f) ngarkesa maksimale, në kiloneëtons;
- g) qëndrueshmëria në ngjeshje të modelit në megapascals ( $\pm 0.5\text{MPa}$ ) ose ( $\pm 0.5\text{ N/mm}^2$ );
- h) tipin e thyerjes (nëse është e përshtatshme) dhe, në këtë rast, tregojnë llojin më të ngjashëm;
- i) çdo shmangie nga metoda e matjes standarde;
- j) një deklaratë e personit teknik përgjegjës për proven e cila tregon se testi është kryer në përputhje me këtë proçedurë stanrti, përveç rastit referuar pikës i).

### 3.5.6 Testimet për vetitë në qëndrueshmërinë në shtypje (Strength Properties)

Qëndrueshmëria në shtypje e kubikëve të betonit u realizua (**referuar UNI EN 12390-3 dhe 12390-5**)

Test rapori mund të përfshijë:

- k) peshën e kampionit;
- l) densitetin me saktësi  $\pm 10 \text{ kg/m}^3$
- m) kushtet e marrjes së mostrës;
- o) koha e kryerjes së testit
- p) kohën e maturimit të kampionit të betonit.

Testimet janë bërë për kubikët në moshë 7, 28, 90, 180 ditë.



Figura 3.5.6.1, 3.5.6.2: Testimet e kubeve për rezistencën në shtypje

### 3.5.7 Qëndrueshmëria në tërheqje e kubikëve të betonit



Figura 3.5.7.1: Testimet e kubeve për rezistencën në tërheqje



**Figura 3.5.7.2 - 3.5.7.5: Testimet e kubeve për rezistencën në tërheqje**

Provat e betonit në tërheqje indirekte mbi kubet e betonit me lidhës çimento realizohen referuar standardit S SH EN 12390-6: 2002.

Qëndrueshmëria në tërheqje llogaritet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë duke testuar

$$\sigma = \frac{2P}{\pi dL} \text{ N/mm}^2$$

ku  $\sigma$  = Qëndrueshmëria në tërheqje (N/mm<sup>2</sup>)  
P = Forca shtypëse e aplikuar (N)

d = Diametri i cilindrit (mm)

L = Gjatësia e cilindrit (mm)

### 3.5.8 Moduli i elasticitetit (referuar BIS:516-1959)

Moduli i elasticitetit është një koeficient që shpreh raportin sforcim (stress) / deformim (strain). Ky raport në formulë matematikore është:

$$\sigma = \frac{P}{A}, \quad A = \frac{\pi}{4}d^2, \quad E = \frac{\sigma}{\epsilon}$$

Deformimi  $\epsilon$  i kubikut të betonit shpreh deformimin linear të tij gjatë kohës së maturimit të betonit e shprehur në formulë do të kemi:

$$\epsilon = \frac{\Delta L}{L}$$

ku  $\sigma$  = Qëndrueshmëria në shtypje ( $\text{N/mm}^2$ )

P = Forca shtypëse e aplikuar (N)

A = Sipërfaqja e kubit cilindër ( $\text{mm}^2$ )

$\epsilon$  = Deformimi

d = Diametri i cilindrit (mm)

$\Delta L$  = Ndryshimi i gjatësisë (mm)

L = Gjatësia e cilindrit (mm)

E = moduli i elasticitetit

Grafikisht varësia sforcim deformim shprehet në figurën 3.5.8.1, si më poshtë.




Figura 3.5.8.1: Sjellja tipike e marëdhënies sforcim – deformim e betonit dhe e përbërësve të tij

Më poshtë, në figurën 3.5.8.2 - 3.5.8.4 janë dhënë pamje të matjes së kubeve të betonit të prodhuara me reper që na ndihmojnë për matjen e deformimit linear në dy drejtime. Të dhënat e matjeve ( $\Delta L$ ) hidhen në një tabelë dhe gjejmë vlerat e  $\epsilon_x$  dhe  $\epsilon_z$  referuar formulave të mësipërme.



Figura 3.5.8.2 – 3.5.8.4: Procedura e testimit të përshkueshmërisë së ujit.

Këto kube u testuan në periudhat e maturimit të betonit për 7, 28, 90 dhe 180 ditë.

**Testimet për vetitë e jetëgjatësisë së betonit (Durability Properties).**

**3.5.9 Qëndrueshmëria ndaj depërtimit të ujit ose Përshkueshmëria nga uji e betonit,** të ruajtur në kushte të ndryshme të ekspozimit. Përshkueshmëria e ujit, matur referuar (referuar EN: 12390-8/ 2002)

Referuar standardit S SH EN 206 që betoni të konsiderohet i papërshkueshëm nga uji rezulton që **vlera maksimale e depërtimit të jetë  $\leq 50\text{mm}$**  dhe vlera mesatare të jetë  $\geq 20\text{ mm}$ . **Raporti ujë/çimentonuk duhet të kalojë 0.55.**

Testimi realizohet për kubet e thara mbi 28 ditore. Këto kube duhet të jenë 3 copë për ato të trajtuara në kushte Normale dhe 3 kube të trajtuara në kushte Agressive të ujit të detit. Lihen në pajisjen e paraqitur në figurat e mëposhtme 3.5.9.1 – 3.5.9.3, ku i nënshtrohen presionit të ujit prej 5 atm për 72 orë.


Pas këtij trajtimi kubet thyhen në presë, thuajse përgjysëm dhe masim depërtueshmërinë e ujit në mm për çdo kub betoni të testuar.



**Figura 3.5.9.1 – 3.5.9.3: Procedura e testimit të përshkueshmërisë së ujit.**

Referuar EN 12390-8, referuar grafikut në figurën 3.20, depërtueshmëria maksimale është  $\leq 50\text{mm}$  dhe kërkohet një cilësi betoni e mirë për të lidhur konstruksioni.

Në grafikun e mëposhtëm po paraqesim një nga rezultatet e analizave të testimeve të bëra me kubikët tane eksperimental. Edhe një herë shohim që varësia



**Figura 3.5.9.4: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport u/ç= 0.47, të trajtuar në kushte Agresive; me agregate mali Fushë Krujë**

### **3.5.10. Përshkueshmëria e klorureve në betonin e trajtuar në ujë deti.**

Është matur përmbajtja e klorureve (referuar EN: 196-2 dhe EN 1744/1); AASHTO T 277 (ASTM C 1202)

Ky ekspertiment mbështetet në bazën ligjore të eurokodit EN 196-2 dhe EN 1744/1 mbi depërtimin e klorureve  $\text{Cl}^-$ .

Testimet u bënë për kubikët në moshë 7, 28, 90, 180 ditë.

Ky test iu bë dy kubikeve të prodhuar me datë 17.10.2013 dhe të trajtuar në kushtet agresive të ambjentit detar, të klasifikuar në kategorinë XS.

Data e testimit është 23.11.2013, dmth pas 37 ditësh.

Metoda e testimit të përdorur është titullimi nëpërmjet tretesirës së “tiocianat amoni”  $\text{NH}_4\text{SCN}$ .

Pas testit të rezistencës në shtypje marrim një sasi kampioni të thërmuar, nga e cila të mos kemi më pak se 5gr pluhur, i cili do të na shërbejë si testim.

E ruajmë, për një afat kohor prej 24 orë në një enë me ujë të distiluar. E lemë në gjendje qetësie.



**Figura 3.5.10.1 – 3.5.10.3: Matja e përmbajtjes së klorureve**

Pasi masa të ketë dekantuar e filtrojmë dhe marrim një sasi jo më pak se 100 ml. Hedhim në të 5 ml indikator sulfat amoni (amoni-  $\text{Fe}_{\text{III}}$ ) dhe titullojmë me tretesirën tiocianat amoni. Sasia, në ml, e tretesirës titulluese të harxhuar, për të cilën kampioni provë merr ngjyrë të kuqërremtë, shënohet në tabelë. Sa më e lartë të jetë përmbajtja e klorureve  $\text{Cl}^-$ , në kampionin provë aq më e madhe do të jetë sasia e titulluesit që na duhet për të ngjyrosur kampioni.

Sasia e klorureve do të gjendet me fomulën:

$$\text{Cl}^- = 0,8865 * (V_{\text{P.B}} - V_{\text{K.P}}) / V_{\text{P.B}} * m$$

Ku:

$m$ --- *Pesha e kampionit e marrë në testin (gr)*

$V_{\text{P.B}}$ --- *Sasia në ml e tretesirës së tiocianat amonit e harxhuar për proven e bardhë*

$V_{\text{K.P}}$ --- *Sasia në ml e tretesirës së tiocianat amonit e harxhuar për kampionin provë*

Për kampionin provë të parë  $\text{Cl}_1^- = 0.00103\%$  dhe  $\text{Cl}_2^- = 0.00106\%$ .

Me rezultatet e testimeve kemi ndërtuar grafikët e mëposhtëm.

## KAPITULLI 4

### REZULTATET GRAFIKE DHE ANALIZA E TYRE

#### 4.1 TË PËRGJITHSHME

Në këtë kapitull bëhen prezente rezultatet e kërkimeve eksperimentale. Kemi realizuar teste të ndryshme për të vlerësuar eksperimentimin e betoneve jetëgjatë të prodhuar me materiale tradicionale dhe të trajtuara në kushtesh ekspozimi ambjentale (N) dhe Agresive në ujë deti(A), për tre raporte të ndryshme ujë/çimento. Përbërësit e tjerë të betonit u mbajtën konstant. Të gjitha të dhënat e testimeve janë pasqyruar në mënyrë grafike dhe tabelare mëposhtë dhe për secilin rast janë bërë komentet dhe interpretimet përkatëse.

#### 4.2 REZISTENCA NË SHTYPJE

**Analizohen rezultatet e testimeve për këto faktorë që ndikojnë në rezistencën në shtypje:**

Ndikimi i raportit ujë/çimento në rezistencën në shtypje

Ndikimi i kohës së maturimit në rezistencën në shtypje

Ndikimi i klasës së ekspozimit ambjental në rezistencën në shtypje

Ndikimi i llojit të agregatit në rezistencën në shtypje

Krahasime

#### 4.3 REZISTENCA NË TËRHEQJE

**Analizohen rezultatet e testimeve për këto faktorë që ndikojnë në rezistencën në tërheqje:**

4.3.1 Ndikimi i raportit ujë/çimento në rezistencën në tërheqje

4.3.2 Ndikimi i llojit të agregatit në rezistencën në tërheqje

4.3.3 Ndikimi i kohës së maturimit në rezistencën në tërheqje

4.3.4 Ndikimi i kushteve ambjentale në rezistencën në tërheqje

4.3.5 Krahasime

#### **4.4 MODULI I ELASTICITETIT**

**Analizohen rezultatet e testimeve për këto faktorë që ndikojnë në rezistencën në Modulin e Elasticitetit:**

4.3.1 Ndikimi i raportit ujë/çimento në Modulin e Elasticitetit

4.3.2 Ndikimi i llojit të agregatit në Modulin e Elasticitetit

4.3.3 Ndikimi i kohës së maturimit në Modulin e Elasticitetit

4.3.4 Ndikimi i kushteve ambientale në Modulin e Elasticitetit

4.3.5 Krahase

#### **4.5 PËRMBAJTJA E KLORUREVE NË BETON**

**Analizohen rezultatet e testimeve për këto faktorë që ndikojnë në rezistencën nëpërmbajtjen e klorureve:**

4.4.1 Ndikimi i raportit ujë/çimento në përmbajtjen e klorureve

4.4.2 Ndikimi i llojit të agregatit në përmbajtjen e klorureve

4.4.3 Ndikimi i kohës së maturimit në përmbajtjen e klorureve

4.4.4 Ndikimi i kushteve ambientale në përmbajtjen e klorureve

4.4.5 Krahase

#### **4.6 PËRSHKUESHMERIA E UJIT NË BETON**

**Analizohen rezultatet e testimeve për këto faktorë që ndikojnë në rezistencën nëpërshkueshmerinë e ujit:**

4.5.1 Ndikimi i raportit ujë/çimento në përshkueshmerinë e ujit

4.5.2 Ndikimi i llojit të agregatit në përshkueshmerinë e ujit

4.5.3 Ndikimi i kohës së maturimit në përshkueshmerinë e ujit

4.5.4 Ndikimi i kushteve ambientale në përshkueshmerinë e ujit

4.5.5 Krahase

#### **4.7 INTERPRETIMI I REZULTATEVE**

## 4.2 REZISTENCA NË SHTYPJE

Në këtë kapitull kemi trajtuar dhe analizuar rezultatet e testimeve të marra nga provat laboratorike. Këto analiza janë nxjerrë nga konkluzionet e nxjerra nga grafikët. Më poshtë analizohen efekti i raportit ujë/çimento, llojit të agregatit, moshës, klasave të ekspozimit në rezistencën në shtypje të betonit jetëgjatë të prodhuar prej nesh. janë analizuar vlerat e rezistencës në shtypje për tre lloje agregatesh, të trajtuara në dy lloje kushtesh ambientale Normale- kushte kantjeri (N) dhe Agresive- ujë deti (A).

### 4.2.1 Ndikimi i Rezistencës në shtypje nga raporti w/c. Krahasime

#### 4.2.1.1 Ndikimi i $f_{cm,28}$ nga raportit w/c; për dy klasat e ekspozimit ambjental për agregate mali (K) të marra në Fushë Krujë nga “VEGA” shpk

1. Rezistenca në shtypje për betonin 35/45 ( $45\text{N/mm}^2$ ) e prodhuar me **agregate mali** (K) të marra në Fushë Krujë nga “VEGA” shpk me indeksimet  $u/\varphi = 0.35$  (K-3-N);  $u/\varphi = 0.40$  (K-2-N);  $u/\varphi = 0.47$  (K-1-N), të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të **Normal**, është analizuar në grafikun e mëposhtëm.





Fig.4.2.1.1.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin  $u/\varphi = 0.35; 0.4; 0.47$ ; në kushte Normale; për agregate mali (K)

Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, përkushte Normale ekspozimi. Vlerat e  $f_{cm,28} = 53.013\text{ N/mm}^2$  ( $u/\varphi = 0.35$ ) dhe  $f_{cm,28} = 38.693\text{ N/mm}^2$  ( $u/\varphi = 0.47$ ).

Kjo rritje e rezistencës është në masën  $f_{cm,28}(0.35)/f_{cm,28}(0.47) = 137\%$ .

Modelimi matematikor për këtë grafik është ekuacioni  $y = -11.52x + 64.53$

2. Rezistenca në shtypje betonin 35/45 ( $45\text{N/mm}^2$ ) të prodhuar me **agregate mali** (K) të marra në Fushë Krujë nga “VEGA” shpk me indeksimet  $u/\varphi=0.35$ (K-3-A);  $u/\varphi=0.40$  (K-2-A);  $u/\varphi=0.47$  (K-1-A), të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të **Agresiv** ujë deti, është analizuar në grafikun e mëposhtëm :



**Fig.4.2.1.1.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin  $u/\varphi = 0.35; 0.4; 0.47$ ; në ambjent Agresive; për agregate mali (K)**

Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për kushte Agresive ekspozimi. Vlerat e  $f_{cm,28} = 54.594 \text{ N/mm}^2$  ( $u/\varphi = 0.35$ ) dhe  $f_{cm,28} = 38.966 \text{ N/mm}^2$  ( $u/\varphi = 0.47$ ) .

Kjo rritje e rezistencës është në masën  $f_{cm,28}(0.35)/f_{cm,28}(0.47) = 140\%$ .

Modelimi matematikor për këtë grafik është ekuacioni  $y = -7.814x + 60.26$

#### **4.2.1.2 Ndikimi i $f_{cm,28}$ nga raportit $u/\varphi$ ; për dy klasat e ekspozimit ambjental për agregate lumi (R) të marra në Romanat nga lumi Erzen**

1. Rezistenca në shtypje për betonin 35/45 ( $45\text{N/mm}^2$ ) të prodhuar me **agregate lumi** (R) të marra në Romanat nga lumi Erzen me indeksimet , për tre raporte  $u/\varphi$  :  $u/\varphi=0.35$ ( R-3-N);  $u/\varphi=0.40$  ( R-2-N) ;  $u/\varphi=0.45$  ( R-1-N) , të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të **Normal** , është analizuar në grafikun e mëposhtëm :




Fig.4.2.1.2.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin u/ç= 0.35; 0.4; 0.47; në kushte Normale; për agregate lumi (R)

Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për kushte Normale ekspozimi. Vlerat e  $f_{cm,28} = 45.587 \text{ N/mm}^2$  (u/ç= 0.35) dhe  $f_{cm,28} = 38.266 \text{ N/mm}^2$  (u/ç= 0.45) .

Kjo rritje e rezistencës është në masën  $f_{cm,28}(0.35)/ f_{cm,28}(0.45) = 120\%$ .

Modelimi matematikor për këtë grafik është ekuacioni  $y = -3.660 x + 49.41$

- Rezistenca në shtypje për betonin 35/45 ( $45 \text{ N/mm}^2$ ) të prodhuar me **agregate lumi** (R) të marra në Romanat nga lumi Erzen me indeksimet, për tre raporte u/ç: u/ç=0.35(R-3-A); u/ç=0.40 (R-2-A); u/ç=0.45(R-1-A), të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të Agresiv ujë deti, është analizuar në grafikun e mëposhtëm.




Fig.4.2.1.2.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin u/ç= 0.35; 0.4; 0.45; në ambjent Agresive; për agregate lumi (R)


Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për kushte Agresive ekspozimi. Vlerat e  $f_{cm,28} = 46.696 \text{ N/mm}^2$  ( $u/\varsigma = 0.35$ ) dhe  $f_{cm,28} = 42.946 \text{ N/mm}^2$  ( $u/\varsigma = 0.45$ ).

Kjo rritje e rezistencës është në masën  $f_{cm,28} (0.35) / f_{cm,28} (0.45) = 110\%$ .

Modelimi matematikor për këtë grafik është ekuacioni  $y = -1.875 x + 48.69$

#### 4.2.1.3 Ndikimi i $f_{cm,28}$ nga raportit $u/\varsigma$ ; klasat e ekspozimit ambjental për agregate lumi (M) të marra në Milot nga lumi Mat

1. Rezistenca në shtypje për betonin 35/45 ( $45 \text{ N/mm}^2$ ) të prodhuar me **agregate lumi** (M) të marra në Milot nga lumi Mat me indeksimet, për tre raporte  $u/\varsigma$ :  $u/\varsigma = 0.34$  (M-3-N);  $u/\varsigma = 0.40$  (M-2-N);  $u/\varsigma = 0.45$  (M-1-N), të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të Normal, është analizuar në grafikun e mëposhtëm.




**Fig.4.2.1.3.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin  $u/\varsigma = 0.34$ ;  $0.4$ ;  $0.45$ ; në kushte Normale; për agregate lumi (M)**

Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për kushte Normale ekspozimi. Vlerat e  $f_{cm,28} = 52.266 \text{ N/mm}^2$  ( $u/\varsigma = 0.34$ ) dhe  $f_{cm,28} = 44.439 \text{ N/mm}^2$  ( $u/\varsigma = 0.45$ ).

Kjo rritje e rezistencës është në masën  $f_{cm,28} (0.34) / f_{cm,28} (0.45) = 118\%$ .

Modelimi matematikor për këtë grafik është ekuacioni  $y = -3.913 x + 56.62$

2. Rezistenca në shtypje për betonin 35/45 ( $45 \text{ N/mm}^2$ ) të prodhuar me **agregate lumi** (M) të marra në Milot nga lumi Mat me indeksimet, për tre raporte  $u/\varsigma$ :  $u/\varsigma = 0.34$  (M-3-A);  $u/\varsigma = 0.40$  (M-2-A);  $u/\varsigma = 0.45$  (M-1-A), të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të Agresiv ujë deti, është analizuar në grafikun e mëposhtëm.




**Fig.4.2.1.3.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditore, për raportin u/ç= 0.34; 0.4; 0.45; në ambjent Agresive; për agregate lumi (M)**

Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për kushte Agresive ekspozimi. Vlerat e  $f_{cm,28} = 46.696 \text{ N/mm}^2$  (u/ç= 0.35) dhe  $f_{cm,28} = 42.946 \text{ N/mm}^2$  (u/ç= 0.45).

Kjo rritje e rezistencës është në masën  $f_{cm,28}(w/c=0.35)/ f_{cm,28} (w/c= 0.45) = 110\%$ .

Modelimi matematikor për këtë grafik është ekuacioni  $y = -1.875 x + 48.69$


#### **4.2.1.4 Krahësimi ndikimit të raportit u/ç për tre llojet e agrgateve dhe për të dy klasat e ekspozimit ambjental në Rezistencën në shtypje 28 ditore**



**Fig.4.2.1.4.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe Raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditore, për raportin u/ç= 0.34; 0.4; 0.45; në ambjent Normal; për tre llojet e agrgateve**

Nga analiza e këtij grafiku vijmë në këto **përfundime**:

- Për të tre llojet e agregateve raporti  $u/\zeta$  ndikon në raport të zhdrejtë me rezistencën në shtypje. Në të tre grafikët shohim vlerat më të ulta të rezistencës për raportin  $u/\zeta$  më të lartë.
- Për të tre raportet vlerat e rezistencave mekanike për agregatet e lumit të marra nga lumi Mat, në Milot kanë vlerat më të larta të rezistencave. Vlerat e  $f_{cm,28}$  (M) janë 146% më të larta se  $f_{cm,28}$  (R) për  $u/\zeta = 0.35$ . Këtë arësye do ta shpjegojmë më poshtë.
- Vlerat e rezistencave në shtypje për betonet më raportin ujë/çimento = 0.47, të trajtuar në kushte Normale ekspozimi, vijnë duke u rritur në lidhje me moshën. Rezistenca 180 ditore ( $44.451 \text{ N/mm}^2$ ) është më e lartë se rezistenca 28 ditore ( $38.369 \text{ N/mm}^2$ ).
- Për këtë raport ujë/çimento, nuk arrijmë rezistencën e dëshiruar,  $f_{cm,28} = 38.693 \text{ MPa}$ . Rezultatet tregojnë që kjo rezistencë merret pas 90 ditësh. Ky rezultat do të na ndikojë në objekt që të mos lejojmë dizarmimin e armaturës së drurit në kohën e maturimit 28 ditor por pas 90 ditëve.
- Vlerat më të larta të rezistencave i marrim për raportin ujë/çimento = 0.35. Për këtë raport  $u/\zeta$  pothuajse marim vlerën e rezistencës që pas 7 ditësh.



**Fig.4.2.1.4.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe Raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin  $u/\zeta = 0.34; 0.4; 0.45$ ; në ambient Agresive; për tre llojet e agregateve**

Nga analiza e këtij grafiku vijmë në këto përfundime:

- Për të tre llojet e agregateve raporti  $u/\zeta$  ndikon në raport të zhdrejtë me rezistencën në shtypje. Në të tre grafikët shohim vlerat më të ulta të rezistencës për raportin  $u/\zeta$  më të lartë.
- Për të tre raportet vlerat e rezistencave mekanike për agregatet e lumit të marra nga lumi Mat, në Milot kanë vlerat më të larta të rezistencave. Vlerat e  $f_{cm,28}$  (M) janë

121% më të larta se  $f_{cm,28}$  (R) për  $u/\varphi = 0.35$ . Këtë arësye do ta shpjegojmë më poshtë.

- Vlerat e rezistencave në shtypje për agregatet e marra në Fushë Krujë , për raportet  $u/\varphi \geq 0.4$  kanë vlera më të ulta se ato të Romanatit, por kur ky raport  $u/\varphi$  zvogëlohet vlerat e  $f_{cm,28}$  për agregatin e malit, Romanat barazohen pothuajse me vlerat e  $f_{cm,28}$  për agregatin e lumit në Milotit.
- **Konkluzionet, janë të njëjta për të dy kushtet e ekspozimit për  $f_{cm,28}$ . Relacioni ndërmjet  $f_{cm,28}$  dhe raportit  $u/\varphi$  është një varësi matematikore e zhdrejtë.** Ky fenomen ndodh sepse:
  - Për raporte më të larta ujë/çimento, kemi hapsira fillestare më të mëdha ndërmjet grimcave të çimentos dhe volum më të madh të poreve të pa mbushura si rezultat i procesit të hidratimit
  - Për njëyasi çimento të dhënë punueshmëria e betonit zvogëlohet në qoftë se zvogëlohet raporti ujë/çimento. Një raport i ulët ujë/çimento dtth më pak ujë, ose më shumë çimento dhe punueshmëri më e ulët.rezultat ky i nxjerë nga vetitë e betonit të freskët.

#### 4.2.1.5 Rezistenca në shtypje ( $f_{cm}$ ), në moshën 180 ditore, për të tre llojet e agregateve dhe për tre raportet ujë/çimento

- Nga grafikët e mëposhtëm rezultojmë që vlerat e  $f_{cm,180}$ , në betonet e prodhuara me të tre llojet e agregateve arrijnë klasën e kërkuar C35/45.
- Vlerat më të larta të  $f_{cm,180}$  marrim për agregatet e malit të marra në Fushë Krujë me  $68.965 \text{ N/mm}^2$ ; të lumit të marra në Milot me vlerë  $61.365 \text{ N/mm}^2$  dhe të lumit të marra në Romanat me vlerë  $51.068 \text{ N/mm}^2$ . **Kjo për arësyen se agregatet e malit janë me forma më të thepisura. Këto materiale inerte janë më të pastra. Kanë strukturë shumë të ngjeshur. Lidhen shumë mirë me çimenton.**






Fig.4.2.1.5.1: Varësia e  $f_{cm,180}$  me raportin ujë/çimento për të tre agregatet, në kushte Normale


- Vlerat më të larta të  $f_{cm,180}$  marrim për raportin ujë/çimento ( $u/ç$ ) = 0.35, për të gjitha rastet e studimit. **Pra ndikimi i uljes së raportit  $u/ç$  në rritjen e vlerave të  $f_{cm,180}$ , nuk varet nga lloji i agregatit, nga klasa e ekspozimit, nga mosha e betonit.** Konkluzion ky që lexohet edhe në grafikët e mëposhtëm.



**Fig.4.2.1.5.2: Varësia e  $f_{cm,180}$ , për tre llojet e agregateve, për dy klasat Normale (N) dhe ujë deti (A); për raportin ujë/çimento 0.35**



**Fig.4.2.1.5.3: Varësia e  $f_{cm,180}$ , për tre llojet e agregateve, për dy klasat Normale (N) dhe ujë deti (A); për raportin ujë/çimento 0.35**



**Fig.4.2.1.5.4: Varësia e  $f_{cm,180}$ , për tre llojet e agregateve, për dy klasat Normale (N) dhe ujë deti (A); për raportin ujë/çimento 0.47**


#### **4.2.2Ndikimii Kohës së Maturimit në Rezistencën në Shtypje**

Në këtë nën kapitull analizojmë ndikimin e moshës së betonit ose kohës së maturimit të betonit, në vlerat e rezistencës në shtypje. Kjo varësi studiohet për tre llojet e agregateve, për tre raporte  $u/\zeta$ , për dy klasat e ekspozimit N dhe A.

Në fund bëjmë krahasimet.

##### **4.2.2.1 Ndikimi i kohës së maturimit në rezistencën në shtypje Për agregate mali (K)**


Me rezultatet e mara nga analizat laboratorike ndërtojmë garfikët e mëposhtëm të cilat shprehin varësinë e vlerave të Rezistenca në shtypje në lidhje me moshën për agregate të malit të Krujës dhe për tre raporte ujë/çimento, si në figurat 4.16-4.20:



**Fig.4.2.2.1.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.35$ ; në kushte Normale; për agregate mali (K)**

Referuar grafikut të mësipërm themi që:


- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jolineare rritëse, me ekuacion  $y = 10.60x + 28.91$ .
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Për raportin  $u/\zeta = 0.35$  marim vlerat  $f_{cm,7}$  (N-7 ditë) = 36.895 N/mm² = 70%  $f_{cm,28}$  (N-28 ditë);  $f_{cm,90}$  (N-90 ditë) = 62.814 N/mm² = 118%  $f_{cm,28}$  (N-28 ditë);  $f_{cm,180}$  (N-180 ditë) = 68.965 N/mm² = 130%  $f_{cm,28}$  (N-28 ditë);
- Grafiku për këtë raport  $u/\zeta = 0.35$  është  $R^2 = 0.957$



**Fig.4.2.2.1.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.4$ ; në kushte Normale; për agregate mali (K)**

Referuar grafikut të mësipërm themi që:


- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jo lineare rritës dhe ekuacion  $y = 5.986 x + 28.36$ .
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Për raportin  $u/\zeta = 0.4$  marim vlerat  $f_{cm,7}$  (N-7 ditë) = 32.589 N/mm<sup>2</sup> = 70%  $f_{cm,28}$  (N-28 ditë);  $f_{cm,90}$  (N-90 ditë) = 49.294 N/mm<sup>2</sup> = 118%  $f_{cm,28}$  (N-28 ditë);  $f_{cm,180}$  (N-180 ditë) = 49.940 N/mm<sup>2</sup> = 130%  $f_{cm,28}$  (N-28 ditë);
- Vlerat e larta të Rezistencës në shtypje 7 ditore janë rezultat i përdorimit të çimentos Portland CEM 42.5R dhe të shtesës së lëngët i cili është superfluid.
- Grafiku për këtë raport  $u/\zeta = 0.4$  është  $R^2 = 0.904$  pra më pak i pjerrët se grafiku i raportit  $u/\zeta = 0.35$ .
- Vlerat respective të rezistencave  $f_{cm}$ , (N- 7 ditë; 28 ditë; 90 ditë; 180 ditë) të këtij raporti  $u/\zeta = 0.4$  janë rreth 88%; 78%; 78%; 72 % të vlerave të Rezistencës në shtypje për raportin  $u/\zeta = 0.35$ . Pra me rritjen e raportit  $u/\zeta$  vlerat e  $f_{cm}$ , zvogëlohen.
- Betoni i projektuar nga ne është C 35/ 45. Vlera e kërkuar e  $f_{cm,28}$  (28 ditore) = 45 N/mm<sup>2</sup>. Këtë vlerë ne e kapim vetëm në kohën e maturimit 90 ditore. Konkretisht vlera për ne është  $f_{cm,28} = 41.486$  N/ mm<sup>2</sup> (28 ditore). Pra rritja e raportit  $u/\zeta$  na rezultoi që ne nuk kapim në kohën e duhur rezistencën e projektuar.



**Fig.4.2.2.1.3:Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje me moshën, për raportin  $u/\bar{c} = 0.47$ ; në kushte Normale; për agregate mali (K)**

Referuar grafikut të mësipërm themi që:


- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jo lineare rritës me ekuacion  $y = 6.066x + 22.90$ .
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Për raportin  $u/\bar{c} = 0.47$  marim vlerat  $f_{cm}$  (N-7 ditë) = 25.788 N/mm<sup>2</sup> = 67% Rezistenca në shtypje (N-28 ditë); Rezistenca në shtypje (N-90 ditë) = 43.369 N/mm<sup>2</sup> = 112% Rezistenca në shtypje (N-28 ditë);  $f_{cm}$  (N-180 ditë) = 44.451 N/mm<sup>2</sup> = 115%  $f_{cm}$  (N-28 ditë);
- Grafiku për këtë raport  $u/\bar{c} = 0.47$  është  $R^2 = 0.836$  pra më pak i pjerrët se grafiku i raportit  $u/\bar{c} = 0.35$ .
- Vlerat respective të rezistencave  $f_{cm}$  (N- 7 ditë; 28 ditë; 90 ditë; 180 ditë) të këtij raporti  $u/\bar{c} = 0.47$  janë rreth 70%; 73%; 69%; 64 % të vlerave të Rezistenca në shtypje për raportin  $u/\bar{c} = 0.35$ . Pra me rritjen e raportit  $u/\bar{c}$  vlerat e Rezistenca në shtypje zvogëlohen.
- Betoni i projektuar nga ne është C 35/ 45. Vlera e kërkuar e  $f_{cm}$ (28 ditore) = 45 N/mm<sup>2</sup>. Këtë vlerë ne e kapim vetëm në kohën e maturimit 90 ditore. Konkretisht vlera për ne është  $f_{cm} = 38.693$  N/mm<sup>2</sup> (28 ditore). Pra rritja e raportit  $u/\bar{c}$  na rezultoi që ne nuk kapim në kohën e duhur rezistencën e projektuar.



**Fig.4.2.2.1.4:Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\varphi = 0.35$ ; në kushte Agresive ujë deti; për agregate mali (K)**

Referuar grafikut të mësipërm themi që:


- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jo lineare.
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Për raportin  $u/\varphi = 0.35$  marim vlerat  $f_{cm}$  (N-7 ditë)= 36.895N/mm2 = 70%  $f_{cm}$  ( N-28 ditë);  $f_{cm}$  ( N-90 ditë)= 62.814 N/mm2 = 118%  $f_{cm}$  ( N-28 ditë);  $f_{cm}$  ( N-180 ditë)= 68.965 N/mm2 = 130%  $f_{cm}$  ( N-28 ditë);
- Grafiku për këtë raport  $u/\varphi = 0.35$  është  $R^2 = 0.957$



**Fig.4.2.2.1.5:Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.4$ ; në kushte Agresive ujë deti; për agregate mali (K)**

Referuar grafikut të mësipërm themi që:

- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jo lineare.
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Për raportin  $u/\zeta = 0.4$  marim vlerat  $f_{cm}$  (N-7 ditë) = 32.589 N/mm² = 70%  $f_{cm}$  (N-28 ditë); Rezistenca në shtypje (N-90 ditë) = 49.294 N/mm² = 118%  $f_{cm}$  (N-28 ditë);  $f_{cm}$  (N-180 ditë) = 49.940 N/mm² = 130%  $f_{cm}$  (N-28 ditë);
- Vlerat e larta të Rezistencës në shtypje 7 ditore janë rezultat i përdorimit të çimentos Portland CEM 42.5R dhe të shtesës së lëngët i cili është superfluid.
- Grafiku për këtë raport  $u/\zeta = 0.4$  është  $R^2 = 0.904$  pra më pak i pjerrët se grafiku i raportit  $u/\zeta = 0.35$ .
- Vlerat respective të rezistencave  $f_{cm}$  (N- 7 ditë; 28 ditë; 90 ditë; 180 ditë) të këtij raporti  $u/\zeta = 0.4$  janë rreth 88%; 78%; 78%; 72 % të vlerave të  $f_{cm}$  për raportin  $u/\zeta = 0.35$ . Pra me rritjen e raportit  $u/\zeta$  vlerat e Rezistencës në shtypje zvogëlohen.
- Betoni i projektuar nga ne është C 35/ 45. Vlera e kërkuar e  $f_{cm}$ (28 ditore) = 45 N/mm². Këtë vlerë ne e kapim vetëm në kohën e maturimit 90 ditore. Konkretisht vlera për ne është  $f_{cm} = 41.486$  N/ mm² (28 ditore). Pra rritja e raportit  $u/\zeta$  na rezultoi që ne nuk kapim në kohën e duhur rezistencën e projektuar.




**Fig.4.2.2.1.6:Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\varphi = 0.47$ ; në kushte Agresive ujë deti; për agregate mali (K)**

Referuar grafikut të mësipërm themi që:

- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jo lineare.
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Për raportin  $u/\varphi = 0.47$  marim vlerat  $f_{cm}$  (N-7 ditë) = 25.788 N/mm<sup>2</sup> = 67%  $f_{cm}$  (N-28 ditë);  $f_{cm}$  (N-90 ditë) = 43.369 N/mm<sup>2</sup> = 112%  $f_{cm}$  (N-28 ditë);  $f_{cm}$  (N-180 ditë) = 44.451 N/mm<sup>2</sup> = 115%  $f_{cm}$  (N-28 ditë);
- Grafiku për këtë raport  $u/\varphi = 0.47$  është  $R^2 = 0.459$ , pra më pak i pjerrët se grafiku i raportit  $u/\varphi = 0.35$ .
- Vlerat respective të rezistencave  $f_{cm}$  (N- 7 ditë; 28 ditë; 90 ditë; 180 ditë) të këtij raporti  $u/\varphi = 0.47$  janë rreth 70%; 73%; 69%; 64 % të vlerave të  $f_{cm}$  për raportin  $u/\varphi = 0.35$ . Pra me rritjen e raportit  $u/\varphi$  vlerat e  $f_{cm}$  zvogëlohen.
- Betoni i projektuar nga ne është C 35/ 45. Vlera e kërkuar e Rezistenca në shtypje (28 ditore) = 45 N/mm<sup>2</sup>. Këtë vlerë ne e kapim vetëm në kohën e maturimit 90 ditore. Konkretisht vlera për ne është  $f_{cm} = 38.693 \text{ N/mm}^2$  (28 ditore). Pra rritja e raportit  $u/\varphi$  na rezultoi që ne nuk kapim në kohën e duhur rezistencën e projektuar.


#### 4.2.2.2 Krahassimi i ndikimit të moshës në rezistencën në shtypje, për agregatet mali të Krujës




**Fig.4.2.2.2.1:Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për raport  $u/\varphi = 0.35, 0.4; 0.47$  kushte Agresive dhe Normale; për agregate mali (K)**

Nga grafiku i mësipërm analizojmë si më poshtë:


- Me rritjen e moshës së betonit, në kushtet ambientale të kantjerit,  $f_{cm}$  rritet në varësi të drejtë, në mënyrë të vazhdueshme dhe me tendencë rritëse, për betonete trajtuara në klasat e ekspozimit XC4.
- Me uljen e raportit  $u/\varphi$ , grafiku i vlerave të  $f_{cm}$ , bëhet më i pjerrët, dhe i largohet më shumë origjinës së koordinatave që do të thotë se vlerat e  $f_{cm}$  rriten. E vlefshme kjo për të dyja klasat e ekspozimit.
- Me rritjen e moshës së betonit, në kushtet ambientale të kantjerit, Rezistenca në shtypje rritet në varësi të drejtë, deri në moshën rreth 90 ditë. **Pas kësaj periudhe maturimi vlerat e Rezistenca në shtypje, në kushtet e ujit të detit, bien.** Ky fenomen ndodh për arsye të depërtimit të ujit të detit në beton, pra përshkueshmëria e klorureve ndikon në uljen e Rezistenca në shtypje të betonit.
- Raporti ujë/çimento ndikon që ky fenomen të ndikojë më shpejt ose më vonë. Në analizë të këtyre grafikëve rezultojmë që ndikimi i depërtimit të klorureve në beton në  $u/\varphi=0.35$  haset pas 120 ditësh, në  $u/\varphi=0.4$  haset pas 100 ditësh, në  $u/\varphi=0.47$  haset pas rreth 90 ditësh. **Kështu themi që ndikimi i moshës së betonit, në kushtet e ujit të detit (XS), në vlerat e Rezistenca në shtypje, pas rreth 60 -90 ditë, vijnë duke u zvogëluar, kjo në varësi të raportit ujë/çimento.**




**Fig.4.2.2.2.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për raport  $u/\zeta = 0.4$ , kushte Agresive dhe Normale; për agregate mali (K)**




**Fig.4.2.2.2.3: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për raport  $u/\zeta = 0.47$ , kushte Agresive dhe Normale; për agregate mali (K)**




**Fig.4.2.2.2.4: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje, raportit  $u/\bar{c}$  dhe moshës për kushte Normale; për agregate mali (K)**



**Fig.4.2.2.2.5: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje, raportit  $u/\bar{c}$  dhe moshës për kushte Agresive; për agregate mali (K)**



**Fig.4.2.2.2.6: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës, për kushte Normale, për tre raporte  $u/\zeta$ ; për agregate mali (K)**




**Fig.4.2.2.2.7: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës, për kushte Agresive, për tre raporte  $u/\zeta$ ; për agregate mali (K)**

**Përmbledhje** e analizës së rezultateve të **testimeve të Rezistenca** në shtypje për materiale inerte mali, Fushë Krujë, kryesisht shkëmbinj gëlqerorë, janë si më poshtë:


- Vlerat e rezistencave në shtypje në varësi të moshës, për betonet më raportin ujë/çimento = 0.47 , të trajtuar në klasat e ekspozimit Normale dhe Agresive, vijnë duke u rritur në lidhje me moshën deri në moshën e maturimit prej 28 ditësh
- Vlerat e rezistencave në shtypje në varësi të moshës, për betonet më raportin ujë/çimento = 0.47, të trajtuar në klasat e ekspozimit Normale, vijnë duke u rritur në lidhje me moshën. Kjo rritje vijon respektivisht rreth 67-70% (7 ditë); 112-115% (90 ditë); 115-120% (180 ditë)
- Vlerat e rezistencave në shtypje në varësi të moshës, për betonet më raportin ujë/çimento = 0.47, të trajtuar në klasat e ekspozimit Agresive, vijnë duke u rritur në lidhje me moshën deri në moshën e maturimit prej 28 ditësh-. Pas kësaj kohe rezistenca e betonit vjen duke u ulur. Rezistenca 180 ditore ( $f_{cm} = 36.917 \text{ N/mm}^2$ ) është më e ulët se rezistenca 28 ditore ( $f_{cm} = 38.966 \text{ N/mm}^2$ ).
- Për këtë raport ujë/çimento  $> 0.4$ , nuk arrijmë rezistencën e dëshiruar.
- Vlerat më të larta të rezistencave i marrim për raportin ujë/çimento = 0.35. Për këtë raport u/ç pothuajse marim vlerën e rezistencës që pas 7 ditësh.
- Pjerrësia e grafikëve të varësisë së rezistencës nga koha e maturimit vijnë duke rënë nga klasat e ekspozimit Normale në Agresive.
- Pjerrësia e grafikëve të varësisë së rezistencës nga koha e maturimit vijnë duke rënë nga raportet u/ç 0.35 deri më 0.47.

#### 4.2.2.3 Ndikimi i kohës së maturimit në rezistencën në shtypje për materiale inerte nga lumi Erzen, Romanat (R)


*Agregati 2-lumi, Erzen, Romanat, të prodhuara në datat (datë 2.11.2013; 11.11.2013; 12.11.2013). Indeksi i këtyre betoneve është R-1-N (Romanat; u/ç= 0.45; Normale ekspozimi)*



**Fig.4.2.2.3.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin u/ç= 0.45; në kushte Normale; për agregate Romanati**




**Fig.4.2.2.3.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.4$ ; në kushte Normale; për agregate Romanati**




**Fig.4.2.2.3.3: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.35$ ; në kushte Normale; për agregate Romanati**

Nga grafikët e mësipërm analizojmë si më poshtë:


- Me rritjen e moshës së betonit , në kushtet ambientale të kantjerit, vlerat e Rezistenca në shtypje për betonet e prodhuara me materiale inerte lumi , Erzen , Romanat , rritet në varësi të drejtë, në mënyrë të vazhdueshme dhe me tendencë rritëse, për betonet e trajtuara ne klasat e ekspozimit XC4.
- Me uljen e raportit u/ç, grafiku i vlerave të Rezistenca në shtypje, **bëhet më i pak pjerrët**, dhe i largohet më shumë origjinës së koordinatave që do të thotë se vlerat e Rezistenca në shtypje rriten, por në krahasim me agregatin e malit këto ritme të rritjes janë më të vogla. E vlefshme kjo për të dyja klasat e ekspozimit.
- Me rritjen e moshës së betonit, në kushtet ambientale të kantjerit, Rezistenca në shtypje rritet në varësi të drejtë, deri në moshën rreth 90 ditë. **Pas kësaj periudhe maturimi vlerat e Rezistenca në shtypje, në kushtet e ujit të detit bien.** Ky fenomen ndodh për arsye të depërtimit të ujit të detit në beton, pra përshkueshmëria e klorureve ndikon në uljen e Rezistenca në shtypje të betonit.
- Raporti ujë/çimento ndikon që ky fenomen të ndikojë më shpejt ose më vonë. Në analizë të këtyre grafikëve rezultojmë që ndikimi i depërtimit të klorureve në beton në u/ç=0.35 haset pas 120 ditësh, në u/ç=0.4 haset pas 100 ditësh, në u/ç=0.45 haset pas rreth 90 ditësh. **Kështu themi që ndikimi i moshës së betonit , në kushtet e ujit të detit (XS) , në vlerat e Rezistenca në shtypje, pas reth 60 -90 ditë, vijnë duke u zvogëluar , kjo në varësi të raportit ujë/çimento.**



**Fig.4.2.2.3.4: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin u/ç= 0.45; në kushte Agresive ujë deti; për agregate Romanati**



**Fig.4.2.2.3.5: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.4$ ; në kushte Agresive ujë deti; për agregate Romanati**



**Fig.4.2.2.3.6: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.35$ ; në kushte Agresive ujë deti; për agregate Romanati**

Referuar grafikut të mësipërm themi që:

- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jo lineare.
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Për raportin  $u/\epsilon = 0.45$  marim vlerat Rezistenca në shtypje (N-7 ditë)  $f_{cm} = 26.655 \text{ N/mm}^2 = 70\%$  Rezistenca në shtypje ( N-28 ditë)  $f_{cm} = 38.266$ ; Rezistenca në shtypje ( N-90 ditë)  $f_{cm} = 42.967 \text{ N/mm}^2 = 112\%$  Rezistenca në shtypje ( N-28 ditë); Rezistenca në shtypje ( N-180 ditë)  $= f_{cm} = 45.054 \text{ N/mm}^2 = 118\%$  Rezistenca në shtypje ( N-28 ditë);
- Grafiku për këtë raport  $u/\epsilon = 0.45$  është  $R^2 = 0.674$ , pra më i pjerrët se grafiku i raportit  $u/\epsilon = 0.35$  ku  $R^2 = 0.576$ . Pra për agregatin e lumit Erzen, Romanat, ritmet e rritjes së vlerave të Rezistenca në shtypje janë më të vogla se në agregatin e malit. Kjo është e vlefshme për të dy ja klasat e ekspozimit.
- Vlerat respective të rezistencave Rezistenca në shtypje (N- 7 ditë; 28 ditë; 90 ditë; 180 ditë) të këtij raporti  $u/\epsilon = 0.45$  janë rreth 70%; 73%; 69%; 64 % të vlerave të Rezistenca në shtypje për raportin  $u/\epsilon = 0.35$ . Pra me rritjen e raportit  $u/\epsilon$  vlerat e Rezistenca në shtypje zvogëlohen.
- Betoni i projektuar nga ne është C 35/ 45; Vlera e kërkuar e Rezistenca në shtypje(28 ditore)  $f_{cm} = 45 \text{ N/mm}^2$ . Këtë vlerë ne e **kapim vetëm në kohën e maturimit 28 ditore** për raportin  $u/\epsilon = 0.35$ . Konkretisht vlera për ne është Rezistenca në shtypje= 46.696 N/ mm<sup>2</sup> (28 ditore). Pra rritja e raportit  $u/\epsilon$  na rezultoi që ne nuk kapim në kohën e duhur rezistencën e projektuar për raportet  $u/\epsilon = 0.4; 0.45$ .

Megjithatë vëmë re gjatë kohës së përgatitjes së betonit të freskët, në qoftë se punueshmëria ulet shumë, mbi S4, betoni kompaktësohet me vështirësi dhe për rrjedhojë zvogëlohet rezistenca Rezistenca në shtypje.

Për tre llojet e aggregateve të marra dhe dy kushtet ambientale të trajtimit të betonit, **rezistenca në shtypje në çdo moshë varet vetëm nga raporti ujë/çimento**, nëse do tentojmë në ngjeshjen e betonit më të mirë që mund të arrihet.

#### 4.2.2.4 Krahasimi i ndikimit të moshës në rezistencën në shtypje, për agregatet Lumit, të Romanatit




Fig.4.2.2.4.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për raport  $u/\zeta = 0.45$ , në kushte Agresive dhe Normale; për agregate Romanati







Fig.4.2.2.4.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për raport  $u/\zeta = 0.40$ , në kushte Agresive dhe Normale; për agregate Romanati




**Fig.4.2.2.4.3: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për raport  $u/\zeta = 0.35$ , në kushte Agresive dhe Normale; për agregate Romanati**




**Fig.4.2.2.4.4: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit  $u/\zeta$  për kushte Normale; për agregate Romanati**



**Fig.4.2.2.4.5: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit  $u/\sigma$  përkushte Agresive; për agregate Romanati**



**Fig.4.2.2.4.6: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës, për kushte Normale, për tre raporte  $u/\sigma$ ; për agregate Romanati**



**Fig.4.2.2.4.7: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për kushte Agresive, për tre raporte  $u/\zeta$ ; për agregate Romanati**

Referuar grafikëve të mësipërm për betonet e prodhuara me agregate Romanati themi që:

- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jo lineare.
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Pra për agregatin e lumit Erzen, Romanat, ritmet e rritjes së vlerave të Rezistencës në shtypje janë më të vogla se në agregatin e malit. Kjo është e vlefshme për të dy ja klasat e ekspozimit.
- Pra me rritjen e raportit  $u/\zeta$  vlerat e Rezistencës në shtypje zvogëlohen.
- Vlerën e Rezistencës në shtypje të kërkuar ne e **kapim vetëm në kohën e maturimit 28 ditore** për raportin  $u/\zeta = 0.35$ . Konkretisht vlera për ne është Rezistenca në shtypje  $f_{cm} = 46.696 \text{ N/mm}^2$  (28 ditore). Pra rritja e raportit  $u/\zeta$  na rezultoi që ne nuk kapim në kohën e duhur rezistencën e projektuar për raportet  $u/\zeta = 0.4; 0.45$ .


Megjithatë vëmë re gjatë kohës së përgatitjes së betonit të freskët, në qoftë se punueshmëria ulet shumë, mbi S4, betoni kompaktësohet me vështirësi dhe për rrjedhojë zvogëlohet rezistenca Rezistenca në shtypje.

Për tre llojet e agregateve të marra dhe dy kushtet ambientale të trajtimit të betonit, **rezistenca në shtypje në çdo moshë varet vetëm nga raporti ujë/çimento**, nëse do tentojmë në ngjeshjen e betonit më të mirë që mund të arrihet.

#### 4.2.2.5 Ndikimi i kohës së maturimit në rezistencën në shtypje për agregate nga lumi Mat, Milot (R)

*Agregati 3- të prodhuara në datat (datë 13.01.2014; 27.01.2014)*

Me rezultatet e marra nga analizat laboratorike ndërtojmë grafikët e mëposhtëm, për tre raporte ujë/çimento dhe për dy klasat e ekspozimit XC4 dhe XS. Bëjmë interpretimet dhe krahasimet e rezultateve në secilin rast.



**Fig.4.2.2.5.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin u/ç= 0.45;në kushte Normale; për agregate Miloti**

Indeksimi i këtyre betoneve është M-1-N (Milot- u/ç= 0.45- Normale ekspozimi); M-2-N (Milot- u/ç= 0.4- Normale ekspozimi); M-3-N (Milot- u/ç= 0.34- Normale ekspozimi); M-4-A (Milot- u/ç= 0.45- Agresive ekspozimi); M-5-A (Milot- u/ç= 0.4- Agresive ekspozimi); M-6-A (Milot- u/ç= 0.34- Agresive ekspozimi)

Konkretisht në grafikun e mësipërm vlerat e Rezistenca në shtypje për këtë raport janë respektivisht:


Rezistenca në shtypje (7 ditë)  $f_{cm} = 31.020 \text{ N/mm}^2 = 70\%$ ; Rezistenca në shtypje (28 ditë)  $f_{cm} = 44.439 \text{ N/mm}^2$

Rezistenca në shtypje (90 ditë)  $f_{cm} = 46.562 \text{ N/mm}^2 = 105\%$ ; Rezistenca në shtypje (28 ditë)  $f_{cm} = 44.439 \text{ N/mm}^2$


Rezistenca në shtypje (180 ditë)  $f_{cm} = 46.562 \text{ N/mm}^2 = 110\%$ ; Rezistenca në shtypje (28 ditë)  $f_{cm} = 44.439 \text{ N/mm}^2$

**Krahasuar këto ritme rritje me ritmet e rritjes së Rezistencës në shtypje respektive për dy agregatet e tjera është më i ulët.**

Por theksojmë që rezistencën e kërkuar Rezistenca në shtypje-M-N (28 ditë)  $f_{cm,28} = 45 \text{ N/mm}^2$  ne e kapim si vlerë edhe ne raportin  $u/\zeta=0.45$ , që tregon që agregati i lumit të Matit, i cili është një lum i thellë dhe me prejardhje magmatike, e për rrjedhojë edhe agregate janë më homogjene, më të ngjeshura dhe më të rrumbullakosura.




**Fig.4.2.2.5.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.4$ ; në kushte Normale; për agregate Miloti**




**Fig.4.2.2.5.3: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.34$ ; në kushte Normale; për agregate Miloti**


- Nga analiza e grafikëve të mësipërm theksojmë që rezistencën e kërkuar Rezistenca në shtypje (28 ditë)  $f_{cm} = 45 \text{ N/mm}^2$  ne e kapim, si vlerë edhe ne raportin  $u/\zeta = 0.4$  dhe  $0.34$ , që tregon që agregati i lumit të Matit, i cili është një lum i thellë dhe me prejardhje magmatike, e për rrjedhojë edhe materiale inerte janë më homogjene, më të ngjeshura dhe më të rrumbullakosura.
- Pra raporti ujë/çimento ndikon më pak në vlerat e Rezistenca në shtypje, në betonin ma materiale inerte lumi, Milot se nëbetonet me agregate lumi Romanat dhe me materiale inerte mali Krujë.



**Fig.4.2.2.5.4: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.45$ ; në kushte Agresive ujë deti; për agregate Miloti**



**Fig.4.2.2.5.5: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.4$ ; në kushte Agresive ujë deti; për agregate Miloti**



**Fig.4.2.2.5.6: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\varphi = 0.34$ ; në kushte Agresive ujë deti; për agregate Miloti**

#### ***Në analizë të grafikëve të mësipërm analizojmë***

Konkretisht në grafikun e mësipërm vlerat e Rezistencës në shtypje-M-A për këtë raport janë respektivisht:

Rezistenca në shtypje (7 ditë)  $f_{cm} = 33.672 \text{ N/mm}^2 = 71\%$  Rezistenca në shtypje (28 ditë)  $f_{cm} = 47.696 \text{ N/mm}^2$

Rezistenca në shtypje (90 ditë)  $f_{cm} = 46.400 \text{ N/mm}^2 = 97\%$  Rezistenca në shtypje (28 ditë)  $f_{cm} = 47.696 \text{ N/mm}^2$

Rezistenca në shtypje (180 ditë)  $f_{cm} = 41.566 \text{ N/mm}^2 = 87\%$  Rezistenca në shtypje (28 ditë)  $f_{cm} = 47.696 \text{ N/mm}^2$

Krahasuar këto ritme rritje me ritmet e rritjes së Rezistencës në shtypje respektive për dy agregatet e tjera është më i ulët.

Theksojmë që rezistencën e kërkuar në shtypje-M-A (28 ditë)  $f_{cm} = 45 \text{ N/mm}^2$  ne e kapim si vlerë edhe në raportin  $u/\varphi = 0.45$ , që tregon që agregati i lumit të Matit, i cili është një lum i thellë dhe me prejardhje magmatike, e për rrjedhojë edhe materiale inerte janë më homogjene, më të ngjeshura dhe më të rumbullakosura.

Pas rreth 50 ditësh vlerat e Rezistencës në shtypje-M-A vijnë duke rënë, për shkak të ndikimit të klorureve, por për këtë agregat ndikimet ndihen pas një kohe më të gjatë se në dy agregatet e tjera.

#### 4.1.2.6 Krahاسimi i ndikimit të moshës në rezistencën në shtypje, për agregatet Lumit, të Milotit




Fig.4.2.2.6.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit u/ç për kushte Normale; për agregate Miloti






Fig.4.2.2.6.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit u/ç për kushte Agresive; për agregate Miloti



**Fig.4.2.2.6.3: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për kushte Normale; për agregate Miloti**




**Fig.4.2.2.6.4: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe moshës për kushte Agresive; për agregate Miloti**


Referuar grafikëve të mësipërm për betonet e prodhuara me **agregate Miloti** analizojmë që:

- Grafiku i varësisë së Rezistenca në shtypje dhe moshës së maturimit është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Ky grafik, i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje, është një varësi jo lineare.
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Pra për agregatin e **lunit Mat, Milot**, ritmet e rritjes së vlerave të Rezistenca në shtypje janë më të vogla se në agregatin e malit dhe të Romanatit. Kjo është e vlefshme për të dy ja klasat e ekspozimit.
- Pra me rritjen e raportit u/ç vlerat e Rezistenca në shtypje zvogëlohen.
- Nga analiza e grafikëve, ne rikonfirmojmë rezultatet teorike që vlerat maksimale të rritjes së Rezistenca në shtypje arrijnë pas 28 ditësh. Ne konfirmojmë që edhe për betonet e përgatitura me materiale inerte Miloti ky rezultat merret për të dy kushtet ambientale të ekspozimit N dhe A.
- Pas periudhës 90 ditore ose më shumë, kjo në varësi të raportit u/ç, vërejmë ulje të vlerave të Rezistenca në shtypje për betonet e trajtuara në ujë deti. Konludojmë që për betonet që punojnë në klasat XS të ekspozimit, pavarësisht nga lloji i agregatit të përdorur, pas një moshe të betonit ndikimi i klorureve në Rezistenca në shtypje bëhet gjithnjë edhe më i dukshëm.
- Për klasat XS të ekspozimit, rënia e vlerave të Rezistenca në shtypje (90 ditore) = 97%; Rezistenca në shtypje (28 ditore) dhe për raportin u/ç = 0.45 dhe Rezistenca në shtypje 90 ditore) = 90%; Rezistenca në shtypje (28 ditore) dhe për raportin u/ç = 0.34. Ndërsa Rezistenca në shtypje (180 ditore) = 86-87%; Rezistenca në shtypje (28 ditore) për raportin u/ç = 0.34; 0.4; 0.45.
- Vlerat e Rezistenca në shtypje-M-N (180 ditore)  $f_{cm} = 54.379 - 61.365 \text{ N/mm}^2$ , për betonin e projektuar C 35/45 ose 21%- 36% më e lartë se klasa e kërkuar .


**4.1.2.7 Krahasimi i vlerave të Rezistencës në shtypje në varësi të moshës së maturimit, klasave të ekspozimit dhe raportit  $u/\zeta$  për agaregate të lumit Mat, në Milot**



**Fig.4.2.2.7.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe kladave të ekspozimit për raport  $u/\zeta = 0.45$ ; për agregate Miloti**



**Fig.4.2.2.7.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe kladave të ekspozimit për raport  $u/\zeta = 0.4$ ; për agregate Miloti**



**Fig.4.2.2.7.3: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe kladave të ekspozimit për raport  $u/\zeta = 0.34$ ; për agregate Miloti**


Referuar grafikëve të mësipërm për betonet e prodhuara me agregate Miloti themi që:

- Grafiku i varësisë ndërmjet kohës së maturimit dhe rezistencës në shtypje është një varësi jo lineare.
- Grafiku është ndërtuar për moshat 7, 28, 90, 180 ditore.
- Rezistenca në shtypje rritet me rritje e moshës së maturimit për klasat e ekspozimit Normal.
- Pra për agregatin e lumit Mat, në Milot, ritmet e rritjes së vlerave të Rezistencës në shtypje janë më të vogla se në agregatin e malit dhe të Romanatit. Kjo është e vlefshme për të dyja klasat e ekspozimit.
- Pra me rritjen e raportit  $u/\zeta$  vlerat e Rezistenca në shtypje zvogëlohen.
- Vlerën e Rezistencës në shtypje të kërkuar ne e **kapim vetëm në kohën e maturimit 28 ditore** edhe për raportin  $u/\zeta = 0.45$ .

#### **4.2.3 Krahassimi ndikimi i klasave të ekspozimit ambjental në rezistencën në shtypje në varësi të agregateve**

##### **4.2.3.1 Krahassimi për ndikimin e kushteve të ekspozicionit.**

Rezistenca në shtypje për betonin 35/45 ( $N/mm^2$ ) të prodhuar me **agregate mali** (K) të marra në Fushë Krujë nga “VEGA” shpk me indeksimet  $u/\zeta=0.35$ (K-3-N);  $u/\zeta=0.40$  (K-2-N);  $u/\zeta=0.47$  (K-1-N);  $u/\zeta=0.35$ (K-3-A);  $u/\zeta=0.40$ (K-2-A);  $u/\zeta=0.47$  (K-1-A), të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të Agresiv ujë deti dhe Normal, është analizuar në grafikun e mëposhtëm :




**Fig.4.2.3.1.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin u/ç= 0.35; 0.4; 0.47; në ambjent Normal dhe Agresive; për agregate mali (K)**

Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për të dy kushtet Agresive dhe normale ekspozimi.

Vlerat e rezistencave, deri në maturimin 28 ditor, pothajse nuk ndryshojnë në varësi të kushteve të ekspozimit ambjental. Madje në më të shumtën vlerat e rezistencës në ambjentin detar janë pak më të larta, rreth 2-3 %.

#### 4.2.3.2 Krahësimi për ndikimin e klasës së ekspozimit ambjental.

Rezistenca në shtypje për betonin 35/45 (45N/ mm<sup>2</sup>) të prodhuar me **agregate lumi** (R) të marra në Romanat nga lumi Erzen me indeksimet , për tre raporte u/ç: u/ç=0.35(R-3-N); u/ç=0.40 (R-2-N); u/ç=0.45 (R-1-N); u/ç=0.35(R-3-A); u/ç=0.40 (R-2-A); u/ç=0.45 (R-1-A), të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të Agresiv ujë deti dhe Normal, është analizuar në grafikun e mëposhtëm.




**Fig.4.2.3.2.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin u/ç= 0.35; 0.4; 0.45; në ambjent Normal dhe Agresiv; për agregate lumi (R)**

Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për të dy kushtet Agresive dhe normale ekspozimi.

Vlerat e rezistencave, deri në maturimin 28 ditor, pothajse nuk ndryshojnë në varësi të kushteve të ekspozimit ambjental. Madje në më të shumtën vlerat e rezistencës në ambjentin detar janë pak më të larta, rreth 3 %.

#### 4.2.3.3 Krahاسimi i ndikimit të klasave të ekspozimit ambjental me rezistencën në shtypje 28 ditore për betonin 35/45 (45N/mm<sup>2</sup>) të prodhuar me agregate lumi

Krahاسimi i ndikimit të klasave të ekspozimit ambjental me rezistencën në shtypje 28 ditore për betonin 35/45 (45N/mm<sup>2</sup>) të prodhuar me agregate lumi(M) të marra në Milot nga lumi Mat me indeksimet, për tre raporte u/ç: u/ç=0.34( M-3-N); u/ç=0.40 (M-2-N); u/ç=0.45 (M-1-N); u/ç=0.34 (M-3-A); u/ç=0.40 (M-2-A); u/ç=0.45 (M-1-A), të trajtuar në kushtet e ekspozimit ambjental të Agresiv ujë deti dhe Normale, është analizuar në grafikun e mëposhtëm.



**Fig.4.2.3.3.1:Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje dhe raportit ujë/çimento, për maturim 28 ditor, për raportin u/ç= 0.34; 0.4; 0.45; në ambjent Normal dhe Agresiv; për agregate lumi (M)**

Nga grafiku shihet se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për të dy kushtet Agresive dhe normale ekspozimi.

Vlerat e rezistencave, deri në maturimin 28 ditor, pothajse nuk ndryshojnë në varësi të kushteve të ekspozimit ambjental. Madje në më të shumtën vlerat e rezistencës në ambjentin detar janë pak më të larta, rreth 2-3 %.

#### 4.2.3.4 Krahasimi i ndikimit të klasave të ekspozimit për të tre llojet e agregateve në Rezistencën në shtypje 28 ditore




Fig.4.2.3.4.1: Ndikimi i klasave të ekspozimit në rezistencën në shtypje për tre agregatesh

Në analizë të grafikëve të mësipërm themi:


- Se vlerat e rezistencës në shtypje 28 ditore rriten me zvogëlimin e raportit ujë/çimento, për të dy kushtet Agresive dhe normale ekspozimi.
- Vlerat e rezistencave, deri në maturimin 28 ditor, pothajse nuk ndryshojnë në varësi të kushteve të ekspozimit ambjental. Madje në më të shumtën vlerat e rezistencës në ambjentin detar janë pak më të larta, rreth 3-5 %.
- Pavarësisht nga lloji i agregatit të përdorur vlerat e Rezistencës në shtypje vijnë duke rënë me rritjen e moshës së betonit. Kjo ulje vjen duke rënë në %.

#### 4.2.4 Krahasimi i ndikimit të llojeve të agregateve të përdorur në Rezistencën në shtypje


##### *Rezistenca mekanike, për të treja llojet e agregateve*

Në grafikët e mëposhtëm po japim një përmbledhje të rezultateve të nxjera nga analizat e grafikëve të deritanishëm.


Në çdo rast eksperimental ne konstatojmë që vlerat e Rezistencës në shtypje ndikohen nga lloji i agregatit të përdorur. Kjo rikonfirmohet edhe nga grafikët e mëposhtëm, pavarësisht moshës së betonit dhe raportit u/ç apo kushteve të punës së objektit të ndërtimit.




**Fig.4.2.4.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.47$ ; 0.45; në kushte Agresive**




**Fig.4.2.4.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.47$ ; 0.45; në kushte Agresive**




**Fig.4.2.4.3: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.4$ ; në kushte Normale**



**Fig.4.2.4.4: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.4$ ; në kushte Normale**



**Fig.4.2.4.5: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.35$ ; në kushte Normale**



**Fig.4.2.4.6: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje moshës, për raportin  $u/\zeta = 0.35$ ; në kushte Normale**




Fig.4.2.4.7: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje për kubet e trajtuara në kushte Normale




Fig.4.2.4.8: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje për kubet e trajtuara në kushte Normale




Fig.4.2.4.9: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje për kubet e trajtuara në kushte Agresive




Fig.4.2.4.10: Varësia ndërmjet Rezistencës në shtypje për kubet e trajtuara në kushte Agresive

Në analizë të grafikëve të mësipërm konkludojmë:

- Rezistenca në shtypje ndryshon në varësi të llojit të agregatit.
- Vlerat më të larta i kapim më shpejt për betonin e përgatitur me agregatin e lumit të Matit, Milotit. Pas 90 ditësh edhe vlerat e Rezistencës në shtypje për betonin me përbërje agregate mali, FushëKrujë kapin të njejtat vlera.
- Vlerat më të ulta të Rezistencës në shtypje i marrim për betonin me materiale inerte Romanati, lumi Erzen. Arësyeja pasi ky lum është fushor dhe agregatet e marra prej tij kanë një përmbajtje të lartë fileri, janë më gëlqerorë.


### 4.3 REZISTENCA NË TËRHEQJE

Me mostrat e betonit të përgatitura nga ne dhe të trajtuara në dy kushtet ambientale të ekspozimit, i testojmë për të marrë vlerat e rezistencës në tërheqje ( $f_{tm, 28}$ ) për moshën 28 ditore. Me këto vlera ndërtojmë grafikët e mëposhtëm.

Analizojmë faktorët qëndikojnë në vlerat e  $f_{tm}$ .

#### 4.3.1 Ndikimi i rezistencës në tërheqje nga raporti $u/\zeta$

**4.3.1.1 Ndikimi i rezistencës në tërheqje nga raporti  $u/\zeta$  dhe klasat e ekspozimit ambiental për agregate mali, të marra në Fushë Krujë (K), për beton të klasës C35/45**



**Fig.4.3.1.1: Varësia ndërmjet Rezistencës në tërheqje dhe raport  $u/\zeta$ , kushte Agresive dhe Normale; me agregate mali Fushë Krujë**

Referuar grafikëve, vlerat e rezistencës në tërheqje, 28 ditore të testuar, për cilindrat e betonit me përmasa 15\*30 cm, nxjerrim këto analiza:

- Vlerat e rezistencës në tërheqje (28 ditore) ndryshojnë në vlerat  $f_{tm,28} = 2.568 - 4.221 \text{ N/mm}^2$ .
- Rezistenca në tërheqje rritet me uljen e raportit u/ç.
- Vlerat më të mëdha janë kapur në kubet e betonit të trajtuara në ujë deti. Kjo për faktin që përshkueshmëria e klorureve rritet pas 28 ditëve, factor i cili bën që rezistenca të rritet pasi lagështia, e domosdoshme në periudhën e ngurtësimit, në këtë ambient është maksimale.
- Këto rezultate të vlerave të rezistencës në tërheqje i vëmë re në të tre llojet e agregateve, pra këto ndryshime nuk varen nga lloji i agregatit.
- Kjo varësi nuk është lineare

#### 4.3.1.2 Ndikimi i rezistencës në tërheqje (28ditore) nga raporti u/ç dhe klasat e ekspozimit ambjental për agregate Lumi Erzen, të marra në Romanat (R), për beton të klasës C35/45





Fig.4.3.1.2: Varësia ndërmjet Rezistencës në tërheqje 28 ditore dhe raport u/ç, kushte Agresive dhe Normale; me agregate lumi Erzen, Romanat

**4.2.1.3 Ndikimi i rezistencës në tërheqje (28ditore) nga raporti u/ç dhe klasat e ekspozimit ambjental për agregate Lumi Mat, të marra në Milot (M), për beton të klasës C35/45**




**Fig.4.3.1.3: Varësia ndërmjet Rezistencës në tërheqje dhe raport u/ç, kushte Agresive dhe Normale; me agregate lumi Mat, Milot**


Referuar grafikëve të mësipërm analizojmë që:

- Këto rezultate të vlerave të rezistencës në tërheqje i vëmë re në të tre llojet e agregateve dhe në të dy klasat e ekspozicionit, pra këto ndryshime nuk varen nga lloji i agregatit.
- Theksojmë që testimet janë bërë për rezistencën në tërheqje 28 ditore.


**4.2.1.4 Krahasime për Rezistenca në tërheqje e betonit C35/45, në varësi të u/ç**



**Fig.4.3.1.4: Varësia ndërmjet Rezistencës në tërheqje, kushte Normale; me agregate mali dhe lumi**



**Fig.4.3.1.5: Varësia ndërmjet Rezistencës në tërheqje, kushte Agresive; me agregate mali dhe lumi**



**Fig.4.3.1.6: Varësia ndërmjet Rezistencës në tërheqje, kushte Agresive; me agregate mali dhe lumi**

Referuar grafikëve të mësipërm, vlerat e rezistencës në tërheqje, 28 ditore të testuar, për cilindrat e betonit, nxjerrim këto analiza:

- Vlerat e rezistencës në tërheqje (28 ditore) rriten me rritjen e moshës së betonit, pavarësisht nga llojet e agregateve dhe për klasat e ekspozimit Normal.
- Rezistenca në tërheqje rritet me uljen e raportit u/ç për të gjitha rastet e studimit.

- Vlerat më të mëdha janë kapur në kubet e betonit të trajtuara në ujë deti. Kjo për faktin që përshkueshmëria e klorureve rritet pas 28 ditëve, factor i cili bën që rezistenca të rritet pasi lagështia, e domosdoshme në periudhën e ngurtësimit, në këtë ambient është maksimale.
- Këto rezultate të vlerave të rezistencës në tërheqje i vëmë re në të tre llojet e agregateve, pra këto ndryshime nuk varen nga lloji i agregatit.
- Kjo varësi nuk është lineare.
- Vlerat më të larta të  $f_{tm}$  i marim për betonin e përgatitur më agregate lumit Mat.
- Për periudhën e studimit nuk marrim rënie të vlerave të  $f_{tm}$  për kushtet agresive të ekspozimit.
- Vlerat më të ulta të  $f_{tm}$  i marim për betonet e përgatitura me materiale inerte Romanati, të lumit Erzen.

#### 4.4. Moduli i Elasticitetit të betonit C35/45

Moduli i Elasticitetit (E), është në funksion të sforcimeve dhe të deformimeve. Sforcimet janë në përpjesëtim të drejtë me rezistencën në shtypje, analizimin e së cilës e bëmë më lart.

##### 4.4.1 Ndikimi i raportit ujë/çimento në modulin e elasticitetit




Fig.4.4.1.1:Moduli i Elasticitetit në varësi të Raportit ujë/çimento për materiale inerte mali, Fushë Krujë

Taleba 4.4.1.1: Raporti u/ç sipas ditëve (Normale Krujë)

| Normale Krujë | 7 ditore | 28 ditore | 90 ditore | 180ditore |
|---------------|----------|-----------|-----------|-----------|
| u/ç=0.35      | 3.04     | 3.64      | 3.96      | 4.15      |
| u/ç=0.40      | 2.85     | 3.22      | 3.51      | 3.53      |
| u/ç=0.47      | 2.54     | 3.11      | 3.29      | 3.33      |

Duke analizuar vlerat e Modulit të Elasticitetit, vijnë në përfundimin që për betonet e prodhuara me agregate mali, Fushë Krujë, rriten pavarësisht moshës së betonit apo raportit u/ç.

Në çdo rast betoni tkurret.




Fig.4.4.1.2: Moduli i Elasticitetit në varësi të Raportit ujë/çimento për materiale inerte mali, Fushë Krujë

**Taleba 4.4.1.2: Raporti u/ç sipas ditëve (Agresive Krujë)**

| AgresiveKrujë | 7 ditore | 28 ditore | 90 ditore | 180 ditore |
|---------------|----------|-----------|-----------|------------|
| u/ç=0.35      | 3.07     | 3.69      | 3.92      | 3.84       |
| u/ç=0.40      | 2.87     | 3.18      | 3.42      | 3.19       |
| u/ç=0.47      | 2.54     | 3.12      | 3.05      | 3.04       |




Fig.4.4.1.3: Moduli i Elasticitetit në varësi të Raportit ujë/çimento për agregate Lumi, Romanat

Taleba 4.4.1.3: Raporti u/ç sipas ditëve (Normale Romanat)

| Normale Romanat | 7 ditore | 28 ditore | 90 ditore | 180 ditore |
|-----------------|----------|-----------|-----------|------------|
| u/ç=0.35        | 2.65     | 3.38      | 3.44      | 3.57       |
| u/ç=0.40        | 2.61     | 3.26      | 3.45      | 3.54       |
| u/ç=0.45        | 2.58     | 3.09      | 3.28      | 3.36       |





Fig.4.4.1.4: Moduli i Elasticitetit në varësi të Raportit ujë/çimento për agregate Lumi, Romanat

**Taleba 4.4.1.4: Raporti u/ç sipas ditëve (Agresive Romanat)**

| Agresive Romanat | 7 ditore | 28 ditore | 90 ditore | 180 ditore |
|------------------|----------|-----------|-----------|------------|
| u/ç=0.35         | 2.69     | 3.42      | 3.39      | 2.95       |
| u/ç=0.40         | 2.64     | 3.36      | 3.39      | 3.34       |
| u/ç=0.45         | 2.61     | 3.28      | 3.19      | 3.31       |

Duke analizuar vlerat e Modulit të Elasticitetit, vijmë në përfundimin që për betonet e prodhuara me agregate lumi, Romanat, rriten pavarësisht moshës së betonit apo raportit u/ ç.

Në çdo rast betoni tkurret.



**Fig.4.4.1.5: Moduli i Elasticitetit në varësi të Raportit ujë/çimento për agregate Lumi, Miloti**

**Taleba 4.4.1.5: Raporti u/ç sipas ditëve (Agresive Romanat)**

| Normale Miloti | 7 ditore | 28 ditore | 90 ditore | 180 ditore |
|----------------|----------|-----------|-----------|------------|
| u/ç=0.34       | 3.17     | 3.61      | 3.88      | 3.92       |
| u/ç=0.40       | 2.98     | 3.52      | 3.65      | 3.69       |
| u/ç=0.45       | 2.78     | 3.33      | 3.41      | 3.50       |




Fig.4.4.1.6: Moduli i Elasticitetit në varësi të Raportit ujë/çimento për agregate Lumi, Miloti

Taleba 4.4.1.6: Raporti u/ç sipas ditëve (Agresive Romanat)

| Agresive, Miloti | 7 ditore | 28 ditore | 90 ditore | 180 ditore |
|------------------|----------|-----------|-----------|------------|
| u/ç=0.34         | 3.23     | 3.71      | 3.52      | 3.47       |
| u/ç=0.40         | 3.03     | 3.59      | 3.37      | 3.32       |
| u/ç=0.45         | 2.90     | 3.45      | 3.41      | 3.22       |

- Duke analizuar vlerat e Modulit të Elasticitetit, vijmë në përfundimin që për betonet e prodhuara me agregate lumi, Milot, rriten pavarësisht moshës së betonit apo raportit u/ç. Grafiku i E shkon në varësi lineare me grafikun e Rezistenca në shtypje. Ky fakt na rikonfirmon që ndikimi i faktorëve që ndikojnë në Rezistenca në shtypje është i njëjtë edhe për E.
- Vlerat e Modulit të Elasticitetit varen nga lloji i agregative të përdorur me modul elasticiteti (E) shumë të lartë, siç janë ato të Milotit.
- Në çdo rast betoni tkurret.

#### 4.4.2 Ndikimi i moshës së betonit në Modulin e Elasticitetit




Fig.4.4.2.1: Moduli i Elasticitetit në varësi të Moshës për materiale inerte mali, Fushë Krujë, Normale







Fig.4.4.2.2: Moduli i Elasticitetit në varësi të Moshës për materiale inerte mali, Fushë Krujë, Agresive




**Fig.4.4.2.3: Moduli i Elasticitetit në varësi të Moshës për agregate Lumi, Romanat, Normale**



**Fig.4.4.2.4: Moduli i Elasticitetit në varësi të Moshës për materiale inerte Lumi, Romanat, Agresive**



**Fig.4.4.2.5: Moduli i Elasticitetit në varësi të Moshës për agregate Lumi, Miloti, Normale**



**Fig.4.4.2.6: Moduli i Elasticitetit në varësi të Moshës për materiale inerteLumi,Milot, Agresive**

#### 4.4.3 Ndikimi i kushteve ambientale në Modulin e Elasticitetit




Fig.4.4.3.1: Moduli i Elasticitetit në varësi të Moshës për materiale inerte mali, Fushë Krujë




Fig.4.4.3.2: Moduli i Elasticitetit në varësi të Moshës për agregate Lumi, Romanat




Fig.4.4.3.3: Moduli i Elasticitetit në varësi të llojit të agregatit në Rt

#### Krahasimi i Modulit të Elasticitetit për llojete agregateve të përdorura




Fig.4.4.3.4: Moduli i Elasticitetit në varësi të llojit të agregatit

**Në përmbledhje themi:**

- Moduli i elasticitetit varet nga rezistencë mekanike (d.m.th në fund të fundit nga raporti ujë/çimento )
- Moduli i elasticitetit varet nga raporti ndërmjet përbërësve të ngurtë që dtth materiale inerte me modul elasticiteti (E) shumë të lartë,

Moduli i elasticitetit varet nga moduli i elasticitetit të çimentos (betonet janë më të deformueshëm kur kemi çimento me E shumë të ulët). Këtë faktor e kemi marrë parasysh në përzgjedhjen e llojit të çimentos së përdorur. Ndikimi i kësaj përbërje vërehet: Reaksioni i hidratimit të çimentos është një reaksion ekzotermik dmth shoqërohet me çlirim nxehtësie. Edhe hidratimi i  $C_3S$  dhe  $C_3A$  kontribuojnë në këtë reaksion ekzotermik. Kështu sa më e madhe të jetë sasia e çimentos së përdorur aq më e madhe do të jetë edhe sasia e nxehtësisë së çliruar që dtth aq më i madh është edhe avullimi i ujit gjatë procesit të ngurtësimit si dhe rritet mundësia e shtimit të poreve kapilare. Pra **hidratimi i çimentos ndikon në ritjen e poreve në beton.**

- Moduli i elasticitetit të betonit (E) varet nga varet nga pjerrësia fillestare e kurbës  $\sigma - \epsilon$ , sa më e lartë është përmbajtja e agragateve në beton aq më e lartë është kurba  $\sigma - \epsilon$ . Duhet që kjo kurbë ti afrohet sa më shumë kurbës së agragateve.
- Moduli i elasticitetit varet nga nga lloji i shkëmbit nga merren agregatet, më shumë ose më pak i ngurtë (granitë, bazolit, gurë gëlqeror, kuarcor).
- Moduli i elasticitetit varet në mënyrë të tërthortë nga klasat e ekspozimit. Nga matjet e bëra na rezulton që betonet në të dyja klasat e ekspozimit kanë tkurrje. Ky fenomen ndodh :
  - Nga tharja (nga hidratimi i çimentos i cili shoqërohet me çlirim nxehtësie dhe për rrjedhojë me avullim uji )
  - Nga karbonatimi (nga  $CO_2$ , kur thellësia e karbonatimit kalon shtresën mbrojtëse jonet e kripës gjejnë ambjent të përshtatshëm për të rritur korrodimin e hekurit punues.)
  - Nga rritja e volumit të ujit gjatë ngurtësimit

#### **4.5 FAKTORËT QË NDIKOJNË NË VETITË E BETONEVE JETËGJATË**

Në analizat tona laboratorike jemi përqendruar në:

Përmbajtja e klorureve për betonet e trajtuara në klasat e ekspozimit XS

Përshkueshmëria e ujit për betonet e trajtuara në kushte ambientale N dhe A.

##### **4.5.1 Përmbajtja e klorureve të kubeve të betonit të klasës c35/45**

Nga ATSM C1202 vlerat e lejueshme 1000-2000 kollonë kanë përshkueshmëri të ulët.

Përmbajtja e klorureve në beton mbështetur në standartin S SHEN 1744-1; UNI EN 196-2, PIKA 14 ku thuhet që përqindja e klorureve në beton nuk duhet të jetë më shumë se

0.1%. Sipas S SH EN 206-1 , tabela 10, përmbajtja maksimale e Cl- në masë të çimentos është 1% dhe b/a 0.4- 0.6%

#### 4.5.2 Ndikimi i raportit ujë/çimento në përmbajtjen e klorureve, për betonet me materiale inerte mali Krujë




Fig.4.5.2.1: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport  $u/\zeta = 0.47$ , të trajtuar në kushte Agresive; me agregate mali Fushë Krujë





Fig.4.5.2.2: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport  $u/\zeta = 0.40$ , të trajtuar në kushte Agresive; me agregate mali Fushë Krujë



**Fig.4.5.2.3: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport u/ç= 0.35, të trajtuar në kushte Agresive; me agregate mali Fushë Krujë**

Nga analiza e grafikëve të mësipërm themi që:

Përmbajtja e klorureve, për betonet e prodhuara me materiale inerte mali Fushë Krujë është një varësi pothuajse lineare, sipas ekuacioneve  $y = 0.001 x + 0.455$


Përmbajtja e klorureve, për agregatet e Fushë Krujës, është < 1%, pavarësisht moshës apo raportit u/ç.

#### **4.5.3 Ndikimi në Përmbajtjen e klorureve të raportit u/ç në betonet e prodhuara me agregate lumi Erzen, të marra në Romanat**


Nga analiza e grafikëve të mësipërm themi që:

Përmbajtja e klorureve, për betonet e prodhuara me materiale inerte Romanatit është një varësi pothuajse lineare, sipas ekuacioneve  $y = 0.001 x + 0.602$

Përmbajtja e klorureve, për agregatet e Romanatit, është < 1%, pavarësisht moshës apo raportit u/ç.



**Fig.4.5.3.1: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport u/ç= 0.45, të trajtuar në kushte Agresive; me agregate lumi Erzen, Romanat**



**Fig.4.5.3.2: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport u/ç= 0.40, të trajtuar në kushte Agresive; me materiale inerte lumi Erzen, Romanat**

#### 4.5.4 Ndikimi në Përmbajtjen e klorureve të raportit u/ç, në kubet e betonit të klasës C35/45 për agregate lumi Mat, të marra në Milot




Fig.4.5.4.1: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport u/ç= 0.45, të trajtuar në kushte Agresive; me agregate lumi Mat, në Milot





Fig.4.5.4.2: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport u/ç= 0.40, të trajtuar në kushte Agresive; me agregate lumi Mat, në Milot



**Fig.4.5.4.3: Varësia ndërmjet Përmbajtje së klorureve dhe moshës së betonit, për raport u/ç= 0.35, të trajtuar në kushte Agresive; me agregate lumi Mat, në Milot**


Nga analiza e grafikëve të mësipërm themi që:

Përmbajtja e klorureve, për betonet e prodhuara me materiale inerte Milotit është një varësi pothuajse lineare, sipas ekuacioneve  $y = 0.001 x + 0.251$


Përmbajtja e klorureve, për agregatet e Milotit, është < 1%, pavarësisht moshës apo raportit u/ç.

Në këtë agregat marim vlerat më të vogla të përmbajtjes së klorureve.


#### 4.5.5 Ndikimi i agregateve dhe moshës së betonit në përmbajtjen e klorureve




**Fig.4.5.5.1: Varësia ndërmjet Përmbajtjes së klorureve dhe raport u/ç, kushte Normale; me agregate mali Fushë Krujë**




**Fig.4.5.5.2: Varësia ndërmjet përmbajtjes së klorureve dhe raport u/ç, kushte Agresive; me agregate mali Fushë Krujë**




**Fig.4.5.5.3: Varësia ndërmjet Përmbajtjes së klorureve dhe raport  $u/\zeta$ , kushte Normale; me agregate lumi Erzen, Romanat**



**Fig.4.5.5.4: Varësia ndërmjet Përmbajtjes së klorureve dhe raport  $u/\zeta$ , kushte e ekspozimit Agresive; me agregate lumi Erzen, Romanat**



**Fig.4.5.5.5: Varësia ndërmjet Përmbytjes së klorureve dhe raport  $u/\zeta$ , kushte Normale; me agregate lumi Mat, në Milot**



**Fig.4.5.5.6: Varësia ndërmjet Përmbytjes së klorureve dhe raport  $u/\zeta$ , kushte Agresive; me agregate lumi Mat, në Milot**

#### 4.5.6 Krahasimi i varësisë së përmbajtjes së klorureve në beton nga raporti u/ç, lloji i agregatit, moshë së betonit




Fig.4.5.6.1: Varësisë së përmbajtjes së klorureve në beton nga raporti u/ç, lloji i agregatit, moshë së betonit

Nga analiza e grafikëve të mësipërm themi që:

Përmbajtja e klorureve, varet nga lloji i agregatit. Në referencë të grafikëve të mësipërm agregati me përmbajtjen më të ulët të klorureve është ai i Milotit.

Përmbajtja e klorureve bëhet më e ndjeshme për raportin  $u/\zeta < 0.4$ . Vlerat ulen shumë deri gati të papërfillshme.

Përmbajtja e klorureve varet nga mosha e betonit, në varësi lineare, pavarësisht nga lloji i agregatit të përdorur.

Përmbajtja e klorureve, për agregatet e Fushë Krujës, është  $< 1\%$ , pavarësisht moshës apo raportit  $u/\zeta$  dhe kushteve ambientale të punës së betonit.

## 4.6 PËRSHKUESHMËRIA E UJIT NË BETON

### 4.6.1 Ndikimi i raportit ujë/çimento ndaj përshkueshmërisë së ujit

Për nga rëndësia që ka ky faktor në betonet jetëgjatë, në praktikë identifikohet si durabilitet ose jetëgjatësi e betonit.

### 4.6.2 Ndikimi raportit u/ ç dhe moshës në përshkueshmërinë e ujit




Fig.4.6.2.1: Përshkueshmëria e ujit në varësi të Moshës për materiale inerte Mali, Fushë Krujë




Fig.4.6.2.2: Përshkueshmëria e ujit në varësi të Moshës për materiale inerte Mali, Fushë Krujë




Fig.4.6.2.3: Përshkueshmëria e ujit në varësi të Moshës për materiale inerte Lumi, Romanat





Fig.4.6.2.4: Përshkueshmëria e ujit në varësi të Moshës për materiale inerte Lumi, Miloti

#### 4.6.3 Ndikimi i kushteve të ekspozimit në përshkueshmërinë e ujit

Nga grafikët e mësipërm analizojmë që klasat e ekspozimit ndikojnë në përshkueshmërinë e ujit. Në klasat XS kemi përshkueshmëri më të madhe.

#### 4.6.4 Ndikimi i llojit të agregatit në përshkueshmërinë e ujit



**Fig.4.6.4.1: Përshkueshmëria e ujit në varësi të Agregateve**

Nga analiza e grafikëve të mësipërm themi që:

Pëshueshmëria e ujit, varet nga lloji i agregatit. Në referencë të grafikëve të mësipërm agregati me përmbajtjen më të ulët të klorureve është ai i Milotit.

Pëshueshmëria e ujit bëhet më e ndjeshme për raportin  $u/\zeta < 0.4$ . Vlerat ulen shumë deri gati të papërfillshme. Raportet  $u/\zeta > 0.5$  bëhen jot e lejuar për prodhimin e betoneve jetëgjatë.

Pëshueshmëria e ujit varet nga mosha e betonit, në varësi lineare të zhdrejtë, pavarësisht nga lloji i agregatit të përdorur.

Pëshueshmëria e ujit, për agregatet e Fushë Krujës, është më e lartë dhe në dis araste testimi ka qenë mbi normat e lejuara, pavarësisht moshës apo raportit  $u/\zeta$  dhe kushteve ambientale të punës së betonit.

Pëshueshmëria e ujit varet edhe nga klasat e ekspozimit. Në klasat XS vlerat janë konsiderueshëm më të larta.

Pëshueshmëria e ujit varet shumë edhe nga ngjeshja e betonit të freskët. Kemi pasur një rast të tillë kur ngjeshja e betonit nuk ishte e duhur dhe vlerat e përshkueshmërisë së ujit kalonin.

#### 4.7 Analizat statistikore

Në figrat e mëposhtme janë prezantuar ekuacionet dhe koeficientët e korrelacioneve ndërmjet vetive të betoneve jetëgjatë dhe faktorëve që ndikojnë në këto veti.

Këto relacione janë polinome të formës  $y = ax^2 + bx + c$  me koeficient të korrelacionit  $R^2$ . Vlerat e larta të  $R^2$  (afër vlerës 1) tregojnë që Rezistenca në shtypje,  $R_t$  ose Përshkueshmëria kanë një varësi të konsiderueshme ndaj faktorëve të marrë në shqyrtim.

##### 4.7.1 Analizat statistikore për rezistencën në shtypje

**Tabela 4.7.1.1: Analizat statistikore për rezistencën në shtypje**

| Varësia                      | Lloji i agregatit | Klasa ekspozimit | Vlera u/ç       | Mosha (ditë) | Ekuacioni             | Koeficienti $R^2$ |
|------------------------------|-------------------|------------------|-----------------|--------------|-----------------------|-------------------|
| Rezistenca në shtypje me u/ç | mali, Fushë Krujë | N ( XC4)         | 0.35; 0.4; 0.47 | 28           | $y = -11.52x + 64.53$ | 1                 |
| Rezistenca në shtypje me u/ç | mali, Fushë Krujë | A ( XS )         | 0.35; 0.4; 0.47 | 28           | $y = -7.814x + 60.26$ | 0.815             |
| Rezistenca në shtypje me u/ç | lumi , Romanat    | N ( XC4)         | 0.35; 0.4; 0.45 | 28           | $y = -3.660x + 49.41$ | 0.993             |
| Rezistenca në shtypje me u/ç | lumi , Romanat    | A ( XS )         | 0.35; 0.4; 0.45 | 28           | $y = -1.875x + 48.69$ | 0.987             |
| Rezistenca në shtypje me u/ç | lumi , Milot      | N ( XC4)         | 0.34; 0.4; 0.45 | 28           | $y = -3.913x + 56.62$ | 0.962             |
| Rezistenca në shtypje me u/ç | lumi , Milot      | A ( XS )         | 0.34; 0.4; 0.45 | 28           | $y = -3.751x + 58.98$ | 0.999             |

**Tabela 4.7.1.2: Analizat statistikore për rezistencën në shtypje**

| Varësia                         | Lloji i agregatit | Klasa ekspozimit | Vlera u/ç | Mosha ( ditë)  | Ekuacioni            | Koeficienti $R^2$ |
|---------------------------------|-------------------|------------------|-----------|----------------|----------------------|-------------------|
| Rezistenca në shtypje me Moshën | mali, Fushë Krujë | N ( XC4)         | 0.35      | 7; 28; 90; 180 | $y = 10.60x + 28.91$ | 0.957             |
| Rezistenca në shtypje me Moshën | mali, Fushë Krujë | N ( XC4)         | 0.4       | 7; 28; 90; 180 | $y = 5.986x + 28.36$ | 0.904             |
| Rezistenca në shtypje me Moshën | mali, Fushë Krujë | N ( XC4)         | 0.47      | 7; 28; 90; 180 | $y = 6.066x + 22.90$ | 0.836             |

|                                 |                   |           |      |                |                       |         |
|---------------------------------|-------------------|-----------|------|----------------|-----------------------|---------|
| Rezistenca në shtypje me Moshën | mali, Fushë Krujë | A ( XS )  | 0.35 | 7; 28; 90; 180 | $y = 7.101x + 35.42$  | 0.732   |
| Rezistenca në shtypje me Moshën | mali, Fushë Krujë | A ( XS )  | 0.4  | 7; 28; 90; 180 | $y = 2.961x + 32.81$  | 0.453   |
| Rezistenca në shtypje me Moshën | mali, Fushë Krujë | A ( XS )  | 0.47 | 7; 28; 90; 180 | $y = 3.171x + 26.75$  | 0.459   |
| Rezistenca në shtypje me Moshën | lumi , Romanat    | N ( XC4 ) | 0.35 | 7; 28; 90; 180 | $y = 0.099x + 35.47$  | 0.576   |
| Rezistenca në shtypje me Moshën | lumi , Romanat    | N ( XC4 ) | 0.4  | 7; 28; 90; 180 | $y = 0.107x + 33.72$  | 0.649   |
